

**32005L0068**

**Direktiva 2005/68/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 16 nëntor 2005, mbi risigurimin dhe Direktivat ndryshuese të Këshillit 73/239/KEE, 92/49/KEE si dhe Direktivat 98/78/KE dhe 2002/83/KE (Tekst me rëndësinë e ZEE-së)**

*Gazeta Zyrtare L 323 , 09/12/2005 fq. 0001 - 0050*

Direktiva 2005/68/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 16 nëntor 2005, mbi risigurimin dhe Direktivat ndryshuese të Këshillit 73/239/KEE, 92/49/KEE si dhe Direktivat 98/78/KE dhe 2002/83/KE (Tekst me rëndësinë e ZEE-së)

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenet 47(2) dhe 55 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social Europian [1],

Pas konsultimit me Komitetin e Rajoneve,

Duke vepruar në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 251 të Traktatit [2]

Meqë:

(1) Direktiva e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës [3], Direktiva e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës [4] dhe Direktiva 2002/83/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 nëntor 2002, në lidhje me sigurimin e jetës [5] e cila përmban dispozitat në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e sigurimit të drejtpërdrejtë në Komunitet.

(2) Këto direktiva parashikojnë kuadrin ligjor për ndërmarrjet e sigurimeve për zhvillimin e veprimtarisë tregtare të sigurimeve në tregun e brendshëm, si nga pikëpamja e së drejtës së vendosjes ashtu edhe nga liria për të ofruar shërbime, me qëllim që të bëhet më e lehtë për ndërmarrjet e sigurimeve, me seli në Komunitet, për të mbuluar angazhimet që gjenden në Komunitet dhe për t'u mundësuar policëmbajtësve t'u drejtohen jo vetëm siguriesve që janë vendosur në vendin e tyre, por edhe siguriesve që kanë zyrën qendror në Komunitet dhe që janë vendosur në Shtete të tjera Anëtare.

(3) Regjimi i vendosur nga këto direktiva zbatohet për ndërmarrjet e sigurimit të drejtpërdrejtë në lidhje me të gjithë veprimtarinë tregtare të kryer, si veprimtaritë e sigurimeve të drejtpërdrejta, ashtu edhe veprimtaritë e risigurimit nëpërmjet pranimeve; megjithatë, veprimtaritë e risigurimit të kryera nga ndërmarrjet e specializuara të risigurimit nuk i nënshtrohen as atij regjimi dhe as ndonjë regjimi tjetër të parashikuar nga e drejta e Komunitetit.

(4) Risigurimi është një aktivitet i rëndësishëm financiar pasi ai u lejon ndërmarrjeve të sigurimit të drejtpërdrejtë, përmes mundësisë të një shpërndarjeje më të gjerë të risqeve në nivel botëror, të kenë një kapacitet më të gjerë sigurues për t'u përfshirë në veprimtarinë e sigurimit dhe të ofrojnë mbulim me siguri si dhe të ulin kostot e tyre kapitale; për më tepër, risigurimi luan një rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë financiare, meqenëse ai është një element thelbësor në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe stabilitetin e tregjeve të sigurimit të drejtpërdrejtë si dhe të sistemit financiar në tërësi, pasi ai përfshin ndërmjetës të rëndësishëm financiarë dhe investitorë institucionalë.

(5) Direktiva e Këshillit 64/255/KEE, datë 25 shkurt 1964, për heqjen e kufizimeve mbi lirinë e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime në lidhje me risigurimet dhe retrocesionin [6] ka hequr kufizimet mbi të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime në lidhje me shtetësinë ose vendbanimin e ofruesit të risigurimit. Megjithatë, ajo nuk ka hequr kufizimet e shkaktuara nga mospërputhjet ndërmjet dispozitave kombëtare në lidhje me rregullimin e mbikëqyrjes së risigurimit. Kjo situatë ka rezultuar në dallime të konsiderueshme në nivelin e mbikëqyrjes së ndërmarrjeve të risigurimit në Komunitet, gjë që krijon barriera për ndjekjen e veprimtarisë së risigurimit, si detyrimi për ndërmarrjen e risigurimit që të vendosë si garanci aktivitetet e saja për të mbuluar pjesën e saj të provigjoneve teknike të ndërmarrjes së sigurimit të drejtpërdrejtë, si dhe përmbushja nga ndërmarrjet risiguroese e rregullave të ndryshme mbikëqyrëse në Shtetet e ndryshme Anëtare në të cilat ato ushtrojnë veprimtari tregtare, ose një mbikëqyrje e tërthortë të aspekteve të ndryshme të një ndërmarrjeje risigurimi nga autoritetet kompetente të ndërmarrjeve të sigurimit të drejtpërdrejtë.

(6) Plani i Veprimit për Shërbimet Financiare ka identifikuar risigurimin si një sektor që kërkon veprim në nivel komunitar me qëllim që të bëhet i plotë tregu i brendshëm për shërbimet financiare. Për më tepër, forume të rëndësishme financiare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) kanë theksuar mungesën e rregullave të harmonizuara për mbikëqyrjen e risigurimit në nivel komunitar si një boshllëk të konsiderueshëm në kuadrin rregullator të shërbimeve financiare i cili rekomandohet të mbushet.

(7) Kjo direktivë synon vendosjen e një kuadri rregullator mbikëqyrës për veprimtaritë e risigurimit në Komunitet. Ajo është pjesë e legjislacionit komunitar në fushën e sigurimeve me qëllim krijimin e Tregut të Brendshëm në sektorin e sigurimeve.

(8) Kjo direktivë është në pajtim me përpjekjet madhore ndërkombëtare që kryhen për rregullat e mbikëqyrjes së risigurimit, veçanërisht me IAIS-në.

(9) Kjo direktivë ndjek qëndrimin e legjislacionit komunitar të miratuar në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë duke kryer harmonizimin që është thelbësor, të nevojshëm dhe të mjaftueshëm për të siguruar njohjen reciproke të autorizimeve dhe sistemeve të kontrollit të matur, duke bërë kështu të mundur dhënien e një autorizimi të vetëm të vlefshëm në të gjithë Komunitetin dhe zbatuar parimin e mbikëqyrjes nga Shteti Anëtar i origjinës.

(10) Për pasojë, fillimi dhe ndjekja e veprimtarisë së risigurimit i nënshtrohen dhënies së një autorizimi të vetëm zyrtar të lëshuar nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ka zyrën qendrore ndërmarrja e risigurimit. Një autorizim i tillë i mundëson një ndërmarrjeje të ushtrojë veprimtari tregtare në të gjithë Komunitetin, në kuadër të së drejtës së vendosjes ose lirisë për të ofruar shërbime. Shteti Anëtar i degës ose Shteti Anëtar ku ofrohen shërbimet nuk mund t'i kërkojë ndërmarrjes së risigurimit e cila dëshiron të ushtrojë veprimtari risigurimi në territorin e tij dhe që është autorizuar në Shtetin e tij Anëtar të origjinës të bëjë kërkesë për autorizim të ri. Për më tepër, një ndërmarrje risigurimi që është autorizuar në Shtetin Anëtar të origjinës nuk është mirë t'i nënshtrohet mbikëqyrjes

ose kontrollit shtesë, në lidhje me qëndrueshmërinë financiare, të kryer nga autoritetet kompetente të një ndërmarrjeje sigurimi që risigurohet nga ajo ndërmarrje risigurimi. Përveç kësaj, është mirë të mos lejohen Shtetet Anëtare t'i kërkojnë një ndërmarrjeje risigurimi të autorizuar në Komunitet që të vendosë si garanci aktivitet e saja me qëllim që të mbulojë pjesën e saj të provigjoneve teknike të ceduesit. Është mirë të përkufizohen kushtet për dhënien ose tërheqjen e këtij autorizimi. Autoritetet kompetente nuk bëjnë mirë ta autorizojnë ose ta vazhdojnë autorizimin e një ndërmarrjeje risigurimi që nuk përmbush kushtet e parashikuara në këtë direktivë.

(11) Kjo direktivë duhet të zbatohet për ndërmarrjet risiguroese që ushtrojnë vetëm veprimtari risigurimi dhe nuk merren me veprimtari sigurimi të drejtpërdrejtë; kjo vlen edhe për ndërmarrjet risiguroese "të brendshme", të krijuara ose në pronësi të një ndërmarrjeje financiare të ndryshme nga një ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi ose të një grupi ndërmarrjesh sigurimesh ose risigurimi, për të cilat zbatohet Direktiva 98/78/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 27 tetor 1998, për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në një grup sigurimesh [7], ose të një ose disa ndërmarrjeve jofinanciare, qëllimi i të cilave është ofrimi i mbulimit me risigurim vetëm për risqet e ndërmarrjeve të cilave u përkasin. Kur në këtë direktivë përmenden ndërmarrjet risiguroese, kjo duhet të përfshijë ndërmarrjet e brendshme risiguroese, përveç kur bëhet parashikim i veçantë për ndërmarrjet e brendshme risiguroese. Ndërmarrjet e brendshme risiguroese nuk mbulojnë risqet që rrjedhin nga veprimtaria e jashtme e sigurimit të drejtpërdrejtë ose risigurimit të një ndërmarrjeje sigurimi ose risigurimi që i takon atij grupi. Për më tepër, ndërmarrjet e sigurimeve ose risiguroese që i përkasin një konglomerati financiar nuk mund të kenë në pronësi një ndërmarrje të brendshme.

(12) Megjithatë kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për ndërmarrjet e sigurimeve të cilat tashmë u nënshtrohen Direktivave 73/239/KEE ose 2002/83/KE; sidoqoftë, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjeve të sigurimeve që ushtrojnë edhe veprimtari risiguroese dhe me qëllim që karakteristikat specifike të këtyre veprimtarive të merren rregullisht parasysh nga kërkesat për kapital të atyre ndërmarrjeve të sigurimeve, dispozitat në lidhje me nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjeve risiguroese që gjenden në këtë direktivë duhet të zbatohen për veprimtarinë risiguroese të atyre ndërmarrjeve të sigurimit, nëse volumi i veprimtarive të tyre risiguroese përfaqëson një pjesë të rëndësishme të të gjithë veprimtarisë të tyre.

(13) Kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për ofrimin e mbulimit të risigurimit të kryer ose garantuar plotësisht nga një Shtet Anëtar për shkaqe të interesit të lartë publik, në cilësinë e risiguroesit të mundësisë së fundit, veçanërisht nëse për shkak të një situatë specifike në treg, nuk është e mundur të arrihet mbulim tregtar adekuat; në këtë kuptim, një mungesë e "mbulimit tregtar adekuat" do të thotë kryesisht një dështim i tregut që karakterizohet nga një mungesë e dukshme e një game të mjaftueshme të ofertave të sigurimeve, megjithëse primet e ekzagjeruara nuk do të thonë në vetvete se ky mbulim tregtar nuk është adekuat. Neni 1 pika 2 i kësaj direktive zbatohet edhe për rregullimet ndërmjet ndërmarrjeve të sigurimeve për të cilat zbatohen Direktivat 73/239/KEE ose 2002/83/KE dhe që synojnë të bashkojnë në një vend dëmet financiare që rrjedhin nga risqet madhore si terrorizmi.

(14) Ndërmarrjet risiguroese duhet ta kufizojnë objektin e tyre në veprimtarinë e risigurimit dhe operacioneve në lidhje me të. Kjo kërkesë mund t'i lejojë një ndërmarrjeje risigurimi të kryejë, për shembull, veprimtari të tilla si dhënia e këshillimeve statistikore ose aktuariale, analizë risku ose punë kërkimore për klientët e saj. Kjo mund të përfshijë edhe funksionin e një shoqërie holding dhe veprimtaritë në lidhje me veprimtaritë e sektorit financiar në kuptimin e nenit 2 pika 8 të Direktivës 2002/87/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2002, për mbikëqyrjen shtesë të institucioneve të kreditit, ndërmarrjeve të sigurimeve dhe firmave të investimeve në një konglomerat

financiar [8]. Në çdo rast, kjo kërkesë nuk lejon kryerjen e veprimtarive bankare dhe financiare që nuk kanë lidhje me to.

(15) Kjo direktivë duhet të sqarojë kompetencat dhe mjetet e mbikëqyrjes që u janë dhënë autoriteteve kompetente. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës së ndërmarrjes risiguroese duhet të jenë përgjegjëse për monitorimin e gjendjes financiare të ndërmarrjeve risiguroese, duke përfshirë gjendjen e aftësisë paguese të tyre, krijimin e provigjoneve të mjaftueshme teknike dhe rezervat e barazimit dhe mbulimin e këtyre provigjoneve dhe rezervave me aktive cilësore.

(16) Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare duhet të kenë në dispozicion të tyre mjete mbikëqyrjeje që janë të nevojshme për të siguruar ndjekjen e rregullt të veprimtarisë së ndërmarrjeve risiguroese në të gjithë Komunitetin, në kuadër të së drejtës së vendosjes apo të lirisë për të ofruar shërbime. Ato duhet të jenë veçanërisht në gjendje të zbatojnë masa mbrojtëse të duhura ose të vendosin sanksione që synojnë parandalimin e parregullsive dhe shkeljeve të dispozitave për mbikëqyrjen e risigurimit.

(17) Dispozitat që rregullojnë transferimin e portofoleve duhet të jenë në pajtim me autorizimin e vetëm të parashikuar në këtë direktivë. Ato duhet të zbatohen për llojet e ndryshme të transferimeve të portofoleve ndërmjet ndërmarrjeve risiguroese, si transferimet e portofoleve që rrjedhin nga bashkimet ndërmjet ndërmarrjeve risiguroese, ose instrumente të tjera të legjislacionit për shoqëritë tregtare ose transferimet e portofoleve me humbje pezull, që i kalojnë një ndërmarrjeje tjetër risiguroese. Për më tepër, dispozitat që rregullojnë transferimet e portofoleve duhet të përfshijnë dispozita veçanërisht në lidhje me transferimet në një ndërmarrje tjetër risigurimi të portofolit të kontratave të lidhura sipas së drejtës së vendosjes ose të lirisë për të ofruar shërbime.

(18) Është mirë të hartohen dispozita për shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve ose organeve të cilat, në sajë të funksionit të tyre, ndihmojnë në fuqizimin e stabilitetit të sistemit financiar. Me qëllim që të ruhet natyra konfidenciale e informacionit të dhënë, është mirë që lista e personave të cilëve u drejtohet informacioni të mbetet brenda kufijve rigorozë. Kështu, është e nevojshme të specifikohen kushtet sipas të cilave autorizohen shkëmbimet e sipërpërmendura të informacionit; për më tepër, nëse parashikohet që informacioni mund të deklarohet vetëm me pëlqimin specifik të autoriteteve kompetente, ato, sipas rastit, mund t'ia nënshtrojnë pëlqimin e tyre respektimit të kushteve rigorozë. Në këtë aspekt, dhe me qëllim sigurimin e mbikëqyrjes së duhur të ndërmarrjeve nga autoritetet kompetente, është mirë që kjo direktivë të parashikojë rregulla që t'u mundësojnë Shteteve Anëtare të lidhin marrëveshje mbi shkëmbimin e informacionit me vendet e treta, me kusht që informacioni i deklaruar t'u nënshtrohet garancive të duhura të sekretit profesional.

(19) Për qëllimet e fuqizimit të mbikëqyrjes së kujdesshme të ndërmarrjeve risiguroese, është mirë të parashikohet që audituesi të ketë për detyrë të raportojë menjëherë para autoriteteve kompetente, sipas parashikimit në këtë direktivë, kurdoherë që vjen në dijeni, në përmbushje të detyrave të tij, për fakte të caktuara që mund të kenë efekte serioze mbi gjendjen financiare ose organizimin administrativ dhe kontabël të ndërmarrjes së risigurimit. Duke pasur parasysh qëllimin në fjalë, është e dëshirueshme që Shtetet Anëtare të parashikojnë që kjo detyrë të zbatohet në të gjitha rrethanat, nëse këto fakte zbulohen nga një auditues gjatë përmbushjes së detyrave të tij në një ndërmarrje që ka lidhje të ngushta me një ndërmarrje risiguroese. Detyra e audituesve për t'u komunikuar, sipas rastit, autoriteteve kompetente fakte dhe vendime të caktuara në lidhje me një ndërmarrje risigurimi që ata zbulojnë gjatë përmbushjes së detyrave të tyre në një ndërmarrje jorisigurimi, nuk ndryshon në

vetvete natyrën e detyrave të tyre në ato ndërmarrje, dhe as mënyrën në të cilën ata duhet të përmbushin ato detyra në atë ndërmarrje.

(20) Është mirë të parashikohet zbatimi i kësaj direktive për ndërmarrjet risiguruese ekzistuese, të cilat tashmë janë autorizuar ose që kanë të drejtë të zhvillojnë veprimtari risigurimi në pajtim me dispozitat e Shteteve Anëtare para zbatimit të kësaj direktive.

(21) Me qëllim që t'i mundësohet ndërmarrjes së risigurimit të përmbushë angazhimet e saj, Shteti Anëtar i origjinës duhet t'i kërkojë asaj të krijojë provogjone teknike të mjaftueshme. Shuma e këtyre provogjoneve teknike duhet të përcaktohet në pajtim me Direktivën e Këshillit 91/674/KEE, datë 19 dhjetor 1991, për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të ndërmarrjeve të sigurimeve [9] dhe, në lidhje me veprimtaritë e risigurimit të jetës, Shteti Anëtar i origjinës duhet gjithashtu të lejohet të vendosë rregulla më specifike në pajtim me Direktivën 2002/83/KE.

(22) Ndërmarrjes së risigurimit që zhvillon veprimtari risigurimi në lidhje me sigurimin e kredisë, veprimtaria e risigurimit të kredisë e së cilës përbën më shumë se një pjesë të vogël të të gjithë veprimtarisë të saj është mirë t'i kërkojë të krijojë një provigjion të barazimit të dëmeve që nuk është pjesë e nivelit të aftësisë paguese; kjo rezervë duhet të llogaritet në pajtim me një prej metodave të parashikuara në Direktivën 73/239/KEE dhe që njihen si të barasvlershme; për më tepër, kjo direktivë është mirë t'i lejojë Shtetit Anëtar të origjinës t'u kërkojë ndërmarrjeve risiguruese me zyra qendrore në territorin e tij të krijojnë rezerva barazimi për klasat e risqeve që nuk përfshijnë risigurimin e kredisë, sipas rregullave të përcaktuara nga ai Shteti Anëtar i origjinës. Pas futjes në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF 4), është mirë që kjo direktivë të sqarojë trajtimin mbikëqyrës të provigjoneve të të barazimit të dëmeve të krijuara në pajtim me këtë direktivë. Megjithatë, meqenëse mbikëqyrja e nevojave të risigurimit është mirë të rivlerësohet sipas projektit "Solvency II" (Aftësia Paguese II), kjo direktivë nuk i del përpara asnjë mbikëqyrjeje të ardhshme që i bëhet risigurimit projektit "Solvency II".

(23) Ndërmarrja e risigurimit është mirë të ketë aktive në mbulim të provigjoneve teknike dhe rezervave të barazimit që duhet të marrin parasysh llojin e veprimtarisë që ajo kryen e veçanërisht natyrën, shumën dhe kohëzgjatjen e pagesave të pritshme të dëmeve, në një mënyrë të tillë që të sigurohet përshtatshmëria, likuiditeti, siguria, cilësia, përfitueshmëria dhe përputhja e investimeve të saj, që ndërmarrja të sigurojë se janë të diversifikuara dhe të shtrira në mënyrë të përshtatshme dhe që t'i japin ndërmarrjes mundësinë e reagimit të përshtatshëm ndaj rrethanave ekonomike në ndryshim, veçanërisht zhvillimeve në tregjet financiare dhe tregjet e pasurive të paluajtshme ose ngjarjet madhore të katastrofave.

(24) Është e nevojshme që, mbi rezervat teknike, ndërmarrjet risiguruese të kenë rezervë shtesë, të njohur si niveli i aftësisë paguese, të përfaqësuar nga aktive të lira dhe, me pëlqimin e autoritetit kompetent, me aktive të tërthorta, të cilat të shërbejnë si amortizuese kundrejt luhatjeve negative të veprimtarisë. Kjo kërkesë është një element i rëndësishëm i mbikëqyrjes të kryer me matura. Në pritje të rishikimit të regjimit ekzistues të nivelit të aftësisë paguese, gjë që Komisioni po e kryen në kuadrin e të ashtuquajturit projekti "Solvency II", me qëllim që të përcaktohet niveli i kërkuar i aftësisë paguese të ndërmarrjeve të risigurimit, është mirë të zbatohen rregullat e parashikuara në legjisllacionin ekzistues në fushën e sigurimit të drejtpërdrejtë.

(25) Në dritën e ngjashmërive ndërmjet risigurimit të jetës që mbulon riskun e vdekshmërisë dhe risigurimit të jojetës, veçanërisht mbulimin e risqeve të sigurimeve dhe kohëzgjatjen e kontratave të risigurimit të jetës, niveli i kërkuar i aftësisë paguese për risigurimin e jetës duhet të përcaktohet në

pajtim me dispozitat e parashikuara në këtë direktivë për llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për risigurimin e jojetës; Shteti Anëtar i origjinës duhet të lejohet të zbatojë rregullat e parashikuara në Direktivën 2002/83/KE për vendosjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, në lidhje me veprimtaritë e risigurimit të jetës, që kanë të bëjnë me fondet e investimeve ose kontratat e pjesëmarrjes.

(26) Me qëllim që të merret parasysh natyra e veçantë e disa llojeve të kontratave të risigurimit ose linjave specifike të veprimtarisë, është mirë të merren masa për të bërë përshtatjet me llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese; këto përshtatje duhet të bëhen nga Komisioni, pas konsultimit me Komitetin Europian të Sigurimeve dhe Pensionet nga Marrëdhëniet e Punës, të ngritur me Vendim të Komisionit 2004/9/KE [10] në ushtrim të kompetencave të tij zbatuese të dhëna nga Traktati.

(27) Këto masa duhet të miratohen në zbatim të procedurës rregullatore të parashikuar në nenin 5 të Vendimit të Këshillit 1999/468/KE, datë 28 qershor 1999, i cili përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave ekzekutive, të dhëna Komisionit [11].

(28) Lista e elementeve të përshtatshme për të përfaqësuar nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese, të parashikuar nga kjo direktivë, duhet të jetë ajo e parashikuar në Direktivat 73/239/KEE dhe 2002/83/KE.

(29) Ndërmarrjet risiguroese është mirë të kenë edhe një fond garancie me qëllim që të sigurojnë që ato zotërojnë burime të mjaftueshme kur themelohen dhe që në rrjedhën pasuese të veprimtarisë niveli i aftësisë paguese në asnjë rast nuk bie poshtë një minimumi garancie; megjithatë, me qëllim që të merren parasysh specifikat e ndërmarrjeve risiguroese të brendshme, është mirë të merren masa për t'i lejuar Shtetit Anëtar të origjinës të caktojë fondin e garancisë minimale të kërkuar për ndërmarrjet e brendshme të risigurimit në një shumë më të vogël.

(30) Dispozita të caktuara të kësaj direktive vendosin standardet minimale.. Është mirë që Shteti Anëtar i origjinës të jetë në gjendje të vendosë rregulla më rigorozë për ndërmarrjet risiguroese të autorizuar nga autoritetet e saj kompetente, veçanërisht në lidhje me kërkesat për nivelin e aftësisë paguese.

(31) Kjo direktivë duhet të jetë e zbatueshme për veprimtaritë risiguroese e fundme; kështu, është i nevojshëm një përkufizim i risigurimit të fundmë për qëllimin e kësaj direktive; për shkak të natyrës së veçantë të kësaj linje të veprimtarisë të risigurimit, është mirë që Shtetit Anëtar të origjinës t'i lihet zgjedhja e vendosjes së dispozitave specifike për zhvillimin e veprimtarive risiguroese të fundme.

(32) Kjo direktivë është mirë të përmbajë rregulla në lidhje me ato mjete për qëllime të veçanta që marrin përsipër rrisje nga ndërmarrjet e sigurimit dhe risigurimit. Natyra e veçantë e këtyre mjeteve për qëllime të veçanta, të cilat nuk janë ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi, kërkon vendosjen e dispozitave specifike në Shtetet Anëtare. Për më tepër, është mirë që kjo direktivë të parashikojë që Shteti Anëtar i origjinës të vendosë rregulla me të hollësishme me qëllim që të vendosen kushtet në bazë të të cilave shumat e mbetura nga një mjet për qëllime të veçanta mund të përdoren si aktive në mbulim të provigjoneve teknike nga një ndërmarrje sigurimi dhe risigurimi. Është mirë që kjo direktivë të parashikojë edhe që shumat e rikuperueshme nga një mjet për qëllime të veçanta të mund të konsiderohen si shuma të zbritshme sipas kontratave të risigurimit ose retrocesionit brenda kufijve të caktuara në këtë direktivë, sipas kërkesës së ndërmarrjes së sigurimit ose ndërmarrjes risiguroese drejtuar autoritetit kompetent dhe pas pëlqimit të atij autoriteti.

(33) Është e nevojshme të parashikohen masa në rastet kur gjendja financiare e ndërmarrjes risiguroese bëhet e tillë që është e vështirë të përmbushë detyrimet e marra përsipër. Në situata të veçanta, është gjithashtu e nevojshme që autoritetet kompetente të kenë kompetencë të ndërhyjnë në një fazë mjaftueshmërisht të hershme, por në ushtrim të këtyre kompetencave, autoritetet kompetente bëjnë mirë të informojnë ndërmarrjet risiguroese për arsyet që motivojnë këtë veprim mbikëqyrës, në pajtim me parimet e administrimit të shëndoshë dhe në zbatim të drejtë të ligjit. Për sa kohë që vazhdon një situatë e tillë, nuk është mirë të lejohej autoritetet kompetente të certifikojnë që ndërmarrja risiguroese ka një nivel të mjaftueshëm të aftësisë paguese.

(34) Është e nevojshme të parashikohet bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare me qëllim që të sigurohet që një ndërmarrje risigurimi e cila i zhvillon veprimtaritë e saj sipas së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime të respektojë dispozitat e zbatueshme për të në Shtetin Anëtar pritës.

(35) Është mirë të parashikohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatave në rast refuzimi ose tërheqjeje të autorizimit.

(36) Është e rëndësishme që të parashikohet që ndërmarrjet risiguroese me zyra qendrore jashtë Komunitetit që zhvillojnë veprimtari risigurimi në Komunitet të mos u nënshtrohen dispozitave që çojnë në një trajtim më të favorshëm se ai që parashikohet për ndërmarrjet risiguroese me zyra qendrore një Shtet Anëtar.

(37) Me qëllim që të merren parasysh aspektet ndërkombëtare të risigurimit, është mirë të parashikohet mundësia e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare me një vend të tretë që synojnë përcaktimin e mjeteve të mbikëqyrjes së subjekteve risiguroese që zhvillojnë veprimtari në territorin e çdo pale kontraktuese.

(38) Është mirë të parashikohet një procedurë më fleksibël për ta bërë të mundur vlerësimin e barasvlershmërisë me maturi me vendet e treta në nivel Komuniteti, për të përmirësuar liberalizimin e shërbimeve të risigurimit në vendet e treta, përmes vendosjes apo përmes ofrimit ndërkufitar të shërbimeve. Për këtë qëllim, kjo direktivë është mirë të parashikojë procedurat për negocimin me vendet e treta.

(39) Rekomandohet që Komisioni të ketë kompetencë të miratojë masa zbatuese me kusht që këto të mos modifikojnë elementet thelbësore të kësaj direktive. Këto masa zbatuese duhet t'i mundësojnë Komunitetit të marrë parasysh zhvillimin e risigurimit në të ardhmen. Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive duhet të miratohen në pajtim me Vendimin 1999/468/KE.

(40) Kuadri ligjor ekzistues i Komunitetit për sigurimet është mirë të përshtatet me qëllim që të marrë parasysh regjimin e ri mbikëqyrës për ndërmarrjet risiguroese të parashikuar nga kjo direktivë dhe me qëllim që të sigurohet një kuadër i njëtrajtshtëm rregullator për të gjithë sektorin e sigurimeve. Veçanërisht, duhet të përshtaten dispozitat ekzistuese që lejojnë "mbikëqyrje jo të drejtpërdrejta" të ndërmarrjeve risiguroese nga autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve të sigurimeve të drejtpërdrejta. Për më tepër, është e nevojshme të shfuqizohen dispozitat e tanishme që u japin mundësi Shteteve Anëtare të kërkojnë vendosjen e barrës siguroese mbi aktivet në mbulim të provigjoneve teknike të një ndërmarrjeje sigurimi, cilëndo formë që të marrë kjo kërkesë, nëse siguroesi është i risiguruar nga një ndërmarrje risigurimi e autorizuar në pajtim me këtë direktivë ose nga një ndërmarrje sigurimi. Së fundmi, është mirë të parashikohet që niveli i aftësisë paguese i kërkuar për ndërmarrjet e sigurimeve që zhvillojnë veprimtari risiguroese, nëse këto veprimtari

përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të veprimtarisë të tyre, t'u nënshtrohet rregullave të aftësisë paguese të parashikuara për ndërmarrjet risiguruese në këtë direktivë.

(41) Direktiva 98/78/KE duhet të ndryshohet me qëllim që të garantohet që ndërmarrjet risiguruese në një grup sigurimesh ose risigurimi t'i nënshtrohen mbikëqyrjes shtesë në të njëjtën mënyrë si ndërmarrjet e sigurimit që janë pjesë e një grupi sigurimesh.

(42) Në përputhje me pikën 34 të marrëveshjes ndërinstitucionale për një ligjvënie më të mirë [12], Këshilli nxit shtetet të hartojnë për vete dhe në interes të Komunitetit, tabelat e tyre që ilustrjnë sa më shumë që të jetë e mundur lidhjen midis kësaj direktive dhe masave të kthimit të saj në legjislacion kombëtar, dhe t'i bëjnë ato publike.

Meqë qëllimi i kësaj direktive, domethënë vendosja e një kuadri ligjor për fillimin dhe ndjekjen e veprimtarive risiguruese, nuk mund të arrihet në nivel të mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare, dhe për rrjedhojë për shkak të shkallës dhe ndikimeve të masës, mund të arrihet më mirë në nivel Komuniteti, ky i fundit mund të marrë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç parashtrohet në nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, siç parashtrohet në atë nen, kjo direktivë nuk tejkalon atë që është e nevojshme, me qëllim arritjen e këtij objekti.

(44) Meqenëse kjo direktivë përkufizon standardet minimale, Shtetet Anëtare mund të vendosin rregulla më rigoroze.

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

## TITULLI I

### FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRKUFIZIMET

#### Neni 1

#### **Fusha e veprimit**

1. Kjo direktivë vendos rregulla për fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë të vetëpunësimit të risigurimit të zhvilluar nga ndërmarrjet risiguruese, të cilat zhvillojnë vetëm veprimtari risigurimi dhe që janë vendosur në një Shtet Anëtar ose dëshirojnë të vendosen atje.

2. Kjo direktivë nuk zbatohet për sa më poshtë:

(a) ndërmarrjet e sigurimeve për të cilat zbatohet Direktiva 73/239/KEE ose 2002/83/KE;

(b) veprimtaritë dhe organet e përmendura në nenin 2 dhe 3 të Direktivës 73/239/KEE;

(c) veprimtaritë dhe organet e përmendura në nenin 3 të Direktivës 2002/83/KE;

(d) veprimtarinë e risigurimit të zhvilluar ose garantuar tërësisht nga qeveria e një Shteti Anëtar nëse ky, për shkaqe të interesit të lartë publik, vepron në cilësinë e risiguruesit të mundësisë së fundit, duke përfshirë rrethanat kur një rol i tillë kërkohet nga një situatë në tregun në të cilin nuk është e mundur të përftohet një mbulim i përshtatshëm tregtar.

#### Neni 2

#### **Përkufizime**



1. Për qëllimet e kësaj direktive, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- (a) "risigurim" do të thotë veprimtaria që përbëhet nga pranimi i riskut të ceduar nga një ndërmarrje sigurimesh ose një ndërmarrje tjetër risigurimi. Në rastin e shoqatës së siguruesve të quajtur "Lloyd's", risigurim do të thotë gjithashtu veprimtaria që përbëhet nga pranimi i risqeve të ceduara nga një anëtar i "Lloyd's", nga një ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi të ndryshme nga shoqata e siguruesve të njohur si Lloyd's;
- (b) "ndërmarrje risigurimi e brendshme" do të thotë një ndërmarrje risigurimi në pronësi të një ndërmarrjeje financiare që nuk është ndërmarrje sigurimi ose risiguroese ose një grup ndërmarrjesh sigurimesh ose risiguroese për të cilat zbatohet Direktiva 98/78/KE, ose nga një ndërmarrje jo-financiare, qëllimi i së cilës është ofrimi i mbulimit me risigurim ekskluzivisht për risqet e ndërmarrjes ose ndërmarrjeve të cilave ajo u përket ose të një ndërmarrjeje ose ndërmarrjeve të grupit, anëtare e të cilave është ndërmarrja risiguroese e brendshme;
- (c) "ndërmarrje risigurimi" është një ndërmarrje që ka marrë autorizim zyrtar në pajtim me nenin 3;
- (d) "degë" është një agjenci ose degë e një ndërmarrjeje risigurimi;
- (e) "vendosje" do të thotë selia ose një degë e një ndërmarrjeje risigurimi, duke marrë parasysh shkronjën "d";
- (f) "Shtet Anëtar i origjinës" do të thotë Shteti Anëtar në të cilin gjendet zyra qendrore e ndërmarrjes risiguroese;
- (g) "Shtet Anëtar i degës" do të thotë Shteti Anëtar në të cilin gjendet dega e ndërmarrjes risiguroese;
- (h) "Shteti Anëtar pritës" është Shteti Anëtar në të cilin një ndërmarrje risiguroese ka një degë ose ofron shërbime;
- (i) "kontroll" do të thotë raporti ndërmjet një ndërmarrjeje mëmë dhe një filiali, sipas përkufizimit në nenin 1 të Direktivës 83/349/KEE(13), ose një raport i ngjashëm ndërmjet një personi fizik ose juridik dhe një ndërmarrjeje;
- (j) "pjesëmarrje influencuese" është një pjesëmarrje e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë në një ndërmarrje që përfaqëson 10% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votimit ose që e bën të mundur të ushtrojë një ndikim të rëndësishëm në administrimin e ndërmarrjes në të cilën ekziston një pjesëmarrje;
- (k) "ndërmarrje mëmë" është një ndërmarrje mëmë sipas përkufizimit në nenet 1 dhe 2 të Direktivës 83/349/KEE;
- (l) "filial" do të thotë një ndërmarrje e kontrolluar e përkufizuar në nenet 1 dhe 2 të Direktivës 83/349/KEE;
- (m) "autoritete kompetente" do të thotë autoritetet kombëtare që kanë kompetencë në bazë të akteve ligjore ose nënligjore për të mbikëqyrur ndërmarrjet risiguroese;
- (n) "lidhje të ngushta" do të thotë një situatë në të cilën dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë lidhen me:

(i) pjesëmarrje, që do të thotë pronësi, drejtpërdrejt ose nëpërmjet kontrollit, të 20% ose më shumë të të drejtave të votimit ose kapitalit të një ndërmarrjeje, ose

(ii) kontroll, në të gjitha rastet e përmendura në nenin 1 pika 1 dhe 2 të Direktivës 83/349/KEE ose një raport të ngjashëm ndërmjet çdo personi fizik ose juridik dhe një ndërmarrjeje;

(o) "ndërmarrje financiare" do të thotë një prej subjekteve të mëposhtme:

(i) një institucion krediti, një institucion financiar ose një ndërmarrje për shërbime bankare plotësuese brenda kuptimit të nenit 1 pika 5 dhe 23 të Direktivës 2000/12/KE (14),

(ii) një ndërmarrje sigurimesh, një ndërmarrje risigurimi ose një ndërmarrje sigurimi tip holding në kuptimin e nenit 1 nënpika "i" të Direktivës 98/78/KE,

(iii) një firmë investimi ose një institucion financiar brenda kuptimit të nënpikës 1 të pikës 1 të nenit 4 të Direktivës 2004/39/KE(15),

(iv) një shoqëri financiare e përzier tip holding brenda kuptimit të nenit 2 pika 15 të Direktivës 2002/87/KE;

(p) "mjet për qëllime të veçanta" do të thotë një ndërmarrje, qoftë e themeluar apo jo, e ndryshme nga një ndërmarrje ekzistuese sigurimesh ose risiguroese, që merr përsipër risqe nga ndërmarrjet e sigurimeve ose risiguroese dhe që financon plotësisht ekspozimin ndaj këtyre risqeve nëpërmjet të ardhurave nga një emetim borxhi ose mekanizma të tjerë financiarë ku të drejtat e shlyerjes së dhënësve të këtij borxhi ose mekanizmat e tjera financiare u nënshtrohen detyrimeve risiguroese të këtij mjete

(q) "risigurim i kufizuar" është risigurimi sipas të cilit potenciali maksimal i shprehur specifikisht i humbjes, i shprehur si risku ekonomik maksimal i transferuar, që rrjedh nga një risk i rëndësishëm i marrë përsipër si dhe nga transferimi i riskut kohor, e kalon shumë e primit gjatë kohëzgjatjes së kontratës me një shumë të kufizuar por të konsiderueshme, së bashku me të paktën një prej tipareve të mëposhtme:

(i) përcaktim shprehimisht dhe materialisht i vlerës kohore të parasë,

(ii) dispozita kontraktuale për të përshtatur zbutur bilancin e eksperiencës ekonomike ndërmjet palëve gjatë kohës për të arritur transferimin e synuar të riskut.

2. Për qëllimet e pikës 1 shkronja "a" të këtij neni, ofrimi i mbulimit nga një ndërmarrje risigurimi një institucioni për ofrimin e pensioneve nga marrëdhëniet e punës që përfshihet në fushën e zbatimit të Direktivës 2003/41/KE(16) nëse ligji i Shtetit Anëtar të origjinës së institucionit e lejon këtë mbulim, konsiderohet gjithashtu si një veprimtari që përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj direktive.

Për qëllimet e pikës 1 shkronja "d", çdo prani e përhershme e një ndërmarrjeje risigurimi në territorin e një Shteti Anëtar trajtohet në të njëjtën mënyrë si një agjenci ose degë, edhe nëse kjo prani nuk merr formën e një dege ose agjencie, por përbëhet thjesht nga një zyrë e administruar nga personeli i vetë ndërmarrjes ose nga një person i cili është i pavarur por ka autoritet të përhershëm për të vepruar për ndërmarrjen si një agjenci.

Për qëllimet e pikës 1 shkronja "j" të këtij neni, dhe në kuadër të nenit 12 dhe neneve nga 199 deri në 23 dhe të niveleve të tjera të pjesëmarrjes së përmendura në nenet nga 19 deri në 23, merren parasysh të drejtat e votimit të përmendura në nenin 92 të Direktivës 2001/34/KE(17).

Për qëllimet e pikës 1 shkronja “l”, çdo filial i një ndërmarrjeje filial konsiderohet gjithashtu si një filial i ndërmarrjes e cila është ndërmarrja mëmë më e lartë e atyre ndërmarrjeve.

Për qëllimet e pikës 1 shkronja “n”:

- çdo ndërmarrje filial i një ndërmarrjeje filial konsiderohet gjithashtu filial i ndërmarrjes mëmë që është në krye të atyre ndërmarrjeve;

- një situatë në të cilën dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë janë të lidhur në mënyrë të përhershme me të njëjtin person me një marrëdhënie kontrolli konsiderohet gjithashtu sikur përbën një lidhje të ngushtë ndërmjet këtyre dy personave.

3. Sa herë që në këtë direktivë përmendet monedha euro, vlera e këmbimit në monedhën vendase që duhet të përdoret, duke filluar nga data 31 dhjetor i çdo viti, është ajo e ditës së fundit të muajit tetor pararendës për të cilin janë të disponueshme vlerat e këmbimit në të gjitha monedhat e Komunitetit.

## TITULLI II

### FILLIMI I VEPRIMTARISË TË RISIGURIMIT DHE AUTORIZIMI I NDËRMARRJES RISIGURUESE

#### Neni 3

#### **Parimi i autorizimit**

Fillimi i veprimtarisë të risigurimit i nënshtrohet autorizimit paraprak zyrtar.

Ky autorizim kërkohet tek autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës nga:

(a) një ndërmarrje që e vendos zyrën qendrore në territorin e atij shteti;

(b) çdo ndërmarrje risigurimi e cila, pas marrjes së autorizimit, e shtrin veprimtarinë e risigurimit tej atyre që tashmë janë autorizuar.

#### Neni 4

#### **Objekti i autorizimit**

1. Autorizimi i dhënë në zbatim të nenit 3 është i vlefshëm për të gjithë Komunitetin. Autorizimi i jep mundësi ndërmarrjes së risigurimit të ushtrijë veprimtari atje, sipas së drejtës së vendosjes ose lirisë për të ofruar shërbime.

2. Autorizimi jepet për veprimtaritë risiguruese të jo-jetës, veprimtaritë e sigurimit të jetës dhe të gjitha llojet e veprimtarive risiguruese, sipas kërkesës së bërë nga kërkuesi.

Ai shqyrtohet sipas skemës së operacioneve që duhet të paraqitet në pajtim me nenin 6 shkronja “b” dhe nenin 11 dhe përmbushjes së kushteve të parashikuara për autorizimin nga Shteti Anëtar nga i cili kërkohet autorizimi.

#### Neni 5

#### **Forma e ndërmarrjes risiguruese**

1. Shteti Anëtar i origjinës i kërkon çdo ndërmarrjeje risiguruese për të cilën kërkohet autorizimi të marrë një nga format e caktuara në Shtojcën I.

Ndërmarrja e risigurimit mund të marrë edhe formën e një Shoqërie Europiane (SHE), sipas përkufizimit në Rregulloren (KE) Nr. 2157/2001(18).

2. Shtetet Anëtare, sipas rastit, mund të krijojnë ndërmarrje në çdo formë të së drejtës publike, me kusht që këto organe të kenë si objekt të tyre operacionet risiguruese sipas kushteve të barasvlershme me ato në kuadër të të cilave ushtrojnë veprimtari ndërmarrjet e së drejtës private.

Neni 6

### **Kushtet**

Shteti Anëtar i origjinës i kërkon çdo ndërmarrjeje risiguruese, për të cilën kërkohet autorizimi:

(a) ta kufizojë objektin në veprimtarinë risiguroes dhe operacionet përkatëse; kjo kërkesë mund të përfshijë një funksion të një shoqërie holding dhe veprimtaritë në lidhje me veprimtaritë e sektorit financiar brenda kuptimit të nenit 2, pika 8, të Direktivës 2002/87/KE;

(b) të paraqesë një skemë operacionesh në pajtim me nenin 11;

(c) të ketë një fond minimal garancie të parashikuar në nenin 40 pika 2;

(d) të drejtohet nga persona me reputacion të mirë me kualifikimet ose eksperiencën e përshtatshme profesionale.

Neni 7

### **Lidhjet e ngushta**

1. Nëse ekzistojnë lidhje të ngushta ndërmjet ndërmarrjes risiguruese dhe personave të tjerë fizikë ose juridikë, autoritetet kompetente e japin autorizimin vetëm nëse këto lidhje të ngushta nuk pengojnë ushtrimin e efektshëm të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

2. Autoritetet kompetente e refuzojnë autorizimin nëse aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të një shteti të tretë që rregullojnë një ose më shumë persona fizikë ose juridikë me të cilët ndërmarrja risiguruese ka lidhje të ngushta, ose vështirësitë në lidhje me zbatimin e tyre, e pengojnë ushtrimin e efektshëm të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

3. Autoritetet kompetente u kërkojnë ndërmarrjeve risiguruese t'u japin atyre vazhdimisht informacionin që u duhet për të monitoruar respektimin e kushteve të përmendura në pikën 1.

Neni 8

### **Zyra qendrore e ndërmarrjes risiguruese**

Shtetet Anëtare kërkojnë që zyrat qendrore të ndërmarrjeve risiguruese të gjenden në të njëjtin Shtet Anëtar ku kanë selinë e regjistruar.

Neni 9

### **Kushtet e policave dhe shkallët e primeve**

1. Kjo direktivë nuk i pengon Shtetet Anëtare të mbajnë në fuqi ose të miratojnë akte ligjore, nënligjore apo administrative që kërkojnë miratimin e aktit të themelimit ose të statutit dhe komunikimin e çdo dokumenti tjetër të nevojshëm për ushtrimin normal të mbikëqyrjes.

2. Megjithatë, Shtetet Anëtare nuk mund të miratojnë dispozita që kërkojnë miratimin paraprak ose njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policave, shkallët e primeve dhe formularët dhe dokumentet e tjera të shtypura që ndërmarrja e risigurimit synon të përdorë në marrëdhëniet e saj me ndërmarrjet ceduese ose retroceduese.

Neni 10

### **Kërkesat ekonomike të tregut**

Shtetet Anëtare nuk mund të kërkojnë që kërkesa për autorizim të shikohet në dritën e kërkesave ekonomike të tregut.

Neni 11

### **Skema e operacioneve**

1. Skema e operacioneve e përmendur në nenin 6 shkronja “b” përfshin hollësitë ose prova për:

- (a) natyrën e risqeve që ndërmarrja risiguroese propozon të mbulojë;
- (b) llojet e masave risiguroese që ndërmarrja risiguroese propozon të marrë me ndërmarrjet ceduese;
- (c) parimet orientuese në lidhje me retrocedimin;
- (d) artikujt që përbëjnë fondin minimal të garancisë;
- (e) vlerësimin e shpenzimeve për ngritjen e shërbimeve administrative dhe organizimin e veprimtarisë të sigurimit dhe burimet financiare që mendohet të mbulojnë këto shpenzime.

2. Përveç kërkesave të pikës 1, skema e operacioneve për tre vitet e para financiare përmban:

- (a) çmuarje të shpenzimeve të administrimit, veçanërisht shpenzimet e përgjithshme korrente dhe komisionet;
- (b) çmuarje të primeve ose kontributeve dhe dëmeve;
- (c) një parashikim bilanci;
- (d) çmuarje të burimeve financiare të parashikuara për të mbuluar pasivet e marrjes në sigurim dhe nivelin e aftësisë paguese;

Neni 12

### **Aksionarët dhe ortakët me pjesëmarrje kualifikuese**

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës nuk ia japin ndërmarrjes autorizimin për fillimin e veprimtarisë risiguroese pa u informuar për identitetin e aksionarëve ose ortakëve, të drejtpërdrejtë ose jo, qofshin persona fizikë apo juridikë, të cilët kanë pjesëmarrje influencuese në atë ndërmarrje dhe për shumat e këtyre pjesëmarrjeve.

Këto autoritete e refuzojnë autorizimin nëse, duke marrë parasysh nevojën e sigurimit të një administrimi të shëndoshë dhe me maturi të ndërmarrjes risiguruese.

Neni 13

### **Refuzimi i autorizimit**

Çdo vendim për refuzimin e autorizimit shoqërohet me një arsyetim të përpiktë për këtë dhe i njoftohet ndërmarrjes në fjalë.

Çdo Shtet Anëtar parashikon të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave, në pajtim me nenin 53, për çdo rast refuzimi.

Një parashikim i tillë bëhet edhe në lidhje me rastet kur autoritetet kompetente nuk kanë trajtuar një kërkesë për autorizim me kalimin e afatit prej gjashtë muajsh nga data e marrjes së saj.

Neni 14

### **Konsultimi paraprak me autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të tjera**

1. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar tjetër të përfshirë konsultohet para dhënies së autorizimit për një ndërmarrje risigurimi, që është:

(a) filial ose një ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi e autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar; ose

(b) filial i një ndërmarrjeje mëmë të një ndërmarrjeje sigurimi ose risigurimi të autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar; ose

(c) e kontrolluar nga i njëjti person, fizik apo juridik, i cili kontrollon një ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi të autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar.

2. Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të përfshirë, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit ose firmave të investimit, konsultohet para dhënies së autorizimit një ndërmarrjeje risigurimi e cila është:

(a) filial i një institucioni krediti apo firme investimi e autorizuar në Komunitet; ose

(b) filial i ndërmarrjes mëmë të një institucioni krediti ose firme investimi të autorizuar në Komunitet; ose

(c) e kontrolluar nga i njëjti person, fizik apo juridik, i cili kontrollon një institucion krediti ose firme investimesh të autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar.

3. Autoritetet kompetente përkatëse të përmendura në pikën 1 dhe 2 konsultohen veçanërisht me njëri-tjetrin gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së aksionarëve dhe reputacionit dhe eksperiencës së administratorëve të përfshirë në administrimin e një subjekti tjetër të të njëjtit grup. Ato njoftojnë njëri-tjetrin për çdo informacion në lidhje me përshtatshmërinë e aksionarëve dhe reputacionit dhe eksperiencës së administratorëve që është me rëndësi për autoritetet e tjera kompetente të përfshira për dhënien e autorizimit si dhe për vlerësimin në vazhdimësi të respektimit të kushteve të shfrytëzimit.

TITULLI III

# KUSHTET QË RREGULLOJNË VEPRIMTARINË E RISIGURIMIT

## KAPITULLI I

### PARIMET DHE METODAT E MBIKËQYRJES FINANCIARE

#### Seksioni 1

Autoritetet kompetente dhe rregullat e përgjithshme

#### Neni 15

##### **Autoritetet kompetente dhe objekti i mbikëqyrjes**

1. Mbikëqyrja financiare e ndërmarrjes së risigurimit, duke përfshirë atë të veprimtarisë që ajo kryen nëpërmjet degëve ose sipas lirisë për të ofruar shërbime, është përgjegjësi e vetme e Shtetit Anëtar të origjinës.

Nëse autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar pritës kanë shkak për të menduar që veprimtaritë e një ndërmarrjeje risigurimi mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e saj financiare, ata informojnë autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës së ndërmarrjes risiguroese. Këto autoritete përcaktojnë nëse ndërmarrja risiguroese i respekton ose jo rregullat mbikëqyrëse të parashikuara në këtë direktivë.

2. Mbikëqyrja financiare në pajtim me pikën 1 përfshin, në lidhje me të gjitha veprimtarinë e ndërmarrjes risiguroese, verifikimin e gjendjes së aftësisë paguese, të krijimit të provigjoneve teknike dhe të aktiveve në mbulim të tyre në pajtim me rregullat e parashikuara ose praktikatat e ndjekura në Shtetet Anëtare të origjinës sipas dispozitave të miratuara në nivel Komuniteti.

3. Shteti Anëtar i origjinës i ndërmarrjes risiguroese nuk e refuzon kontratën e retrocedimit të lidhur nga ndërmarrja risiguroese me një ndërmarrje risiguroese të autorizuar në pajtim me këtë direktivë ose një ndërmarrje sigurimesh të autorizuar në pajtim me Direktivat 73/239/KEE ose 2002/83/KE për shkaqe të lidhura drejtpërdrejt me qëndrueshmërinë financiare të asaj ndërmarrjeje risiguroese ose asaj ndërmarrjeje sigurimesh.

4. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës i kërkojnë çdo ndërmarrjeje risigurimi të ketë procedura të shëndosha administrative dhe kontabile dhe mekanizma të përshtatshme të kontrollit të brendshëm.

#### Neni 16

##### **Mbikëqyrja e degëve të vendosura në një Shtet tjetër Anëtar**

Shteti Anëtar i degës parashikon që, nëse një ndërmarrje risiguroese e autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar zhvillon veprimari nëpërmjet një dege, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, pas informimit paraprakisht të autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të degës, kryejnë vetë ose me ndërmjetësimin e personave që ata caktojnë për këtë qëllim, verifikime në vend të informacionit të nevojshëm për të siguruar mbikëqyrjen financiare të ndërmarrjes. Autoritetet e Shtetit Anëtar të degës mund të marrin pjesë në këtë verifikim.

#### Neni 17

##### **Kontabiliteti, informacioni mbikëqyrës dhe statistikor: kompetencat mbikëqyrëse**

1. Çdo Shtet Anëtar i kërkon çdo ndërmarrjeje risiguruese me zyra qendrore në territorin e saj të paraqesë një raport vjetor, duke mbuluar të gjitha llojet e operacioneve, për gjendjen e saj financiare dhe të aftësisë së saj paguese.

2. Shtetet Anëtare u kërkojnë ndërmarrjeje risiguruese me zyra qendrore brenda territoreve të tyre të depozitojnë periodikisht deklarata, së bashku me dokumentet statistikore, të cilat janë të nevojshme për qëllimet e mbikëqyrjes. Autoritetet kompetente i japin njëri tjetrit çdo dokument dhe informacion që është i nevojshëm për qëllimet e mbikëqyrjes.

3. Çdo Shtet Anëtar merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që autoritetet kompetente të kenë kompetencat dhe mjetet e nevojshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë të ndërmarrjeje risiguruese me zyra qendrore brenda territoreve të tyre, duke përfshirë veprimtarinë e kryer jashtë këtyre territoreve.

4. Veçanërisht, autoriteteve kompetente u jepet mundësi :

(a) të bëjnë hetime të hollësishme në lidhje me gjendjen e ndërmarrjes risiguruese dhe të gjithë veprimtarinë e saj, ndër të tjera, duke mbledhur informacion ose duke kërkuar paraqitjen e dokumenteve në lidhje me veprimtarinë risiguruese ose retroceduese, dhe duke kryer hetime në vend tek mjediset e ndërmarrjes risiguruese;

(b) të marrë çdo masë në lidhje me ndërmarrjen risiguruese, anëtarët e këshillit ose administratorët e saj, ose personat që e kontrollojnë atë, që është e përshtatshme dhe e nevojshme për të siguruar që veprimtaria e ndërmarrjes risiguruese të vazhdojë të respektojë aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të cilat ndërmarrja risiguruese duhet të respektojë në çdo Shtet Anëtar;

(c) të sigurojë që këto masa, sipas rastit, të zbatohen me forcë dhe, sipas rastit, nëpërmjet kanaleve gjyqësore.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë gjithashtu që autoritetet kompetente të marrin çdo informacion në lidhje me kontratat të cilat mbahen nga ndërmjetësit.

Neni 18

### **Transferimi i portofolit**

Sipas kushteve të parashikuara në ligjin e brendshëm, çdo Shtet Anëtar autorizon ndërmarrjet risiguruese me zyra qendrore në territorin e tij të transferojnë të gjithë ose një pjesë të portofolit të kontratave, duke përfshirë ato të lidhura sipas së drejtës së vendosjes ose lirisë për të ofruar shërbime, tek një zyrë pranuese të vendosur brenda Komunitetit, nëse autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës së zyrës pranuese vërtetojnë që, pas marrjes parasysh të transferimit, kjo e fundit zotëron nivelin e nevojshëm të aftësisë paguese të përmendur në Kapitullin 3.

Seksioni 2

### **Pjesëmarrjet influencuese**

Neni 19

### **Marrja e pjesëmarrjes influencuese**

Shtetet Anëtare i kërkojnë çdo personi fizik ose juridik i cili propozon të mbajë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një pjesëmarrje influencuese në një ndërmarrje risigurimi të informojë së pari autoritetet



kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, duke treguar madhësinë e pjesëmarrjes së synuar. Ky person duhet gjithashtu të informojë autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës nëse propozon ta rrisë pjesëmarrjen e tij influencuese në mënyrë që raporti i të drejtave të votimit ose i kapitalit që ai ka do të arrijë ose kalonte 20 për qind, 33 për qind ose 50 për qind apo një nivel pas të cilit ndërmarrja risiguruese do të ndërmarrje e kontrolluar e tij.

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës kanë afat deri në tre muaj nga data e njoftimit të parashikuar në paragrafin e parë ta kundërshtojnë këtë plan nëse, duke pasur parasysh nevojën për të siguruar një administrim të shëndoshë dhe me maturi të ndërmarrjes risiguruese në fjalë, ata nuk janë të bindur në lidhje me kualifikimet e personit të përmendur në paragrafin e parë. Nëse nuk e kundërshtojnë planin në fjalë, ato mund të caktojnë një afat maksimal për zbatimin e tij.

Neni 20

### **Marrja e pjesëmarrjes influencuese nga ndërmarrjet financiare**

Nëse përftuesi i pjesëmarrjeve të përmendura në nenin 19 është një ndërmarrje sigurimesh, një ndërmarrje risigurimi, një institucion krediti ose një firmë investimesh e autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar, ose një ndërmarrje mëmë e këtij subjekti, ose një person fizik apo juridik që kontrollon këtë subjekt, dhe nëse, si rezultat i kësaj marrjeje në pronësi, ndërmarrja në të cilën marrësi propozon ta marrë këtë pjesëmarrje do të bëhet filial ose do t'i nënshtrohet kontrollit të marrësit, vlerësimi i marrjes në pronësi duhet t'u nënshtrohet konsultimeve të përmendura në nenin 14.

Neni 21

### **Heqja e pjesëmarrjes influencuese**

Shtetet Anëtare i kërkojnë çdo personi fizik ose juridik i cili propozon të heqë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një pjesëmarrje influencuese në një ndërmarrje risigurimi të informojë së pari autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, duke treguar madhësinë e pjesëmarrjes që synon të ketë.

Ky person duhet gjithashtu të informojë autoritetet kompetente nëse ai propozon ta ulë pjesëmarrjen e tij influencuese në mënyrë që raporti i të drejtave të votimit ose i kapitalit që ai ka do të binte poshtë 20 për qind 33 për qind ose 50 për qind apo në atë nivel ku ndërmarrja risiguruese nuk do të ishte më filial i tij.

Neni 22

### **Informimi i autoriteteve kompetente nga ndërmarrja risiguruese**

Ndërmarrjet risiguruese, me të marrë dijeni, informojnë autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të origjinës për çdo marrje ose heqje të pjesëmarrjeve në kapitalin e tyre që bëjnë që pjesëmarrjet të kalojnë ose bien poshtë pragjeve të përmendura në nenin 19 dhe 21.

Ato gjithashtu, të paktën një herë në vit, i informojnë autoritetet kompetente të lartpërmendura për emrat e aksionarëve dhe ortakëve me pjesëmarrje influencuese dhe për madhësitë e këtyre pjesëmarrjeve, për shembull, siç tregohet nga informacioni i marrë në mbledhjet vjetore të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve ose ortakëve ose si rezultat i respektimit të akteve normative për shoqëritë e regjistruara në bursë.

Neni 23

## **Pjesëmarrjet influencuese: kompetencat e autoritetit kompetent**

Shtetet Anëtare kërkojnë që, nëse ndikimi i ushtruar nga personat e përmendur në nenin 19 mund të bjerë ndesh administrimit të shëndoshë dhe me maturi të ndërmarrjes së risigurimit, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës marrin të gjitha masat e nevojshme për ta ndryshuar këtë situatë. Këto masa mund të përfshijnë, për shembull, urdhrat për sigurimin e padisë, sanksionet kundër anëtarëve të këshillit të administrimit dhe administratorëve, ose pezullimin e ushtrimit të të drejtave të votimit të lidhura me aksionet e mbajtura nga aksionarët ose kuotat e mbajtur nga ortakët në fjalë.

Masa të ngjashme zbatohen për personat fizikë dhe juridikë që nuk respektojnë detyrimin e dhënies së informacionit paraprak të vendosur në pajtim me nenin 19. Nëse pjesëmarrja merret përkundër kundërshtimit të autoriteteve kompetente, Shtetet Anëtare, pavarësisht sanksioneve të tjera që do të vendosen, parashikojnë pezullimin e të drejtave përkatëse të votimit ose pavlefshmërinë e votave të hedhura ose mundësinë e anulimit të tyre.

### Seksioni 3

#### Sekreti profesional dhe shkëmbimi i informacionit

##### Neni 24

#### **Detyrimi**

Shtetet Anëtare parashikojnë që të gjithë personat që punojnë ose kanë punuar për autoritetet kompetente, si dhe audituesit dhe ekspertët që veprojnë për llogari të autoriteteve kompetente, t'i nënshtrohen detyrimit të sekretit profesional.

Në pajtim me këtë detyrim dhe pa cenuar rastet e mbuluara nga e drejta penale, asnjë informacion konfidencial që marrin në përmbushje të detyrave të tyre nuk mund t'u deklarohet personave ose autoriteteve të tjera cilado qofshin, përveç se në formë të përmbledhur ose të agreguar, në mënyrë që të mos identifikohen ndërmarrjet e veçanta risiguroese.

Megjithatë, nëse një ndërmarrje risigurimi është deklaruar e falimentuar ose është në administrim të detyruar, informacioni konfidencial që nuk ka të bëjë me palët e treta në përpjekje për të shpëtuar atë ndërmarrje mund të bëhet i ditur në procese civile ose tregtare.

##### Neni 25

#### **Shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare**

Neni 24 nuk i pengon autoritetet kompetente të Shteteve të ndryshme Anëtare të shkëmbejnë informacion në pajtim me direktivat e zbatueshme për ndërmarrjet risiguroese. Ky informacion u nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të parashikuar në nenin 24.

##### Neni 26

#### **Marrëveshjet e bashkëpunimit me vendet e treta**

Shtetet Anëtare mund të përfundojnë marrëveshje bashkëpunimi që parashikojnë shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente të vendeve të tjera sipas përkufizimit në nenin 28 pika 1 dhe 2, vetëm nëse informacioni i deklaruar u nënshtrohet garancive të sekretit profesional të paktën të

barasvlershme me ato të përmendura në këtë Seksion. Ky shkëmbim informacioni ka për synim përmbushjen e detyrës mbikëqyrëse të autoriteteve ose organeve të përmendura.

Nëse informacioni e ka origjinën në një Shtet tjetër Anëtar, ai nuk mund të deklarohet pa pëlqimin specifik të autoriteteve kompetente që e kanë bërë të ditur dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat këto autoritete kanë dhënë pëlqimin e tyre.

Neni 27

### **Përdorimi i informacionit konfidencial**

Nëse informacioni e ka origjinën në një Shtet tjetër Anëtar, ai nuk mund të deklarohet pa pëlqimin specifik të autoriteteve kompetente që e kanë bërë të ditur dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat këto autoritete kanë dhënë pëlqimin e tyre.

(a) për të verifikuar përmbushjen e kushteve që rregullojnë fillimin e veprimtarisë të risigurimit dhe për të lehtësuar monitorimin e sjelljes së kësaj veprimtarie, veçanërisht në lidhje me monitorimin e provigjoneve teknike, niveleve të aftësisë paguese, procedurave administrative dhe kontabile dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm,

(b) për vendosjen e sanksioneve,

(c) në ankimet administrative kundër veprimeve të autoriteteve kompetente, ose

(d) në proceset gjyqësore të çelura nenit 53 ose sipas dispozitave të veçanta të parashikuara në këtë direktivë ose direktivat e tjera të miratuara në fushën e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe risiguruese..

Neni 28

### **Shkëmbimi i informacionit me autoritetet e tjera**

1. Nenet 24 dhe 27 nuk përjashtojnë shkëmbimin e informacionit brenda një Shteti Anëtar, nëse ka dy ose më shumë autoritete kompetente në të njëjtin Shtet Anëtar ose, ndërmjet Shteteve Anëtare, ndërmjet autoriteteve kompetente dhe:

(a) autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen zyrtare të institucioneve të kreditit dhe organizatave të tjera financiare dhe autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve financiare,

(b) organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe risiguruese dhe në procedura të tjera të ngjashme, dhe

(c) personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të ndërmarrjeve të sigurimeve, ndërmarrjeve risiguruese dhe institucioneve të tjera financiare,

në përmbushje të funksioneve të tyre mbikëqyrëse, ose deklarimin tek organet që administrojnë procedurat e administrimit të detyruara ose skemat e garancisë të informacionit të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Informacioni i marrë nga këto autoritete, organe dhe persona u nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të parashikuar në nenin 24.

2. Pavarësisht neneve 24 deri 27, Shtetet Anëtare mund të autorizojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe:

(a) autoriteteve përgjegjës për mbikëqyrjen e organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe risiguruese dhe procedurat e tjera të ngjashme, ose

(b) autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e personave të ngarkuar me kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe risiguruese, institucioneve të kreditit, firmave të investimeve dhe institucioneve të tjera financiare, ose

(c) aktuarëve të pavarur të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe risiguruese që kryejnë mbikëqyrjen ligjore të atyre ndërmarrjeve dhe organeve përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtyre aktuarëve.

Shtetet Anëtare të cilat kanë mundësinë e opsionit të parashikuar në nënparagrafin e parë kërkojnë që të paktën të përmbushen kushtet e mëposhtme:

(a) ky shkëmbim informacioni të jetë për qëllimin e kryerjes së kontrollit mbikëqyrës ose mbikëqyrjes ligjore të përmendur në paragrafin e parë;

(b) informacioni i marrë në këtë kuadër t' u nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të parashikuar në nenin 24;

(c) nëse informacioni e ka origjinën në një Shtet tjetër Anëtar, ai nuk mund të deklarohet pa pëlqimin specifik të autoriteteve kompetente që e kanë bërë të ditur dhe, sipas rastit, mund të deklarohet vetëm për qëllimet për të cilat këto autoritete kanë dhënë pëlqimin e tyre.

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare emrat e autoriteteve, personave dhe organeve që mund ta marrin informacionin në pajtim me këtë pikë.

Pavarësisht neneve nga 24 deri 27, Shtetet Anëtare, me synim fuqizimin e qëndrueshmërisë, duke përfshirë integritetin, e sistemit financiar, autorizojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve ose organeve përgjegjëse sipas ligjit për zbulimin dhe hetimin e shkeljeve të legjislacionit për shoqëritë tregtare.

Shtetet Anëtare të cilat kanë mundësinë e opsionit të parashikuar në nënparagrafin e parë kërkojnë që të paktën të përmbushen kushtet e mëposhtme:

(a) informacioni të jetë për qëllimin e kryerjes së detyrës të përmendur në nënparagrafin e parë;

(b) informacioni i marrë në këtë kuadër t' u nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të parashikuara në nenin 24;

(c) nëse informacioni e ka origjinën në një Shtet tjetër Anëtar, ai nuk mund të deklarohet pa pëlqimin specifik të autoriteteve kompetente që e kanë bërë të ditur dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat këto autoritete kanë dhënë pëlqimin e tyre.

Nëse në një Shtet Anëtar, autoritetet ose organet e përmendura në paragrafin e parë e kryejnë detyrën e tyre të zbulimit ose hetimit, në mbështetje të kompetencës së tyre të veçantë, me ndihmën e personave të caktuar për këtë qëllim dhe që nuk janë punësuar në sektorin publik, mundësia e shkëmbimit të informacionit të parashikuar në paragrafin e parë mund të shtrihet tek këta persona sipas kushteve të parashikuara në paragrafin e dytë.

Me qëllim që të zbatohet shkronja “c” e paragrafit të dytë, autoritetet ose organet e përmendura në paragrafin e parë u komunikojnë autoriteteve kompetente që kanë bërë të ditur informacionin emrat dhe përgjegjësitë e sakta të personave të cilëve do t'u dërgohet.

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare emrat e autoriteteve ose organeve që mund të marrin informacionin në pajtim me këtë pikë.

Neni 29

### **Transmetimi i informacionit bankave qendrore dhe autoriteteve monetare**

Ky seksion nuk e pengon një autoritet kompetent t'u transmetojë bankave qendrore dhe organeve të tjera me një funksion të ngjashëm në cilësinë e tyre si autoritete monetare dhe, sipas rastit, autoriteteve të tjera publike përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, informacionin e synuar për përmbushjen e detyrave të tyre. Ky nuk i pengon këto autoritete ose organe as në komunikimin autoriteteve kompetente të atij informacioni që atyre mund t'u duhet për qëllimet e nenit 27.

Informacioni i marrë në këtë kontekst u nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të vendosura në këtë Seksion.

Neni 30

### **Deklarimi i informacionit administratave qeveritare përgjegjëse për legjislacionin financiar**

Pavarësisht neneve 24 dhe 27, Shtetet Anëtare, sipas dispozitave të parashikuara me ligj, autorizojnë deklarinimin e informacioneve të caktuara për departamente të tjera të administratave të qeverive të tyre qendrore përgjegjëse për legjislacionin për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit, institucioneve financiare, shërbimeve të investimeve dhe ndërmarrjeve të sigurimeve dhe risiguruese dhe për inspektorët që veprojnë për llogari të këtyre departamenteve.

Megjithatë, këto deklarime mund të bëhen vetëm nëse është e nevojshme për arsyet e kontrollit mbikëqyrës.

Megjithatë, Shtetet Anëtare parashikojnë që informacioni i marrë sipas neneve 25 dhe 28 pika 1 dhe ai i marrë me anë të verifikimit në vend të përmendur në nenin 16 nuk mund të deklarohet asnjëherë në rastet e përmendura në këtë Nen, përveç se me pëlqimin specifik të autoriteteve kompetente që kanë dhënë informacionin ose të autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin është bërë verifikimi në vend.

Seksioni 4

Detyrat e audituesve

Neni 31

### **Detyrat e auditëve**

Shtetet Anëtare parashikojnë të paktën që çdo person i autorizuar në pajtim me Direktivën 84/253/KEE (19), i cili në ndërmarrjen risiguruese kryen detyrën e përshkruar në nenin 51 të Direktivës 78/660/KEE (20), nenin 37 të Direktivës 83/349/KEE ose nenin 31 të Direktivës 85/611/KEE (21) ose një detyrë tjetër ligjore, ka për detyrë të raportojë menjëherë tek autoritetet kompetente çdo fakt ose vendim në lidhje me atë ndërmarrje për të cilin ai/ajo ka ardhur në dijeni në ushtrim të detyrës, që mund:

(a) të jetë një shkëlqje materiale e akteve ligjore, nënligjore ose administrative që përcaktojnë kushtet që rregullojnë autorizimin ose që rregullojnë në mënyrë specifike ndjekjen e veprimtarive të ndërmarrjeve të sigurimeve ose risiguruese, ose

(b) të ndikojë në funksionimin e vazhdueshëm të ndërmarrjes risiguruese, ose

(c) të çojë në refuzimin për të certifikuar llogaritë ose në opinion me rezerva.

Ky person ka gjithashtu detyrën për të raportuar për çdo fakt dhe vendim për të cilin ai/ajo vjen në dijeni në përmbushje të një detyre të përkrahur në paragrafin e parë në një ndërmarrje që ka lidhje të ngushta që rrjedhin nga një marrëdhënie kontrolli me ndërmarrjen e risigurimit brenda së cilës ai/ajo kryen detyrën e sipërpërmendur.

Deklarimi para autoriteteve kompetente nga personat e autorizuar në pajtim me Direktivën 84/253/KEE të çdo fakti ose vendimi të përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk përbën shkëlqje të ndonjë kufizimi mbi deklarin e informacionit të caktuar me kontratë ose me dispozitë ligjore, nënligjore ose administrative dhe nuk i përfshin këta persona në përgjegjësinë e asnjë lloji.

## KAPITULLI 2

### RREGULLAT NË LIDHJE ME PROVIGJONET TEKNIKE

#### Neni 32

#### **Krijimi i provigjoneve teknike**

Shteti Anëtar i origjinës i kërkon çdo ndërmarrjeje risigurimi të krijojë provigjoneve të mjaftueshme teknike në lidhje me të gjithë veprimtarinë e saj.

Shuma e këtyre provigjoneve teknike përcaktohet në pajtim me rregullat që janë parashikuar në Direktivën 91/674/KEE. Sipas rastit, Shteti Anëtar i origjinës mund të vendosë rregulla më specifike në pajtim me nenin 20 të Direktivës 2002/83/KE.

Shtetet Anëtare nuk mbajnë apo miratojnë asnjë sistem me rezerva bruto që kërkon rëndimin me barrë të aktiveve për të mbuluar provigjonet për primet e pafituara dhe dëmet pezull nëse risiguresi është një ndërmarrje risiguruese e autorizuar në pajtim me këtë direktivë ose një ndërmarrje sigurimesh e autorizuar në pajtim me Direktivën 73/239/KEE ose 2002/83/KE.

Nëse Shteti Anëtar i origjinës lejon mbulimin e provigjoneve teknike me pretendime kundrejt risiguresve të cilët nuk janë autorizuar në pajtim me këtë direktivë ose ndërmarrjeve të sigurimeve që nuk janë autorizuar në pajtim me Direktivat 73/239/KEE ose 2002/83/KE, ai cakton kushtet për pranimin e këtyre pretendimeve.

#### Neni 33

#### **Provigjoneve e barazimit të dëmeve**

1. Shteti Anëtar i origjinës i kërkon çdo ndërmarrjeje risigurimi që risiguron risqet e përfshira në klasën 14 të renditura në pikën A të shtojcës të Direktivës 73/239/KEE të krijojë një rezervë balancimi për qëllimin e kompensimit të çdo deficiti teknik ose të raportit të dëmeve mbi mesataren në atë klasë për çdo vit financiar.

2. Provigjoni i barazimit të dëmeve për risigurimin e kredisë llogaritet në pajtim me rregullat e caktuara nga Shteti Anëtar i origjinës në pajtim me një prej katër metodave të përcaktuara në pikën D të Shtojcës së Direktivës 73/239/KEE, e cila konsiderohet si e barasvlershme.

3. Shteti Anëtar i origjinës mund të përjashtojë ndërmarrjet risiguroese nga detyrimi për të krijuar provigjoneve të barazimit të dëmeve për risigurimin e veprimtarisë të sigurimit të kredisë nëse primet ose kontributet e arkëtueshme në lidhje me risigurimin e sigurimit të kredisë janë më pak se 4% e primeve ose kontributeve të përgjithshme të arkëtueshme prej tyre dhe më pak se 2 500 000 Euro.

4. Shteti Anëtar i origjinës mund t'i kërkojë çdo ndërmarrjeje risiguroese të krijojë provigjoneve të barazimit të dëmeve për klasat e risqeve të ndryshme nga risigurimi i kredisë. Provigjonet e barazimit të dëmeve llogariten në pajtim me rregullat e vendosura nga Shteti Anëtar i origjinës.

Neni 34

Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike

1. Shteti Anëtar i origjinës i kërkon çdo ndërmarrjeje risigurimi të investojë aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe provigjonin e barazimit të dëmeve të përmendur në nenin 33 në pajtim me rregullat e mëposhtme:

(a) aktivitet marrin parasysh llojin e veprimtarisë që kryhet nga një ndërmarrje risigurimi, veçanërisht natyrën, shumën dhe kohëzgjatjen e pagesave të pritshme të dëmeve, në një mënyrë të tillë që të sigurohet mjaftueshmëria, likuiditeti, siguria, cilësia, përfitueshmëria dhe përputhja e investimeve të saj;

(b) ndërmarrja risiguroese siguron që aktivitet të jenë të larmishme dhe të shpërndara në mënyrë të përshtatshme dhe t'i mundësojnë ndërmarrjes të reagojë në mënyrë të përshtatshme ndaj rrethanave ekonomike që ndryshojnë, veçanërisht ndaj zhvillimeve në tregjet financiare dhe tregjet e pasurive të paluajtshme ose ngjarjet katastrofike madhore. Ndërmarrja vlerëson ndikimin e rrethanave të pazakonta në treg mbi aktivitet e saj dhe i diversifikon aktivitet në një mënyrë të tillë që ta zbutë këtë ndikim;

(c) investimi në aktive që nuk pranohen për tregtim në një treg të rregulluar financiar në çdo rast mbahen në nivele të arsyeshme;

(d) investimi në instrumente derivative është i mundshëm në masën që ato kontribuojnë në uljen e risqeve të investimit ose lehtësojnë menaxhimin efiçent të portofolit. Ato vlerësohen mbi një bazë të arsyeshme, duke marrë parasysh aktivitet përkatëse dhe përfshihen në vlerësimin e aktiveve të institucionit. Institucioni gjithashtu mënjanon ekspozimin e tepërt ndaj riskut kundrejt një pale ose operacioneve të tjera derivative.

(e) sendet pasurore diversifikohen në mënyrë të përshtatshme në një mënyrë të tillë që të mënjanohet mbështetja e tepërt tek një aktiv i veçantë, emetues ose grup ndërmarrjesh dhe akumulimet e riskut në portofol si një i tërë. Investimet në aktivitet e emetuara nga i njëjti emetues ose nga emetues që i përkasin të njëjtit grup nuk e ekspozojnë ndërmarrjen ndaj përqendrimit të tepër të riskut. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos zbatojnë kërkesat e përmendura në shkronjën “e” për investimet në obligacionet qeveritare.

2. Shtetet Anëtare nuk u kërkojnë ndërmarrjeve risiguroese që gjenden në territorin e tyre të investojnë në kategori të veçanta të aktiveve.

3. Shtetet Anëtare nuk ia nënshtrojnë vendimet e investimeve të ndërmarrjes së risigurimit që gjendet në territorin e tyre ose të administruesit të investimeve të asaj ndërmarrjeje asnjë lloji aprovimi paraprak apo kërkesash njoftimi sistematik.

4. Pavarësisht pikave nga 1 deri në 3, Shteti Anëtar i origjinës, për çdo ndërmarrje risigurimi secila e së cilës është në territorin e saj, mund të vendosë rregullat e mëposhtme sasiore, me kusht që të jenë të justifikuar me maturi:

(a) investimet e provigjoneve teknike bruto në monedha të ndryshme nga ato të cilat janë caktuar provigjonet teknike të mos jenë më shumë se 30%;

(b) investimet e provigjoneve teknike bruto në aksione dhe letra me vlerë të tjera të negociueshme të trajtuara si aksione, obligacione dhe letra me vlerë të borxhit, të cilat nuk pranohen për tregtim në një treg të rregulluar të mos jenë më shumë se 30%;

(c) Shteti Anëtar i origjinës mund të kërkojë që çdo ndërmarrje risigurimi të investojë jo më shumë se 5% të provigjoneve të saj teknike bruto në aksione dhe letra të tjera me vlerë të negociueshme të trajtuar si aksione, obligacione, letra me vlerë të borxhit dhe para të tjera dhe instrumente të tregut të kapitalit nga e njëjta ndërmarrje, dhe jo më shumë se 10% të provigjoneve të saj teknike në aksione dhe dhe letra të tjera me vlerë të negociueshme të trajtuar si aksione, obligacione, letra me vlerë të borxhit dhe para të tjera dhe instrumente të tregut të kapitalit nga ndërmarrjet që janë anëtarë të të njëjtit grup.

Për më tepër, Shteti Anëtar i origjinës cakton rregulla më të hollësishme duke vendosur kushte për përdorimin e shumave të mbetura nga një mjet me qëllime të veçanta si aktive në mbulim të provigjoneve teknike në pajtim me këtë nen.

### KAPITULLI 3

#### RREGULLAT NË LIDHJE ME NIVELIN E AFTËSISË PAGUESE DHE FONDIN E GARANCISË

##### Seksioni 1

##### Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese

##### Neni 35

#### **Rregull i përgjithshëm**

Secili Shtet Anëtar i kërkon gjithmonë çdo ndërmarrjeje risiguruese me zyra qendrore në territorin e saj, një nivel të mjaftueshëm të disponueshëm të aftësisë paguese në lidhje me të gjithë veprimtarinë e saj, i cili të jetë të paktën i barabartë me kërkesat e kësaj direktive.

##### Neni 36

#### **Zërat që mund të përfshihen**

1. Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese përbëhet nga të gjitha aktivet e ndërmarrjes siguruese të pazëna me asnjë pasiv të parashikueshëm, duke zbritur çdo zë jomaterial, duke përfshirë:

(a) kapitalin aksionar të paguar ose, në rastin e një ndërmarrjeje të përbashkët risigurimi, fondin faktik fillestar duke shtuar llogaritë e ortakëve që përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme:



(i) akti i themelimit dhe statuti parashikon që pagesat mund të bëhen nga këto llogari për ortakët vetëm në masën që kjo nuk bën që niveli i disponueshëm i aftësisë paguese të bjerë poshtë nivelit të kërkuar ose, nëse, pas prishjes së ndërmarrjes, janë paguar të gjitha borxhet e ndërmarrjes;

(ii) akti i themelimit dhe statuti parashikon që, në lidhje me çdo pagesë të përmendur në pikën (i) për shkaqe të ndryshme nga pushimi individual i anëtarësisë, autoritetet kompetente duhet të njoftohen të paktën një muaj paraprakisht dhe brenda asaj periudhe mund të ndalojnë pagesën;

(iii) dispozitat përkatëse të aktit të themelimit dhe statutit mund të ndryshohen vetëm pasi autoritetet kompetente të kenë deklaruar që ato nuk kanë kundërshtim për ndryshimin, pa cenuar kriteret e shprehura në pikat (i) dhe (ii);

(b) rezervat ligjore dhe të lira që nuk i përkasin marrjes përsipër të detyrimeve dhe nuk klasifikohen si provigjoneve të barazimit të dëmeve;

(c) fitimin ose humbjen e mbartur pas zbritjes së dividendëve që duhet të paguhet.

2. Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese zvogëlohet me shumën e aksioneve të veta që mbahen drejtpërdrejt nga ndërmarrja risiguruese.

Për ato ndërmarrje risigurimi të cilat i skontojnë ose zvogëlojnë provigjonet e tyre teknike të jo-jetës për pretendimet e patrajuara për të marrë parasysh të ardhurat nga investimet sipas parashikimit në nenin 60 pika 1 shkronja “g” të Direktivës 91/674/KEE, niveli i disponueshëm i aftësisë paguese zvogëlohet me diferencën ndërmjet provigjoneve teknike të paskontuara ose provigjoneve teknike para skontimeve, siç pasqyrohen në shënimet shpjeguese të llogarive dhe provigjoneve teknike ose të skontuara pas skontimeve. Ky veprim rregullues bëhet për të gjitha risqet e renditura në pikën A të shtojcës së Direktivës 73/239/KEE, përveç risqeve të renditura në klasat 1 dhe 2 të pikës A të asaj shtojce. Për klasat e ndryshme nga 1 dhe 2 të renditura në pikën A të asaj shtojce, nuk është e nevojshme të bëhet asnjë përshtatje në lidhje me skontimin e shumave vjetore të përfshira në provigjonet teknike. Përveç skontimeve të paragrafëve të parë dhe të dytë, niveli i disponueshëm i aftësisë paguese zvogëlohet me zërat e mëposhtëm:

(a) pjesëmarrjet që ndërmarrja risiguruese ka në subjektet e mëposhtme:

(i) ndërmarrjet e sigurimeve brenda kuptimit të nenit 6 të Direktivës 73/239/KEE, nenit 4 të Direktivës 2002/83/KE ose nenit 1 shkronja “b” të Direktivës 98/78/KE,

(ii) ndërmarrjet risiguruese brenda kuptimit të nenit 3 të kësaj direktive ose ndërmarrjet risiguruese të vendeve të treta brenda kuptimit të nenit 1 shkronja “l” të Direktivës 98/78/KE,

(iii) shoqëritë financiare tip holding brenda kuptimit të nenit 1 shkronja “i” të Direktivës 98/78/KE,

(iv) institucionet e kreditit dhe institucionet financiare brenda kuptimit të nenit 1 pika 1 dhe 5 të Direktivës 2000/12/KE,

(v) firmat e investimeve dhe institucionet financiare brenda kuptimit të nenit 1 pika 2 të Direktivës 93/22/KEE(22) dhe të nenit 2 pika 4 dhe 7 të Direktivës 93/6/KEE(23),

(b) secili prej zërave të mëposhtëm që një shoqëri risiguruese ka në lidhje me subjektet e përkufizuara në shkronjën “a” në të cilat ajo ka një pjesëmarrje:

(i) instrumentet e përmendura në pikën 4,

(ii) instrumentet e përmendura në nenin 27 pika 3 të Direktivës 2002/83/KE;

(iii) të drejtat e nënrenditura dhe instrumentet e përmendura në nenin 35 pika 3 të Direktivës 2000/12/KEE;

Nëse aksionet në një institucion tjetër krediti, firmë investimesh, institucion financiar, ndërmarrje sigurimesh dhe risigurimi ose shoqëri sigurimesh tip holding mbahen përkohësisht për qëllimet e një operacioni asistence financiare të destinuar për të riorganizuar dhe shpëtuar subjektin, autoriteti kompetent mund të mos zbatojë dispozitat për zbritjen e përmendur në shkronjën “a” dhe “b” të paragrafit të tretë.

Si alternativë për zbritjet e zërave të përmendur në shkronjën “a” dhe “b” të paragrafit të tretë që ndërmarrja risiguroese ka në institucionet e kreditit, firmat e investimeve dhe institucionet financiare, Shtetet Anëtare mund të lejojnë ndërmarrjet e tyre risiguroese të zbatojnë, duke i përshtatur sipas rastit, metodat 1, 2 ose 3 të Shtojcës I të Direktivës 2002/87/KE. Metoda 1 (Konsolidimi kontabël) zbatohet vetëm nëse autoriteti kompetent ka besim në lidhje me nivelin e administrimit të integruar dhe kontrollit të brendshëm në lidhje me subjektet që do të përfshiheshin në objektin e konsolidimit. Metoda e zgjedhur zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme me kalimin e kohës.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që për llogaritjen e nivelit të aftësisë paguese sipas parashikimit të kësaj direktive, ndërmarrjet risiguroese që i nënshtrohen mbikëqyrjes shitesë në pajtim me Direktivën 98/78/KE ose mbikëqyrjes shitesë në pajtim me Direktivën 2002/87/KE nuk e kanë të nevojshme të zbresin zërat e përmendur në shkronjën “a” dhe “b” të paragrafit të tretë që mbahen në institucionet e kreditit, firmat e investimeve, institucionet financiare ose ndërmarrjet risiguroese ose ndërmarrjet e sigurimeve tip holding të cilat përfshihen në mbikëqyrjen shitesë. Për qëllimet e zbritjes së pjesëmarrjeve të përmendura në këtë paragraf, pjesëmarrje do të thotë një pjesëmarrje në kuptimin e nenit 1 shkronja “f” të Direktivës 98/78/KE.

3. Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese mund të përbëhet edhe nga:

(a) kapitali i aksioneve progresive me përparësi dhe kapitali i huave të nënrenditura deri në 50% të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese ose nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, cilado të jetë më e vogla, ku jo më shumë se 25% e të cilit përbëhet nga hua të nënrenditura me maturim fiks ose nga kapital i aksioneve progresive me përparësi me afat fiks, me kusht që në rastin e falimentimit ose likuidimit të ndërmarrjes risiguroese, të ekzistojnë marrëveshje detyruese sipas të cilave kapitali i huave të nënrenditura ose kapitali i aksioneve me përparësi të renditet pas të drejtave të të gjithë kreditorëve të tjerë dhe të mos shlyhet pa u shlyer të gjitha borxhet e pashlyera në atë moment. Kapitali i huave të nënrenditura përmbush edhe kushtet e mëposhtme:

(i) mund të merren parasysh vetëm fondet e paguara plotësisht;

(ii) për huatë me datë fikse maturimi, maturimi fillestar është të paktën pesë vjet. Jo më vonë se një vit para datës së shlyerjes ndërmarrja risiguroese u paraqet autoriteteve kompetente për aprovim një plan i cili tregon si niveli i disponueshëm i aftësisë paguese mbahet ose sillet në nivelin e kërkuar në maturim, përveç kur masa në të cilën huaja mund të renditet si një pjesë përbërëse e nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese të zvogëlohet gradualisht gjatë të paktën pesë viteve të fundit para datës së shlyerjes. Autoritetet kompetente mund të autorizojnë shlyerjen e parakohshme të këtyre huave, me kusht që kërkesa të jetë bërë nga ndërmarrja risiguroese dhënëse dhe niveli i saj i disponueshëm i aftësisë paguese të mos bjerë poshtë nivelit të kërkuar;

(iii) huatë, maturimi i të cilave nuk është fikse, janë të shlyeshme vetëm duke iu nënshtruar njoftimit pesëvjeçar, përveç kur huatë nuk vazhdojnë të konsiderohen si pjesë përbërëse e nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese, ose përveç kur pëlqimi paraprak i autoriteve kompetente kërkohet shprehimisht për shlyerjen e parakohshme. Në rastin e fundit, ndërmarrja risiguruese njofton autoritetet kompetente të paktën gjashtë muaj para datës së shlyerjes së propozuar, duke specifikuar nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese para dhe pas shlyerjes. Autoritetet kompetente e autorizojnë shlyerjen vetëm nëse niveli i disponueshëm i aftësisë paguese të ndërmarrjes risiguruese nuk bie poshtë nivelit të kërkuar;

(iv) marrëveshja e huasë nuk përfshin asnjë klauzolë që të parashikojë që në rrethana të caktuara, përveç likuidimit të ndërmarrjes risiguruese, borxhi bëhet i shlyeshëm para datave të rena dakord për shlyerjen;

(v) marrëveshja e huasë mund të ndryshohet vetëm pasi autoritetet kompetente të kenë deklaruar që ata nuk kanë asnjë kundërshtim për ndryshimin;

(b) letrat me vlerë që nuk kanë datë të specifikuar maturimi dhe instrumentet e tjerë, duke përfshirë aksionet progresive me përparësi pa përfshirë ato që përmenden në shkronjën “a”, deri në 50% të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese dhe të nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, cilido të jetë më i vogël, për totalin e këtyre letrave me vlerë dhe kapitalin e huave të nënrenditura të përmendura në pikën shkronjën “a”, me kusht që ato të përmbushin sa më poshtë:

(i) ato nuk mund të shlyhen me iniciativën e zotëruesit ose pa pëlqimin paraprak të autoritetit kompetent;

(ii) kontrata e emetimit i jep mundësi ndërmarrjes risiguruese të shtyjë pagesën e interesit mbi huanë;

(iii) të drejtat e huadhënësit kundrejt ndërmarrjes risiguruese duhet të renditen tërësisht pas të gjithë kreditorëve jo të nënrenditur;

(iv) dokumentet që rregullojnë emetimin e letrave me vlerë parashikojnë mundësinë e rikuperimit të humbjeve nga borxhet dhe të interesat e papaguar, duke i dhënë mundësi ndërmarrjes risiguruese të vazhdojë veprimtarinë;

(v) mund të merren parasysh vetëm shumat e paguara plotësisht;

4. Me kërkesë të shoqëruar me dokumente mbështetëse të ndërmarrjes risiguruese drejtuar autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e autoritetit kompetent, niveli i disponueshëm i aftësisë paguese mund të përbëhet nga:

(a) gjysma e kapitalit aksionar të papaguar ose fondit fillestar, nëse pjesa e paguar arrin në 25% të këtij kapitali aksionar ose fondi, deri në 50% të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese dhe të nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, cilado të jetë më e vogël;

(b) në rastin e shoqatës së përbashkët të sigurimit jo-jetë ose të ngjashme me të me kontribute të ndryshueshme, çdo pretendim që ajo ka kundrejt anëtarëve të saj nëpërmjet kërkimit të një kontributi shtesë, brenda vitit financiar, deri në gjysmën e diferencës ndërmjet kontributeve maksimale dhe kontributeve të kërkuara faktikisht dhe deri në një limit prej 50% të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese dhe nivelit të kërkuar të aftësisë paguese cilido të jetë më i vogël. Autoritetet kompetente kombëtare vendosin orientime që caktojnë kushtet në të cilat mund të pranohen kontributet shtesë

(c) çdo rezervë neto e fshehur që rrjedh nga vlerësimi i aktiveve, në masën që këto rezerva neto të fshehura nuk janë të një natyre të jashtëzakonshme.

5. Përveç kësaj, në lidhje me veprimtaritë risiguroese të jetës, me kërkesë të shoqëruar me dokumente mbështetëse të ndërmarrjes risiguroese drejtuar autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e autoritetit kompetent, niveli i disponueshëm i aftësisë paguese mund të përbëhet nga:

(a) deri më 31 dhjetor 2009, një shumë të barabartë me 50% të fitimeve të ardhshme të ndërmarrjes, por që nuk kalon 25% të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese ose nivelin të kërkuar të aftësisë paguese, cilado të jetë më e vogël; shuma e fitimeve të ardhshme gjendet duke shumëzuar fitimin e çmuar vjetor me një koeficient që përfaqëson afatin mesatar të mbetur për policat në fuqi; koeficienti i përdorur nuk mund të jetë më i madh se gjashtë; fitimi vjetor i çmuar nuk kalon mesataren aritmetike të fitimeve të marra gjatë pesë viteve të fundit financiarë në këto veprimtari të renditura në nenin 2 pika 1 të Direktivës 2002/83/KE.

Autoritetet kompetente mund të bien dakord të përfshijnë një shumë të tillë për nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese:

(i) nëse është paraqitur një raport aktuarial tek autoritetet kompetente që mbështet probabilitetin e lindjes së këtyre fitimeve në të ardhmen; dhe

(ii) në masën që ajo pjesë e fitimeve të ardhshme që del nga rezervat neto të fshehura të përmendura në pikën 4 shkronja “c” nuk është marrë parasysht;

(b) nëse zillmerizimi nuk përdoret, apo, nëse përdoret, është më i vogël se shtesa e kostos së përfuturit të përfshirë në prim, diferenca ndërmjet një provigjoni matematikor të pazillmerizuar ose të zillmerizuar pjesërisht dhe një provigjoni matematikor të zillmerizuar me një normë të barabartë me shtesën për koston e përfuturit të përfshirë në premie; megjithatë, kjo shifër nuk mund të kalojë 3,5 % të shumës së diferencave ndërmjet shumave përkatëse të kapitalit të veprimtarive të risigurimit të jetës dhe provigjoneve matematikore për të gjitha policat për të cilat është i mundshëm zillmerizimi; diferencës i zbritet shuma e të gjithë kostos së paamortizuar të marrjes në pronësi të regjistruar si aktiv.

Ndryshimet e pikave nga 1 deri në 5 të këtij neni, të cilat marrin parasysht zhvillimet që motivojnë një përshtatje teknike të elementëve që lejohen të përfshihen në nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese, miratohen në pajtim me procedurën e parashikuar në nenin 55 pika 2.

## Seksioni 2

### Niveli i kërkuar i aftësisë paguese

#### Neni 37

### **Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për veprimtaritë risiguroese të jo-jetës**

1. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese përcaktohet në bazë shumëvjetore të primeve ose kontributeve ose të barrës mesatare të dëmeve për të tre vitet e fundit financiare.

Megjithatë, në rastin e ndërmarrjeve risiguroese që sigurojnë në thelb vetëm një ose më shumë prej risqeve të kredisë, stuhive, breshërit ose ngricave, për barrën mesatare të dëmeve merren si bazë shtatë vitet e fundit financiare.

2. Në pajtim me nenin 40, shuma e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese është e barabartë me shumën më të madhe të dy rezultateve sipas parashikimit në pikën 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Baza e primit llogaritet duke përdorur shumën më të madhe të primeve ose kontributeve bruto të shkruara siç llogariten më poshtë dhe primeve ose kontributeve bruto të fituara.

Primet ose kontributet në lidhje me klasat 11, 12 dhe 13 të renditura në pikën A të Shtojcës së Direktivës 73/239/KEE rriten me 50%.

Primet ose kontributet në lidhje me klasat e ndryshme nga klasat 11, 12 dhe 13 të renditura në pikën A të Shtojcës së Direktivës 73/239/KEE mund të rritet me deri në 50% për veprimtaritë risiguroese specifike ose lloje specifike kontratash me qëllim që të merren parasysh tiparet e veçanta të këtyre veprimtarive ose kontratave, në pajtim me procedurën e përmendur në nenin 55 pika 2 të kësaj direktive. Primet ose kontributet, duke përfshirë detyrimet shtesë për primet ose kontributet, të kërkueshme në lidhje me veprimtarinë risiguroese në vitin e fundit financiar mblidhen së bashku.

Nga kjo shumë zbritet shuma e përgjithshme e primeve ose kontributeve të anuluar në vitin e fundit financiar, si dhe shuma e përgjithshme e tatimeve dhe detyrimeve të lidhura me primet ose kontributet që futen në këtë shumë. Shuma e nxjerrë në këtë mënyrë ndahet në dy pjesë, ku pjesa e parë është deri në 50 000 000 Euro, pjesa e dytë përbëhet nga pjesa e mbetur; llogariten përkatësisht 18% dhe 16% e këtyre pjesëve dhe mblidhen bashkë. Shuma e nxjerrë në këtë mënyrë shumëzohet me raportin që ekziston në lidhje me shumën e tre viteve të fundit financiare ndërmjet shumës së dëmeve që mbetet të mbulohet nga ndërmarrja risiguroese pas zbritjes së shumave të rikuperueshme sipas retrocesionit dhe shumës bruto të dëmeve; ky raport nuk mund të jetë në asnjë rast më pak se 50%. Me kërkesë të mbështetur në prova nga ndërmarrja risiguroese drejtuar autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e autoritetit, shumat e rikuperueshme nga mjetet e qëllimeve të veçanta të përmendura në nenin 46 mund të zbriten si retrocesion. Me miratimin e autoriteteve kompetente, mund të përdoren metoda statistikore për shpërndarjen e primeve ose kontributeve.

4. Baza e dëmeve llogaritet si më poshtë, duke përdorur, në lidhje me klasat 11, 12, dhe 13 të renditura në pikën A të Shtojcës së Direktivës 73/239/KEE, dëmet, provigjonet dhe rimarrjet të zmadhuara me 50%. Dëmet, provigjonet dhe rimarrjet në lidhje me klasat e ndryshme nga klasat 11, 12 dhe 13 të renditura në pikën A të Shtojcës së Direktivës 73/239/KEE mund të rritet me deri në 50% për veprimtari specifike risiguroese ose lloje specifike kontratash me qëllim që të merren parasysh tiparet e veçanta të këtyre veprimtarive ose kontratave, në pajtim me procedurën e përmendur në nenin 55 pika 2 të kësaj direktive. Shumat e dëmeve të paguara, pa zbritur dëmet e mbuluara nga risiguroesit dhe retrocesionarët, në periudhat e përcaktuara në pikën 1 mblidhen bashkë. Kësaj shume i shtohet shuma e rezervave për dëmet pezull të vendosura në fund të vitit të fundit financiar.

Kësaj shume i zbritet shuma e rimarrjeve të realizuara gjatë periudhave të specifikuar në pikën 1.

Shumës së mbetur i zbritet shuma e provigjoneve për dëmet pezull të krijuara në fillimin e vitit të dytë financiar që është para vitit të fundit financiar për të cilin ka llogari. Nëse periudha bazë e vendosur në pikën 1 është e barabartë me shtatë vjet, zbritet shuma e provigjoneve për dëmet pezull të krijuara në fillim të vitit të gjashtë financiar që është para vitit të fundit financiar për të cilin ka llogari. Një e treta ose një e shtata e shumës së gjetur në këtë mënyrë, sipas periudhës bazë të vendosur në pikën 1, ndahet në dy pjesë, ku pjesa e parë është deri në 35 000 000 Euro, pjesa e dytë përbëhet nga pjesa e mbetur; llogariten përkatësisht 26 % dhe 23 % e këtyre pjesëve dhe mblidhen bashkë. Shuma e nxjerrë në këtë mënyrë shumëzohet me raportin që ekziston në lidhje me shumën e tre viteve të fundit financiarë ndërmjet shumës së dëmeve që mbetet të mbulohet nga ndërmarrja pas zbritjes së shumave

të rikuperueshme sipas retrocesionit dhe shumës bruto të dëmeve; ky raport nuk mund të jetë në asnjë rast më pak se 50%. Me kërkesë të mbështetur në prova nga ndërmarrja risiguruese drejtuar autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e autoritetit, shumat e rikuperueshme nga mjetet e qëllimeve të veçanta të përmendura në nenin 46 mund të zbriten si retrocesion. Me miratimin e autoriteteve kompetente, mund të përdoren metoda statistikore për shpërndarjen e dëmeve, provigjoneve dhe rimarrjeve.

5. Nëse niveli i kërkuar i aftësisë paguese i llogaritur në pikat 2, 3 dhe 4 është më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese i vitit të mëparshëm, niveli i kërkuar i aftësisë paguese është të paktën i barabartë me nivelin e kërkuar të aftësisë paguese të vitit të mëparshëm i shumëzuar me raportin e shumës së provigjoneve teknike për dëmet pezull në mbyllje të vitit të fundit financiar dhe shumës së provigjoneve teknike për dëmet pezull në fillim të vitit të fundit financiar. Provigjonet teknike në këto llogaritje llogariten pa retrocesion, por raporti në asnjë rast nuk mund të jetë më i lartë se 1.

6. Fraksionet e zbatueshme për pjesët e përmendura në paragrafin e pestë të pikës 3 dhe paragrafin e shtatë të pikës 4 zvogëlohen në një të tretën në rastin e sigurimit shëndetësor të ushtruar me të njëjtën bazë teknike si sigurimi i jetës, nëse

(a) primet e paguara llogariten mbi bazën e tabelave të probabilitetit sipas metodës matematikore të zbatuar në sigurime;

(b) krijohet një provigjon për rritjen e moshës;

(c) arkëtohet një prim shtesë me qëllim që të krijohet një nivel sigurie në një shumë të përshtatshme;

(d) ndërmarrja e sigurimeve mund ta anulojë kontratën jo më vonë se para fundit të vitit të tretë të sigurimeve;

(e) kontrata parashikon mundësinë e rritjes së primeve ose uljes së pagesave edhe për kontratat në vazhdim.

Neni 38

### **Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për veprimtaritë risiguruese të jetës**

1. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për veprimtaritë risiguruese të jetës përcaktohet në pajtim me nenin 37.

2. Pavarësisht pikës 1 të këtij neni, Shteti Anëtar i origjinës mund të parashikojë që për klasat e risigurimit të veprimtarisë të sigurimeve të mbuluara nga neni 2 pika 1 shkronja “a” i Direktivës 2002/83/KE të lidhura me fondet e investimeve ose kontratat pjesëmarrëse dhe për operacionet e përmendura në nenin 2 pika 1 shkronja “b”, nenin 2 pika 2 “b”, “c”, “d” dhe “e” të Direktivës 2002/83/KE, niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të përcaktohet në pajtim me nenin 28 të Direktivës 2002/83/KE.

Neni 39

### **Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për ndërmarrjet risiguruese që kryejnë njëkohësisht risigurim të jo-jetës dhe jetës**

1. Shteti Anëtar i origjinës kërkon që çdo ndërmarrje risigurimi që ushtron veprimtari risiguruese të jo-jetës dhe jetës të ketë një nivel të disponueshëm të aftësisë paguese për të mbuluar shumën e

përgjithshme të niveleve të kërkuara të aftësisë paguese në lidhje me veprimtaritë risiguroese të jo-jetës dhe jetës që përcaktohen përkatësisht në pajtim me nenet 37 dhe 38.

2. Nëse niveli i disponueshëm i aftësisë paguese nuk arrin nivelin e kërkuar në pikën 1 të këtij neni, autoritetet kompetente zbatojnë masat e parashikuara në nenet 42 dhe 43.

### Seksioni 3

#### Fondi i garancisë

#### Neni 40

#### **Shuma e fondit të garancisë**

1. Një e treta e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese sipas parashikimit në nenet 37, 38 dhe 39 përbën fondin e garancisë. Ky fond përbëhet nga zërat e renditur në nenin 36 pika 1, 2 dhe 3 dhe, me pëlqimin e autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës, në nenin 36 pika 4 shkronja “c”.

2. Fondi i garancisë nuk është më pak se një minimum prej 3 000 000 Euro.

Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë që në lidhje me ndërmarrjet risiguroese të brendshme, fondi i garancisë minimale të mos jetë më pak se 1 000 000 Euro.

#### Neni 41

#### Rishikimi i shumës së fondit të garancisë

1. Shumat në Euro sipas parashikimit në nenin 40 pika 2 shqyrtohen çdo vit duke filluar nga data 10 dhjetor 2007 me qëllim që të merren parasysh ndryshimet në indeksin europian të çmimeve të konsumatorit që përfshin të gjithë Shtetet Anëtare siç publikohet nga Eurostati.

Shumat përshtaten automatikisht duke rritur shumën bazë në Euro me ndryshimin në përqindje në atë indeks për periudhën ndërmjet hyrjes në fuqi të kësaj direktive dhe datës së rishikimit dhe të rrumbullakosur deri në një shumëfish të 100 000 Euro.

Nëse ndryshimi në përqindje qysh nga përshtatja e fundit është më pak se 5% nuk bëhet asnjë përshtatje.

2. Komisioni informon çdo vit Parlamentin Europian dhe Këshillin për rishikimin dhe shumat e përshtatura të përmendura në pikën 1.

### KAPITULLI 4

#### **NDËRMARRJET RISIGURUESE NË VËSHTIRËSI OSE NË NJË GJENDJE TË PARREGULLT DHE TËRHEQJA E AUTORIZIMIT**

#### Neni 42

#### **Ndërmarrjet risiguroese në vështirësi**

1. Nëse një ndërmarrje risigurimi nuk respekton nenin 32, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës mund të ndalojë disponimin e lirë të aktiveve të saj pas komunikimit të këtij synimi autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare pritëse.

2. Për qëllimet e rivendosjes së situatës financiare të një ndërmarrjeje risigurimi niveli i aftësisë paguese i të cilave ka rënë poshtë minimumit të kërkuar sipas neneve 37, 38 dhe 39, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës kërkon paraqitjen për aprovim të një plani për rivendosjen e një gjendjeje të shëndoshë financiare.

Në rrethana të veçanta, nëse autoriteti kompetent është i mendimit që situata financiare e ndërmarrjes risiguroese do të përkeqësohet më tej, ai mund të kufizojë ose ndalojë gjithashtu disponimin e lirë të aktiveve të ndërmarrjes risiguroese. Ai njofton autoritetet e Shteteve të tjera Anëtare brenda territoreve të të cilëve ndërmarrja risiguroese ushtron veprimtari, për masat që ka marrë dhe këto të fundit, me kërkesë të të parave, marrin të njëjtat masa.

3. Nëse niveli i aftësisë paguese bie poshtë fondit të garancisë së përkufizuar në nenin 40, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës i kërkon ndërmarrjes risiguroese të paraqesë për aprovim një skemë financiare afatshkurtër.

Ai mund të kufizojë ose ndalojë gjithashtu disponimin e lirë të aktiveve të ndërmarrjes risiguroese. Ai njofton autoritetet e të gjitha Shteteve Anëtare dhe këto të fundit, me kërkesë të të parave, marrin të njëjtat masa.

4. Çdo Shtet Anëtar merr masat e nevojshme për të qenë në gjendje, në pajtim me ligjin e vet kombëtar, të ndalojë sipas kërkesë disponimin e lirë të aktiveve që gjenden brenda territorit, në rastet e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të Shtetit Anëtar të origjinës së ndërmarrjes risiguroese, që cakton aktivet që mbulohen nga këto masa.

#### Neni 43

### **Plani i rimëkëmbjes financiare**

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetencën të kërkojnë një plan të rimëkëmbjes financiare për këto ndërmarrje risigurimi nëse autoritetet kompetente janë të mendimit se janë në rrezik detyrimet që rrjedhin nga kontratat e risigurimit.

2. Plani i rimëkëmbjes financiare minimalisht përfshin hollësi ose prova për të tre vitet e ardhshme financiare në lidhje me:

(a) çmuarjet e shpenzimeve të administrimit, veçanërisht shpenzimet e përgjithshme rrjedhëse dhe komisionet;

(b) një plan që përfshin çmuarje të hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me pranimet në risigurim dhe cedime risigurimesh;

(c) një parashikim bilanci;

(d) parashikimet e burimeve financiare të parashikuara për të mbuluar marrjen përsipër të detyrimeve dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;

(e) politikën e përgjithshme të retrocesionit.



3. Nëse gjendja financiare e ndërmarrjes risiguruese po përkeqësohet dhe po vihen në rrezik detyrimet kontraktore të ndërmarrjes risiguruese, Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetencën ta detyrojnë ndërmarrjen risiguruese të kenë një nivel më të lartë të kërkuar të aftësisë paguese, me qëllim që të sigurojnë që ndërmarrja risiguruese të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e aftësisë paguese në të ardhmen e afërt. Ky nivel më i lartë i kërkuar i aftësisë paguese bazohet në një plan të rimëkëmbjes financiare të përmendur në pikën 1..

4. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetencën të zhvlerësojnë të gjithë elementet e përshtatshme për nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese, veçanërisht, nëse ka pasur një ndryshim të konsiderueshëm në vlerën e tregut të këtyre elementëve qysh nga fundi i vitit të fundit financiar.

5. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetencën të kufizojnë zbritjen, bazuar në retrocedim, në nivelin e aftësisë paguese sipas parashikimit në pajtim me nenet 37, 38 dhe 39, nëse:

(a) natyra ose cilësia e kontratave të retrocedimit ka ndryshuar në masë të konsiderueshme qysh nga viti i fundit financiar;

(b) nuk ka asnjë transferim të riskut sipas kontratave të retrocedimit ose ka një transferim të kufizuar të këtij risku.

6. Nëse autoritetet kompetente kanë kërkuar një plan të rimëkëmbjes financiar për ndërmarrjen risiguruese në pajtim me pikën 1 të këtij Neni, ato nuk e lëshojnë certifikatën në pajtim me nenin 18, nëse janë të mendimit që detyrimet e saj që rrjedhin nga kontratat risiguruese janë të rrezikuara në kuptimin e pikës 1.

#### Neni 44

#### **Tërheqja e autorizimit**

1. Autorizimi i dhënë një ndërmarrjeje risigurimi nga një autoritet kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës mund të tërhiqet nga ky autoritet nëse kjo ndërmarrje:

(a) nuk e përdor këtë autorizim brenda 12 muajve, heq dorë shprehimisht prej tij ose pushon së kryeri veprimtarinë për më shumë se 6 muaj, përveç kur Shteti Anëtar përkatës ka parashikuar që autorizimi në këto raste të parashkruhet;

(b) nuk vazhdon të përmbushë kushtet për pranim;

(c) nuk ka qenë në gjendje, brenda kohës së lejuar, të marrë masat e specifikuar në planin e rimëkëmbjes ose skemën financiare të përmendur në nenin 42;

(d) nuk përmbush detyrimet e veta sipas rregulloreve që u nënshtrohet.

Në rastin e tërheqjes ose parashkrimit të autorizimit, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës njofton përkatësisht autoritetet kompetente të Shteteve të tjera Anëtare dhe ato marrin masat e përshtatshme për të mos e lejuar ndërmarrjen risiguruese të fillojë operacione të reja brenda territoreve të tyre, sipas së drejtës së vendosjes apo lirisë për të ofruar shërbime.

2. Çdo vendim për tërheqjen e një autorizimi mbështetet në arsye të përpikta dhe i komunikohet ndërmarrjes risiguruese në fjalë.

## TITULLI IV

### DISPOZITA NË LIDHJE ME RISIGURIMIN E KUFIZUAR DHE MJETET ME QËLLIM TË VEÇANTË

Neni 45

#### **Risigurimi i kufizuar**

1. Shteti Anëtar i origjinës mund të vendosë dispozita specifike në lidhje me ushtrimin e veprimtarive të risigurimit të kufizuar në lidhje me:

- kushtet e detyrueshme për përfshirjen në të gjitha kontratat e nxjerra;
- procedura të shëndosha administrative dhe kontabël, mekanizma të përshtatshme të kontrollit të brendshëm dhe kërkesat e menaxhimit të riskut;
- kërkesat për informacionin e kontabilitetit, maturisë dhe statistikave;
- krijimin e provigjoneve teknike për të siguruar që janë të përshtatshme, të besueshme dhe objektive;
- investimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike me qëllim që të marrin parasysh tipin e veprimtarisë që kryhet nga një ndërmarrje risigurimi, veçanërisht natyrën, shumën dhe kohëzgjatjen e pagesave të pritshme të dëmeve, në një mënyrë të tillë që të sigurohet mjaftueshmëria, likuiditeti, siguria, përfitueshmëria dhe përputhja e aktiveve të saj;
- rregulla në lidhje me nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese, nivelin e kërkuar të aftësisë paguese dhe fondin minimal të garancisë që ndërmarrja risiguroese ruan në lidhje me veprimtaritë e risigurimit të kufizuar.

2. Në interes të transparencës, Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit pa vonesë tekstin e çdo mase të parashikuar në ligjet e tyre kombëtare për qëllimet e pikës 1.

Neni 46

#### **Mjetet me qëllime të veçanta**

1. Nëse një Shtet Anëtar vendos të lejojë vendosjen në territorin e vet të mjeteve për qëllime të veçanta brenda kuptimit të kësaj direktive, ai për këtë kërkon autorizim paraprak zyrtar.

2. Shteti Anëtar ku është vendosur mjeti, për qëllime të veçanta, vendos kushtet sipas së cilave do të zhvillohen veprimtaritë nga një ndërmarrje e tillë. Veçanërisht, ai Shtet Anëtar vendos rregulla në lidhje me:

- objektin e autorizimit
- kushtet e detyrueshme për përfshirjen në të gjitha kontratat e nxjerra;
- opinionin e mirë dhe kualifikimet e përshtatshme profesionale të personave që administrojnë mjetin për qëllime të veçanta;
- kërkesat për përshtatshmërinë e aksionarëve ose ortakëve që kanë një pjesëmarrje në mjetin për qëllime të veçanta;

- procedurat e shëndosha administrative dhe të llogarive, mekanizmat e përshtatshme të kontrollit të brendshëm dhe kërkesat për menaxhimin e riskut;

- kërkesat për informacionin për kontabilitetin, maturinë dhe atë statistikor;

- kërkesat e aftësisë paguese për mjetet për qëllime të veçanta.

3. Në interes të transparencës, Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit pa vonesë tekstin e çdo mase të parashikuar në ligjet e tyre kombëtare për qëllimet e pikës 2.

## TITULLI V

### DISPOZITAT NË LIDHJE ME TË DREJTËN E VENDOSJES DHE LIRINË PËR TË OFRUAR SHËRBIME

Neni 47

#### **Ndërmarrjet risiguroese që nuk respektojnë dispozitat ligjore**

1. Nëse autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar pritës konstatojnë që një ndërmarrje risigurimi me një degë ose që ushtron veprimtari në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime në territorin e tij nuk i respekton dispozitat ligjore që zbatohen në atë Shtet, ato i kërkojnë ndërmarrjes risiguroese në fjalë ta korrigjojë situatën e parregullt. Në të njëjtën kohë, ato ia përcjellin këto konstatime autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës.

Nëse, me gjithë masat e marra nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës ose për shkak se këto masa duken të papërshtatshme, ndërmarrja risiguroese vazhdon me shkeljen e dispozitave ligjore të zbatueshme për të në Shtetin Anëtar pritës, ky i fundit, pas informimit të autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës, mund të marra masat e përshtatshme për të parandaluar ose penalizuar shkeljet e tjera, duke përfshirë, për aq sa është vetëm e nevojshme, moslejimin që ndërmarrja e risigurimit të vazhdojë të lidhë kontrata të reja risigurimi në territorin e tij. Shtetet Anëtare sigurojnë që brenda territoreve të tyre të jetë e mundur të vihen në dispozicion dokumentet ligjore të nevojshme për këto masa për ndërmarrjet risiguroese.

2. Çdo masë e marrë sipas pikës 1 e cila ka të bëjë me sanksione ose kufizime për zhvillimin e veprimtarisë risiguroese arsyetohet rregullisht dhe i komunikohet ndërmarrjes risiguroese përkatëse.

Neni 48

#### **Likuidimi**

Në rastin e likuidimit të një ndërmarrjeje risiguroese, detyrimet që rrjedhin nga kontratat e lidhura nga një degë ose sipas lirisë për të ofruar shërbime përmbushen në të njëjtën mënyrë si ato që rrjedhin nga kontratat e tjera risiguroese të asaj ndërmarrjeje.

## TITULLI VI

### NDËRMARRJET RISIGURUESE ME ZYRA QENDRORE JASHTË KOMUNITETIT QË ZHVILLOJNË VEPRIMTARI RISIGURIMI NË KOMUNITET

Neni 49

#### **Parimi dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarisë risiguroese**

Shteti Anëtar nuk zbaton për ndërmarrjet risiguruese me zyra qendrore jashtë Komunitetit që fillojnë ose ushtrojnë veprimtari risiguruese në territorin e tij dispozita që çojnë në një trajtim më të favorshëm se ai që u jepet ndërmarrjeve risiguruese me zyra qendrore në atë Shtet Anëtar.

Neni 50

### **Marrëveshjet me vendet e treta**

1. Komisioni mund t'i paraqesë propozime Këshillit për negocimin e marrëveshjeve me një ose më shumë vende të treta në lidhje me mjetet e ushtrimit të mbikëqyrjes mbi:

(a) ndërmarrjet risiguruese me zyra qendrore në vende të treta dhe që zhvillojnë veprimtari risiguruese në Komunitet,

(b) ndërmarrjet risiguruese me zyra qendrore në Komunitet dhe që zhvillojnë veprimtari risiguruese në territorin e një vendi të tretë.

2. Marrëveshjet e përmendura në pikën 1 synojnë të sigurojnë, veçanërisht në kushtet e barasvlershmërisë së rregullimit të kryer me maturi, hyrje të efektshme në treg për ndërmarrjet risiguruese në territorin e çdo pale kontraktuese dhe parashikojnë njohjen e ndërsjellë të rregullave dhe praktikave mbikëqyrëse për risigurimin. Ato synojnë gjithashtu të sigurojnë që:

(a) autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të jenë në gjendje të marrin informacionin e nevojshëm për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve risiguruese me zyra qendrore në Komunitet dhe që ushtrojnë veprimtari në territorin e vendeve përkatëse të treta,

(b) autoritetet kompetente të vendeve të treta të jenë në gjendje të marrin informacionin e nevojshëm për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve risiguruese me zyra qendrore në territoret e tyre dhe që ushtrojnë veprimtari në Komunitet.

3. Pa cenuar nenin 300 paragrafi 1 dhe 2 të Traktatit, Komisioni, me asistencën e Komitetit European për Sigurimet dhe Pensionet nga Marrëdhëniet e Punës, shqyrton rezultatin e negociatave të përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe situatën përkatëse.

## **TITULLI VII**

### **FILIALET E NDËRMARRJEVE MËMË TË RREGULLUARA NGA LIGJET E NJË VENDI TË TRETË DHE MARRJET E PJESËMARRJEVE NGA KËTO NDËRMARRJE MËMË**

Neni 51

#### **Informacioni i Shteteve Anëtare dhënë Komisionit**

Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare informojnë Komisionin dhe autoritetet kompetente të Shteteve të tjera Anëtare:

(a) për çdo autorizim të një filiali të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, një ose më shumë ndërmarrje mëmë të cilave rregullohen nga ligjet e një vendi të tretë;

(b) kurdoherë që një ndërmarrje mëmë e tillë merr një pjesëmarrje në një ndërmarrje risigurimi të Komunitetit gjë që do ta kthente këtë të fundit në filialin e saj.

Nëse autorizimi i përmendur në shkronjën “a” i jepet filialit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një ose më shumë ndërmarrjeve mëmë të rregulluara nga ligjet e një vendi të tretë, struktura e grupit specifikohet në njoftimin që autoritetet kompetente i bëjnë Komisionit.

Neni 52

### **Trajtimi nga vendet e treta të ndërmarrjeve risiguroese të Komunitetit**

1. Shtetet Anëtare informojnë Komisionin për çdo vështirësi të përgjithshme që haset nga ndërmarrjet e tyre risiguroese gjatë vendosjes dhe funksionimit në një vend të tretë ose gjatë ushtrimit të veprimtarive në një vend të tretë.
2. Komisioni, periodikisht, përpilon një raport që shqyrton trajtimin që u jepet ndërmarrjeve risiguroese të Komunitetit në vendet e treta, sipas kushteve të përmendura në pikën 3, në lidhje me vendosjen e ndërmarrjeve risiguroese të komunitetit në vendet e treta, përfitim të pjesëmarrjeve në ndërmarrjet risiguroese të vendeve të treta, zhvillimin e veprimtarive risiguroese nga këto ndërmarrje të vendosura dhe ofrimin ndërkufitar të ndërmarrjeve risiguroese nga Komuniteti në vendet e treta. Komisioni ia paraqet këto raporte Komisionit, së bashku me propozimet ose rekomandimet e përshtatshme.
3. Nëse Komisioni mendon, në bazë të raporteve të përmendura në pikën 2 ose në bazë të informacioneve të tjera, që një vend i tretë nuk u jep ndërmarrjeve risiguroese të Komunitetit hyrje të efektshme në treg, Komisioni mund t'i paraqesë Këshillit rekomandime për mandatin e përshtatshëm për negociata me qëllim arritjen e hyrjes së përmirësuar në treg për ndërmarrjet risiguroese të Komunitetit.
4. Masat e marra sipas këtij neni janë në pajtim me detyrimet e Komunitetit sipas çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, veçanërisht me Organizatën Botërore të Tregtisë.

## **TITULLI VIII**

### **DISPOZITA TË TJERA**

Neni 53

### **E drejta për t'iu drejtuar gjykatës**

Shtetet Anëtare sigurojnë që vendimet e marra në lidhje me një ndërmarrje risigurimi sipas akteve ligjore, nënligjore dhe administrative të nxjerra në zbatim të kësaj direktive t'i nënshtrohen të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.

Neni 54

### **Bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komisionit**

1. Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për qëllimin e lehtësimit të mbikëqyrjes së risigurimit brenda Komunitetit dhe zbatimit të kësaj direktive.
2. Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare bashkëpunojnë ngushtë për qëllimin e lehtësimit të mbikëqyrjes së risigurimit brenda Komunitetit dhe shqyrtimit të çdo vështirësie që mund të lindë nga zbatimi i kësaj direktive.

Neni 55

### **Procedura e Komitetit**

1. Komisioni asistohet nga Komiteti Europian i Sigurimeve dhe Pensioneve nga Marrëdhëniet e Punës.

2. Në lidhje me këtë pikë, nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE zbatohen duke pasur parasysh, dispozitat e nenit 8 të tij.

Periudha e parashikuar në nenin 5 pika 6 të Vendimit 1999/468/KE është 3 muaj.

3. Komiteti miraton rregulloren e vet të punës.

Neni 56

### **Masat zbatuese**

Masat e mëposhtme zbatuese të kësaj direktive miratohen në bazë të procedurës së parashikuar në nenin 55 pika 2:

(a) zgjerimi i formës ligjore të parashikuar në Shtojcën I,

(b) sqarimi i zërave që përbëjnë nivelin e aftësisë paguese të renditur në nenin 36 për të marrë parasysh krijimin e instrumenteve të reja financiare;

(c) rritja me deri 50% të shumave të primeve ose dëmeve që përdoren për llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese të parashikuar në nenin 37 pika 3 dhe 4, në klasat që nuk përfshijnë klasat 11, 12 dhe 13 të renditura në pikën A të Shtojcës së Direktivës 73/239/KEE për veprimtari risiguroese specifike ose lloje specifike kontratash ose të marrin parasysh tiparet specifike të këtyre veprimtarive ose kontratave,

(d) ndryshimi i fondit minimal të garancisë të parashikuar në nenin 40 pika 2 për të marrë parasysh zhvillimet ekonomike dhe financiare,

(e) sqarimi i përkufizimeve në nenin 2 për të garantuar zbatimin e njëtrajtshëm të kësaj Direktive në të gjithë Komunitetin.

## **TITULLI IX**

### **NDRYSHIMET NË DIREKTIVAT EKZISTUESE**

Neni 57

### **Ndryshime të Direktivës 73/239/KEE**

Direktiva 73/239/KE ndryshohet si vijon:

Në nenin 12a, pikat 1 dhe 2 zëvendësohen si më poshtë:

"1. Autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar tjetër të përfshirë u kërkohet mendim para dhënies së autorizimit ndërmarrjes së sigurimeve jo-jete, që është:

(a) filial ose ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi e autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar; ose

(b) filial i një ndërmarrjeje mëmë të një ndërmarrjeje sigurimi ose risigurimi të autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar; ose

(c) e kontrolluar nga i njëjti person, fizik apo juridik, i cili kontrollon një ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi të autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar.

2. Autoritetit kompetent të një Shteti Anëtar të përfshirë përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit ose firmave të investimit i merret mendim përpara dhënies së autorizimit ndërmarrjes së sigurimeve jo-jete e cila është:

(a) filial i një institucioni krediti apo firme investimi të autorizuar në Komunitet; ose

(b) filial i ndërmarrjes mëmë të një institucioni krediti ose firme investimi të autorizuar në Komunitet; ose

(c) e kontrolluar nga i njëjti person, fizik apo juridik, i cili kontrollon një institucion krediti ose firmë investimesh të autorizuar në Komunitet."

2. Në nenin 13(2), shtohet nënparagrafi i mëposhtëm:

"Shteti Anëtar i origjinës së ndërmarrjes së sigurimeve nuk refuzon një kontratë risigurimi të lidhur nga ndërmarrja e sigurimeve me një ndërmarrje risigurimi të autorizuar në pajtim me Direktivën 2005/68/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 nëntor 2005, mbi risigurimin [24] ose një ndërmarrje sigurimesh të autorizuar në pajtim me këtë direktivë ose Direktivën 2002/83/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 5 nëntor 2002, në lidhje me sigurimin e jetës [25], për shkaqe që lidhen drejtpërdrejt me qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes risiguroese ose të ndërmarrjes së sigurimeve."

3. Në nenin 15, pikat 2 dhe 3 zëvendësohen si më poshtë:

"2. Shteti Anëtar i origjinës i kërkon çdo ndërmarrjeje sigurimesh të mbulojë provigjonet teknike dhe provigjonet e barazimit të dëmeve të përmendur në nenin 15a të kësaj direktive duke përputhur aktivet në pajtim me nenin 6 të Direktivës 88/357/KEE. Në lidhje me risqet që ndodhen brenda Komunitetit, këto aktive duhet të ndodhen brenda Komunitetit. Shtetet Anëtare nuk u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimeve t'i vendosin aktivet në një Shtet Anëtar të caktuar. Megjithatë, Shteti Anëtar i origjinës lejon lehtësimin e rregullave për vendndodhjen e aktiveve.

3. Shtetet Anëtare nuk mbajnë në fuqi apo miratojnë për krijimin e provigjoneve teknike asnjë sistem me rezerva bruto që kërkon lënien peng të aktiveve për të mbuluar provigjonet për primet e pafituara dhe dëmet pezull nga risiguroesi, nëse risiguroesi është ndërmarrje risiguroese e autorizuar në pajtim me Direktivën 2005/68/KE ose ndërmarrje sigurimesh e autorizuar në pajtim me këtë direktivë ose Direktivën 2002/83/KE.

Nëse Shteti Anëtar i origjinës lejon që provigjonet teknike të mbulohen me të drejta kundrejt një risiguroesi i cili nuk është ndërmarrje risigurimi të autorizuar në pajtim me Direktivën 2005/68/KE dhe as ndërmarrje sigurimesh e autorizuar në pajtim me këtë direktivë ose Direktivën 2002/83/KE, ai vendos kushte për pranimin e këtyre të drejtave."

4. Neni 16 pika 2 ndryshohet si vijon:

(a) shkronja "b" e paragrafit të parë zëvendësohet si vijon:

“(b) rezervat (rezervat ligjore dhe ato të lira) që nuk i përkasin marrjes përsipër të detyrimeve dhe nuk klasifikohen si provigjoneve të barazimit të dëmeve;”;

(b) teksti hyrës dhe shkronja “a” e paragrafit të katërt zëvendësohet si vijon:

"Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese zvogëlohet edhe me zërat e mëposhtëm:

(a) pjesëmarrjet që ndërmarrja e sigurimeve ka në:

- ndërmarrjet e sigurimeve brenda kuptimit të nenit 6 të kësaj direktive, të nenit 4 të Direktivës 2002/83/KE ose nenit 1 shkronja “b” të Direktivës 98/78/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit,
- ndërmarrjet risiguruese brenda kuptimit të nenit 3 të Direktivës 2005/68/KE ose ndërmarrjet risiguruese të vendeve të treta brenda kuptimit të nenit 1 shkronja “l” të Direktivës 98/78/KE,
- shoqëritë financiare holding brenda kuptimit të nenit 1 shkronja “i” të Direktivës 98/78/KE,
- institucionet e kreditit dhe institucionet financiare brenda kuptimit të nenit 1 pika 1 dhe 5 të Direktivës 2000/12/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit,
- firmat e investimeve dhe institucionet financiare brenda kuptimit të nenit 1 pika 2 të Direktivës 93/22/KEE dhe të nenit 2 pika 4 dhe 7 të Direktivës së Këshillit 93/6/KEE.”.

5. Neni 16a ndryshohet si vijon:

(a) në pikën 3, paragrafi i shtatë zëvendësohet si vijon:

"Shuma e nxjerrë në këtë mënyrë shumëzohet me raportin që ekziston në lidhje me shumën e tre viteve të fundit financiarë ndërmjet shumës së dëmeve që mbetet të mbulohet nga ndërmarrja pas zbritjes së shumave të rikuperueshme përmes risigurimit dhe shumës bruto të dëmeve; ky raport nuk mund të jetë në asnjë rast më pak se 50%. Me kërkesë të mbështetur në prova nga ndërmarrja e sigurimeve drejtuar autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e autoritetit, shumat e rikuperueshme nga mjetet e qëllimeve të veçanta të përmendura në nenin 46 të Direktivës 2005/68/KE mund të zbriten si risigurim.”;

(b) në pikën 4, paragrafi i shtatë zëvendësohet si vijon:

"Shuma e nxjerrë në këtë mënyrë shumëzohet me raportin që ekziston në lidhje me shumën e tre viteve të fundit financiarë ndërmjet shumës së dëmeve që mbetet të mbulohet nga ndërmarrja pas zbritjes së shumave të rikuperueshme përmes risigurimit dhe shumës bruto të dëmeve; ky raport nuk mund të jetë në asnjë rast më pak se 50%. Me kërkesë të mbështetur në prova nga ndërmarrja e sigurimeve drejtuar autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e autoritetit, shumat e rikuperueshme nga mjetet e qëllimeve të veçanta të përmendura në nenin 46 të Direktivës 2005/68/KE mund të zbriten si risigurim.”.

6. Shtohet neni i mëposhtëm:

"Neni 17b

1. Çdo Shtet Anëtar kërkon që ndërmarrja e risigurimit me zyrë qendrore në territorin e saj dhe që zhvillon veprimtari risigurimi, në lidhje me të gjithë veprimtarinë e saj të krijojë një fond minimal garancie në pajtim me nenin 40 të Direktivës 2005/68/KE nëse përmbushet njëri prej kushteve të mëposhtme:



- (a) primet e mbledhura të risigurimit janë më shumë se 10% e shumës së përgjithshme të primeve;
- (b) primet e arkëtuara të risigurimit janë më shumë se 50 000 000 Euro;
- (c) provigjonet teknike që rezultojnë nga pranimet në risigurim janë më shumë se 10% e provigjoneve teknike gjithsej.

2. Çdo Shtet Anëtar mund të zgjedhë që, për ndërmarrjet e risigurimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni me zyra qendrore në territorin e tij, të zbatojë dispozitat e nenit 34 të Direktivës 2005/68/KE në lidhje me veprimtaritë e tyre të pranimit në risigurim, nëse përmbushet një nga kushtet e parashikuara në këtë pikën 1 të lartpërmendur.

Çdo Shtet Anëtar mund të zgjedhë që, për ndërmarrjet e risigurimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni me zyra qendrore në territorin e tij, të zbatojë dispozitat e nenit 34 të Direktivës 2005/68/KE në lidhje me veprimtaritë e tyre të pranimit në risigurim, nëse përmbushet një nga kushtet e parashikuara në këtë pikën 1 të lartpërmendur. Në një rast të tillë dhe vetëm në lidhje me veprimtaritë e tyre të pranimit në risigurim, ndërmarrjet e sigurimeve nuk u nënshtrohen neneve 20, 21 dhe 22 të Direktivës 92/49/KEE(26) dhe Shtojcës I të Direktivës 88/357/KEE.

Çdo Shtet Anëtar siguron që autoritetet e tij kompetente të verifikojnë ndarjen e parashikuar në paragrafin e dytë.

3. Nëse, në zbatim të nenit 56 shkronja "c" të Direktivës 2005/68/KE, Komisioni vendos të rrisë shumat e përdorura për llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese të parashikuar në nenin 37 pika 3 dhe 4 të kësaj direktive, çdo Shtet Anëtar zbaton për këto ndërmarrje sigurimesh që përmenden në pikën 1 të këtij neni dispozitat e neneve 35 deri 39 të kësaj direktive në lidhje me veprimtaritë e tyre të pranimit në risigurim.

7. Në nenin 20a, pika 4 zëvendësohet si vijon:

"4. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetencën ta kufizojnë zbritjen, bazuar në risigrim, në nivelin e aftësisë paguese të përcaktuar sipas nenit 16a, nëse:

- (a) natyra ose cilësia e kontratave të risigurimit ka ndryshuar në masë të konsiderueshme qysh nga viti i fundit financiar;
- (b) nuk ka asnjë transferim të riskut sipas kontratave të risigurimit ose ka një transferim të kufizuar të këtij risku."

Neni 58

### **Ndryshime të Direktivës 92/49/KEE**

Direktiva 92/49/KEE ndryshohet si vijon:

1. Në nenin 15, pika 1a zëvendësohet si vijon:

Nëse marrësi i pjesëmarrjeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni është ndërmarrje sigurimesh, ndërmarrje risigurimi, institucion krediti ose firmë investimesh e autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar, ose ndërmarrje mëmë e këtij subjekti, ose person fizik apo juridik që e kontrollon këtë subjekt, dhe nëse, si rezultat i marrjes, ndërmarrja në të cilën marrësi propozon ta marrë pjesëmarrjen do të bëhej

filial ose do t'i nënshtrohej kontrollit të marrësit, vlerësimi i marrjes u nënshtrohet konsultimeve të përmendura në nenin 12a të Direktivës 73/239/KEE."

2. Në nenin 16, pikat 4, 5 dhe 6 zëvendësohen si më poshtë:

"4. Autoritetet kompetente që marrin informacionin konfidencial sipas pikën 1 mund ta përdorin atë vetëm në ushtrim të detyrave të tyre:

- për të verifikuar përmbushjen e kushteve që rregullojnë fillimin e veprimtarisë të sigurimit dhe për të lehtësuar monitorimin e sjelljes së kësaj veprimtarie, veçanërisht në lidhje me monitorimin e provigjoneve teknike, niveleve të aftësisë pague, procedurave administrative dhe kontabile dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm,

- për të vendosur sanksione,

- në ankimet administrative kundër veprimeve të autoriteteve kompetente, ose

- në proceset gjyqësore të çelura sipas nenit 53 ose sipas dispozitave të veçanta të parashikuara në këtë direktivë ose direktivat e tjera të miratuara në fushën e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguroese.

5. Pikat 1 dhe 4 nuk përjashtojnë shkëmbimin e informacionit brenda një Shteti Anëtar, nëse ka dy ose më shumë autoritete kompetente në të njëjtin Shtet Anëtar ose, ndërmjet Shteteve Anëtare, ndërmjet autoriteteve kompetente dhe:

- autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen zyrtare të institucioneve të kreditit dhe organizatave të tjera financiare dhe autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve financiare,

- organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguroese dhe në procedura të tjera të ngjashme, dhe

- personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të ndërmarrjeve të sigurimeve, ndërmarrjeve risiguroese dhe institucioneve të tjera financiare, në përmbushje të funksioneve të tyre mbikëqyrëse, dhe deklarimit tek organet që administrojnë procedurat e administrimit të detyruar ose fondet e garancisë të informacionit të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre.

6. Pavarësisht pikave nga 1 deri në 4, Shtetet Anëtare mund të autorizojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe:

- autoriteteve përgjegjës për mbikëqyrjen e organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguroese dhe procedurat e tjera të ngjashme, ose

- autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e personave të ngarkuar me kryerjen e auditimeve të detyrueshme të llogarive të ndërmarrjeve të sigurimeve, ndërmarrjeve risiguroese, institucionet e kredisë, firmat e investimeve dhe institucione të tjera financiare, ose

- aktuarëve të pavarur të ndërmarrjeve të sigurimeve ose ndërmarrjeve risiguroese që kryejnë mbikëqyrjen ligjore të atyre ndërmarrjeve dhe organeve përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtyre aktuarëve.

Shtetet Anëtare të cilat kanë mundësinë e parashikuar në paragrafin e parë kërkojnë që të paktën të përmbushen kushtet e mëposhtme:

- ky informacion është për qëllimin e kryerjes së kontrollit ose mbikëqyrjes ligjore të përmendur në paragrafin e parë;

- informacioni i marrë në këtë kontekst u nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të parashikuar në pikën 1,

- nëse informacioni e ka origjinën në një Shtet tjetër Anëtar, ai nuk mund të deklarohet pa pëlqimin e shprehur të autoriteteve kompetente që e kanë dhënë atë dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat këto autoritete kanë dhënë pëlqimin e tyre.

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare emrat e autoriteteve, personave dhe organeve që mund të marrin informacion në pajtim me këtë paragraf."

3. Neni 21(1) ndryshohet si vijon:

(a) teksti hyrës zëvendësohet si më poshtë:

"1. Shteti Anëtar i origjinës nuk mund t'i autorizojë ndërmarrjet e sigurimeve t'i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonet e barazimit të dëmeve me asnjë aktiv tjetër përveç aktiveve të kategorive të mëposhtme:";

(b) shkronja "f" e pikës "B" zëvendësohet si vijon:

"(f) borxhet e risiguruesve, duke përfshirë pjesën e risiguruesve në provigjonet teknike, dhe borxhet e mjeteve për qëllime të veçanta të përmendura në nenin 46 të Direktivës 2005/68/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 nëntor 2005, për risigurimin [27].

(c) paragrafi i tretë i pikës "C" zëvendësohet si më poshtë:

"Përfshirja e aktiveve ose kategorive të aktiveve në paragrafin e parë nuk do të thotë që të gjitha këto aktive duhet të pranohen automatikisht si mbulim për provigjonet teknike. Shteti Anëtar i origjinës përcakton rregulla më të hollësishme që vendosin kushte për përdorimin e aktiveve të pranueshme."

4. Në nenin 22 pika 1, teksti hyrës zëvendësohet si më poshtë:

"1. Në lidhje me aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe provigjoneve të barazimit të dëmeve, Shteti Anëtar i origjinës kërkon që çdo ndërmarrje sigurimesh të investojë jo më shumë se:".

Neni 59

### **Ndryshime të Direktivës 98/78/KEE**

Direktiva 98/78/KE ndryshohet si vijon:

1. Titulli zëvendësohet si më poshtë:

"Direktiva 98/78/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 27 tetor 1998, për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguruese në një grup sigurimesh".

2. Neni 1 ndryshohet si vijon:

(a) shkronjat "c", "i", "j" dhe "k" zëvendësohet si më poshtë:

"(c) "ndërmarrje risigurimi" do të thotë një ndërmarrje që ka marrë autorizim zyrtar në pajtim me nenin 3 të Direktivës 2005/68/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 nëntor 2005, për risigurimin [28];

"(i) "shoqëri sigurimesh holding" do të thotë një ndërmarrje mëmë, aktiviteti kryesor i së cilës është marrja dhe mbajtja e pjesëmarrjes në ndërmarrjet filiale, nëse këto ndërmarrje filiale janë ekskluzivisht ose kryesisht ndërmarrje sigurimesh, ndërmarrje risigurimesh ose ndërmarrje sigurimesh të vendeve të treta ose ndërmarrje risigurimi të vendeve të treta, ku të paktën një prej ndërmarrjeve filiale është një ndërmarrje sigurimesh ose një ndërmarrje risigurimi dhe që nuk është një shoqëri financiare holding e përzier brenda kuptimit të Direktivës 2002/87/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2002, për mbikëqyrjen shtesë të institucioneve të kreditit, ndërmarrjeve të sigurimeve dhe firmave të investimeve në një konglomerat financiar [29];

(j) "shoqëri sigurimesh holding me veprimtari të përzier" do të thotë një ndërmarrje mëmë, e ndryshme nga një ndërmarrje sigurimesh, një ndërmarrje sigurimesh e një vendi të tretë, një ndërmarrje risigurimi, një ndërmarrje risigurimi e një vendi të tretë, një shoqëri sigurimesh holding ose një shoqëri financiare e përzier holding brenda kuptimit të Direktivës 2002/87/KE, që përfshin të paktën një ndërmarrje sigurimesh ose një ndërmarrje risigurimi ndërmjet ndërmarrjeve të saj filiale;

(k) "autoritete kompetente" janë autoritetet kombëtare që kanë kompetencë në bazë të ligjit ose rregullores për të mbikëqyrur ndërmarrjet e sigurimeve ose ndërmarrjet e risigurimeve.

(b) Shtohet shkronja e mëposhtme:

(l) "ndërmarrje risigurimi e një vendi të tretë" është një ndërmarrje së cilës do t'i kërkohej autorizim në pajtim me nenin 3 të Direktivës 2005/68/KEE nëse do ta kishte zyrën qendrore në Komunitet;".

3. Nenet 2, 3 dhe 4 zëvendësohen si vijon:

"Neni 2

Rastet e zbatimit të mbikëqyrjes shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguroese

1. Përveç dispozitave të Direktivës 73/239/KEE, Direktivës 2002/83/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 5 nëntor 2002, në lidhje me sigurimin e jetës [30] dhe Direktivës 2005/68/KE, të cilat vendosin rregullat për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguroese, Shtetet Anëtare parashikojnë që mbikëqyrja për çdo ndërmarrje sigurimesh ose çdo ndërmarrje risigurimi, e cila është një ndërmarrje pjesëmarrëse në të paktën një ndërmarrje sigurimesh, një ndërmarrje risigurimi, një ndërmarrje sigurimesh të një vendi të tretë ose një ndërmarrje risigurimi e një vendi të tretë, të plotësohet në mënyrën e parashikuar në nenet 5, 6, 8 dhe 9 të kësaj direktive.

2. Çdo ndërmarrje sigurimesh ose ndërmarrje risigurimi, ndërmarrja mëmë e së cilës është një shoqëri sigurimesh holding, një ndërmarrje sigurimesh ose një ndërmarrje risigurimi e një shteti të tretë, i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë në mënyrën e parashikuar në nenin 5 pika 2, nenin 6, 8 dhe 10.

3. Çdo ndërmarrje sigurimesh ose ndërmarrje risigurimi, ndërmarrja mëmë e së cilës është një shoqëri sigurimesh me veprimtari të përzier i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë në mënyrën e parashikuar në nenin 5 pika 2, neni 6 dhe 8.

Neni 3

Objekti i mbikëqyrjes shtesë

1. Ushtrimi i mbikëqyrjes shtesë në pajtim me nenin 2 në asnjë mënyrë nuk do të thotë që autoriteteve kompetente u kërkohet të luajnë një rol mbikëqyrës në lidhje me ndërmarrjen e sigurimeve të një shteti të tretë, ndërmarrjen risiguruese të një shteti të tretë, shoqërinë e sigurimeve holding ose shoqërive të sigurimit holding me aktivitet të përzier ose ndërmarrjet e sigurimeve me aktivitet të përzier holding të marra individualisht.

2. Mbikëqyrja shtesë merr parasysh ndërmarrjet e mëposhtme të përmendura në nenet 5, 6, 8, 9 dhe 10:

- ndërmarrjet e lidhura të ndërmarrjes së sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguruese,
- ndërmarrjet pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguruese,
- ndërmarrjet e lidhura të një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve ose në ndërmarrjen risiguruese.

3. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos marrin parasysh në mbikëqyrjen shtesë të parashikuar në nenin 2 ndërmarrje që e kanë zyrën qendrore në një shtet jo-anëtar, nëse ka pengesa ligjore për transferimin e informacionit të nevojshëm, pa cenuar dispozitat e Shtojcës I, pika 2.5 dhe të Shtojcës II, pika 4.

Për më tepër, autoritetet kompetente përgjegjëse për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë, në rastet e renditura më poshtë, mund të vendosin rast pas rasti për të mos marrë parasysh një ndërmarrje për mbikëqyrjen shtesë të përmendur në nenin 2:

- nëse ndërmarrja që duhet të përfshihet është e një interesi të ulët në lidhje me objektivat e mbikëqyrjes shtesë të ndërmarrjeve të sigurimit ose ndërmarrjeve risiguruese,
- nëse përfshirja e gjendjes financiare të ndërmarrjes do të ishte e papërshtatshme ose e pasaktë në lidhje me objektivat e mbikëqyrjes shtesë të ndërmarrjeve të sigurimit ose ndërmarrjeve risiguruese.

Neni 4

Autoritetet kompetente për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë

1. Mbikëqyrja shtesë ushtrohet nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin ndërmarrja e sigurimeve ose ndërmarrja risiguruese ka marrë autorizimin zyrtar sipas nenit 6 të Direktivës 73/239/KEE ose nenit 4 të Direktivës 2002/83/KE ose të nenit 3 të Direktivës 2005/68/KEE.

2. Nëse ndërmarrjet e sigurimeve ose ndërmarrjet risiguruese të autorizuar në një ose më shumë Shtete Anëtare kanë si ndërmarrje mëmë të njëjtën shoqëri sigurimesh holding, ndërmarrje sigurimesh e një vendi të tretë, ndërmarrje risigurimi e një shteti të tretë ose shoqëri sigurimesh holding me aktivitet të përzier, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare përkatëse mund të arrijnë një marrëveshje se cili prej tyre do të jetë përgjegjës për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë.

3. Nëse një Shtet Anëtar ka më shumë se një autoritet kompetent për mbikëqyrjen financiare të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve të risigurimeve, këto Shtete Anëtare marrin masat e nevojshme për të organizuar bashkërendimin ndërmjet atyre autoriteteve.

4. Në nenin 5, pika 1 zëvendësohet si vijon:

"1. Shtetet Anëtare parashikojnë që autoritetet kompetente të kërkojnë që çdo ndërmarrje sigurimesh dhe ndërmarrje risiguruese që i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë të ketë mekanizma të mjaftueshëm kontrolli të brendshëm për nxjerrjen e të dhënave dhe informacionit për qëllimet e kësaj mbikëqyrjeje shtesë."

5. Nenet 6, 7 dhe 8 zëvendësohen si vijon:

"Neni 6

E drejta e informimit

1. Shtetet Anëtare parashikojnë që autoritetet e tyre kompetente përgjegjëse për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë të ketë të drejtë shikimi të informacioneve që do të ishin të rëndësishme për qëllimin e mbikëqyrjes së një ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risiguruese që i nënshtrohet kësaj mbikëqyrjeje shtesë. Autoritetet kompetente mund t'u drejtohen drejtpërdrejt ndërmarrjeve përkatëse të përmendura në nenin 3 pika 2 për të marrë informacionin e nevojshëm vetëm nëse ky informacion i është kërkuar ndërmarrjes së sigurimeve ose ndërmarrjes risiguruese dhe nuk është dhënë prej saj.

2. Shtetet Anëtare parashikojnë që autoritetet e tyre kompetente mund të kryejnë brenda territorit të tyre, vetë ose me ndërmjetësimin e personave të cilët ata i emërojnë për këtë qëllim, verifikime në vend të informacionit të përmendur në pikën 1 tek:

- ndërmarrja e sigurimeve që i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë,
- ndërmarrja risiguruese që i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë,
- ndërmarrjet filiale të asaj ndërmarrjeje sigurimesh,
- ndërmarrjet filiale të asaj ndërmarrjeje risiguruese,
- ndërmarrjet mëmë të asaj ndërmarrjeje sigurimesh,
- ndërmarrjet mëmë të asaj ndërmarrjeje risiguruese,
- ndërmarrjet filiale të një ndërmarrjeje mëmë të asaj ndërmarrjeje sigurimesh.
- ndërmarrjet filiale të një ndërmarrjeje mëmë të asaj ndërmarrjeje risiguruese.

3. Nëse, në zbatimin e këtij neni, autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar në raste të veçanta dëshirojnë të verifikojnë një informacion të rëndësishëm në lidhje me një ndërmarrje që gjendet në një Shtet Anëtar tjetër që është një ndërmarrje sigurimi e lidhur, një ndërmarrje risigurimi e lidhur, një ndërmarrje filial, një ndërmarrje mëmë ose një filial i një ndërmarrjeje mëmë të ndërmarrjes së sigurimeve ose e ndërmarrjes risiguruese që i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë, ato duhet t'u kërkojnë autoriteteve të Shtetit Anëtar tjetër që ta kryejnë atë verifikim. Autoritetet që marrin një kërkesë të tillë duhet të veprojnë brenda kufijve të juridiksionit të tyre duke kryer vetë verifikimin, duke u lejuar autoriteteve që kanë bërë kërkesën ta kryejnë atë ose duke lejuar një auditues ose ekspert ta kryejë atë.

Autoriteti kompetent që ka bërë kërkesën, nëse dëshiron, mund të marrë pjesë në verifikimin nëse ai nuk e kryen verifikimin vetë.

Neni 7

## Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente

1. Nëse ndërmarrjet e sigurimeve ose ndërmarrjet risiguruese të vendosura në Shtete të ndryshme Anëtare janë të lidhura drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt ose kanë një ndërmarrje të përbashkët pjesëmarrëse, autoritetet kompetente të secilit Shtet Anëtar i komunikojnë sipas kërkesës njëri-tjetrit të gjithë informacionin përkatës që mund të mundësojë ose lehtësojë ushtrimin e mbikëqyrjes në pajtim me këtë direktivë dhe të komunikojnë kryesisht çdo informacion që atyre u duket thelbësor për autoritetet e tjera kompetente.

2. Nëse një ndërmarrje sigurimesh ose një ndërmarrje risigurimi ose një institucion krediti i përkufizuar në Direktivën 2000/12/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 20 mars 2000, në lidhje me fillimin dhe zhvillimin e veprimtarisë të institucioneve të kreditit [31] ose një firmë investimesh sipas përkufizimit të Direktivës së Këshillit 93/22/KE, datë 10 maj 1993, për shërbimet e investimeve në fushën e letrave me vlerë [32], ose të dyja, janë të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi apo kanë një ndërmarrje të përbashkët pjesëmarrëse, autoritetet kompetente dhe autoritetet me përgjegjësi publike për mbikëqyrjen e këtyre ndërmarrjeve të tjera bashkëpunojnë ngushtë. Pa cenuar përgjegjësitë e tyre përkatëse, këto autoritete i japin njëra-tjetrës çdo informacion që mund ta lehtësojë punën e tyre, veçanërisht brenda kuadrit të kësaj direktive.

3. Informacioni i marrë në pajtim me këtë direktivë dhe, veçanërisht, çdo shkëmbim informacioni ndërmjet autoriteteve kompetente që është i parashikuar në këtë direktivë i nënshtrohet detyrimit të sekretit profesional sipas përkufizimit në nenin 16 të Direktivës së Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (Direktiva e tretë për sigurimin e jo-jetës) [33] dhe nenin 16 të Direktivës 2002/83/KE dhe nenet nga 24 deri në 30 të Direktivës 2005/68/KE.

## Neni 8

### Transaksionet brenda grupit

1. Shtetet Anëtare parashikojnë që autoritetet kompetente të ushtrjnë mbikëqyrje të përgjithshme mbi veprimet ndërmjet:

(a) një ndërmarrje sigurimesh ose një ndërmarrje risigurimi dhe:

(i) një ndërmarrjeje të lidhur të ndërmarrjes së sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguruese;

(ii) një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve ose në ndërmarrjen risiguruese;

(iii) një ndërmarrjeje të lidhur të një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve ose në ndërmarrjen risiguruese;

(b) një ndërmarrjeje sigurimesh ose një ndërmarrjeje risigurimi dhe një personi fizik që ka pjesëmarrje në:

(i) ndërmarrjen e sigurimeve, ndërmarrjen risiguruese ose një prej ndërmarrjeve të lidhura të saj;

(ii) një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve ose në ndërmarrjen risiguruese,

(iii) një ndërmarrjeje të lidhur të një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve ose në ndërmarrjen risiguruese.

Këto veprime kanë të bëjnë veçanërisht me:

- huatë,
- dorëzantë dhe veprimet jashtë bilancit,
- elementet e lejuara për nivelin e aftësisë paguese,
- investimet,
- operacionet e risigurimit ose retrocesionit,
- marrëveshjet për ndarjen e shpenzimeve.

2. Shtetet Anëtare u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguroese të kenë procese të përshtatshme për menaxhimin e riskut dhe mekanizmat e brendshëm të kontrollit, duke përfshirë procedura të shëndosha raportimi dhe kontabiliteti, me qëllim që të identifikojnë, matin, monitorojnë dhe kontrollojnë rregullisht transaksionet sipas parashikimit në pikën 1. Shtetet Anëtare gjithashtu kërkojnë të paktën raportim vjetor nga ndërmarrjet e sigurimeve tek autoritetet kompetente për veprimet juridike të rëndësishme. Këto procese dhe mekanizma i nënshtrohen rishikimit të autoriteteve kompetente.

Nëse në bazë të këtij informacioni, duket se aftësia paguese e ndërmarrjes së sigurimeve ose ndërmarrjes risiguroese është ose mund të jetë e rrezikuar, autoriteti kompetent merr masat e përshtatshme në nivelin e ndërmarrjes së sigurimeve ose ndërmarrjes risiguroese.

6. Në nenin 9, pika 3 zëvendësohet si vijon:

"3. Nëse llogaritja e përmendur në pikën 1 tregon që aftësia paguese e rregulluar është negative, autoritetet kompetente marrin të gjitha masat e përshtatshme në nivelin e ndërmarrjes së sigurimit ose ndërmarrjes risiguroese në fjalë.

7. Neni 10 ndryshohet si vijon:

(a) titulli zëvendësohet si më poshtë:

"Shoqëritë e sigurimeve holding, ndërmarrjet e sigurimeve të shteteve të treta dhe ndërmarrjet risiguroese të shteteve të treta";

(b) pikat 2 dhe 3 zëvendësohen si më poshtë:

"2. Në rastin e përmendur në nenin 2 pika 2, llogaritja përfshin të gjitha ndërmarrjet e lidhura të shoqërisë holding të sigurimeve, ndërmarrjen e sigurimeve të një vendi të tretë ose ndërmarrjen risiguroese të një vendi të tretë, në mënyrën e parashikuar në Shtojcën II.

3. Nëse në bazë të kësaj llogaritjeje, autoritetet kompetente nxjerrin përfundimin që aftësia paguese e një ndërmarrjeje sigurimesh filial ose një ndërmarrje risigurimi e shoqërisë holding të sigurimeve, ndërmarrjes së sigurimeve të një vendi të tretë ose ndërmarrjes siguroese të një vendi të tretë është ose mund të rrezikohet, ata marrin masat e përshtatshme në nivelin e asaj ndërmarrjeje të sigurimeve ose ndërmarrjeje risigurimi.

8. Neni 10a ndryshohet si vijon:



(a) në pikën 1, shkronja "b" zëvendësohet si vijon:

"(b) ndërmarrjet risiguruese të cilat kanë, si ndërmarrje pjesëmarrëse, ndërmarrje brenda kuptimit të nenit 2 të cilat e kanë zyrën qendrore në një vend të tretë;

(c) ndërmarrjet e sigurimeve të një vendi të tretë ose ndërmarrjet risiguruese të një vendi të tretë të cilat kanë, si ndërmarrje pjesëmarrëse, ndërmarrje brenda kuptimit të nenit 2 të cilat e kanë zyrën qendrore në Komunitet.";

(b) pika 2 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"2. Marrëveshjet e përmendura në pikën 1 synojnë veçanërisht të sigurojnë:

(a) që autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të jenë në gjendje të marrin informacionin e nevojshëm për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguruese të cilat e kanë zyrën qendrore në Komunitet dhe që kanë filiale ose kanë pjesëmarrje në ndërmarrjet jashtë Komunitetit; dhe

(b) që autoritetet kompetente të vendeve të treta të jenë në gjendje të marrin informacionin e nevojshëm për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguruese të cilat e kanë zyrën qendrore në territoret e tyre dhe që kanë filiale ose kanë pjesëmarrje në ndërmarrjet në një ose disa Shtete Anëtare."

9. Shtojcat I dhe II të Direktivës 98/78/KE zëvendësohen me Shtojcën II të kësaj direktive.

Neni 60

Ndryshime të Direktivës 2002/83/EEC

Direktiva 2002/83/KE ndryshohet si vijon:

1. Në nenin 1(1), shtohet pika e mëposhtme:

"(c) "ndërmarrje risigurimi" do të thotë një ndërmarrje risigurimi brenda kuptimit të nenit 2 shkronja "c" të Direktivës 2005/68/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 nëntor 2005, për risigurimin (34);

2. Shtohet neni i mëposhtëm:

"Neni 9a

Konsultimi paraprak me autoritetet kompetente të Shteteve Anëtarë të tjera

1. Autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar tjetër të përfshirë u kërkohet mendim para dhënies së një autorizimi për një ndërmarrje sigurimi jete, që është:

(a) filial i një ndërmarrjeje sigurimesh ose risigurimi e autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar; ose

(b) një filial i një ndërmarrjeje memë të një ndërmarrjeje sigurimi ose risigurimi të autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar; ose

(c) e kontrolluar nga i njëjti person, fizik apo juridik, i cili kontrollon një ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi të autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar.

2. Autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të përfshirë përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit ose firmave të investimit, i kërkohet mendim para dhënies së një autorizimi një ndërmarrjeje sigurimi jete e cila është:

(a) një filial i një institucion krediti apo firme investimi të autorizuar në Komunitet; ose

(b) një filial i ndërmarrjes mëmë të një institucioni krediti ose firme investimi të autorizuar në Komunitet; ose

(c) e kontrolluar nga i njëjti person, fizik apo juridik, i cili kontrollon një institucion krediti ose firmë investimesh të autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar.

3. Autoritetet kompetente përkatëse të përmendure në pikën 1 dhe 2 kërkojnë veçanërisht mendim njëri-tjetrin gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së aksionarëve dhe reputacionit dhe eksperiencës së anëtarëve të këshillit të administrimit të përfshirë në administrimin e një subjekti tjetër të të njëjtit grup. Ato njoftojnë njëri-tjetrin për çdo informacion në lidhje me përshtatshmërinë e aksionarëve dhe reputacionin dhe eksperiencën e anëtarëve të këshillit të administrimit që është me rëndësi për autoritetet e tjera kompetente të përfshira për dhënien e një autorizimi si dhe për vlerësimin në vazhdimësi të respektimit të kushteve operative."

3. Në nenin 10 pika 2, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"Shteti Anëtar i origjinës i ndërmarrjes së sigurimeve nuk e refuzon një kontratë risigurimi të lidhur nga ndërmarrja e sigurimeve me një ndërmarrje risiguroese të autorizuar në pajtim me Direktivën 2005/68/KE ose një ndërmarrje sigurimesh të autorizuar në pajtim me Direktivën 73/239/KEE ose me këtë direktivë për shkaqe të lidhura drejtpërdrejt me qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes risiguroese ose ndërmarrjes së sigurimeve."

4. Në nenin 15, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"1a. Nëse marrësi i pjesëmarrjeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni është ndërmarrje sigurimesh, ndërmarrje risigurimi, institucion krediti ose firmë investimesh e autorizuar në një Shtet tjetër Anëtar, ose ndërmarrje mëmë e këtij subjekti, ose person fizik apo juridik që kontrollon këtë subjekt, dhe nëse, si rezultat i marrjes, ndërmarrja në të cilën marrësi propozon ta marrë këtë pjesëmarrje do të bëhej filial ose do t'i nënshtrohej kontrollit të marrësit, vlerësimi i marrjes duhet t'u nënshtrohet konsultimeve të përmendura në nenin 9a."

5. Neni 16 ndryshohet si vijon:

(b) pikat 4, 5 dhe 6 zëvendësohen si më poshtë:

"4. Autoritetet kompetente që marrin informacionin konfidencial sipas pikës 1 ose 2 mund ta përdorin atë vetëm në ushtrim të detyrave të tyre:

- për të verifikuar përmbushjen e kushteve që rregullojnë fillimin e veprimtarisë të sigurimit dhe për të lehtësuar monitorimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie, veçanërisht në lidhje me monitorimin e provigjoneve teknike, niveleve të aftësisë pagueuse, procedurave administrative dhe kontabile dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm, ose

- për të vendosur sanksione, ose

- në ankimet administrative kundër veprimeve të autoritetit kompetent, ose

- në gjykimet e filluara sipas nenit 67 ose sipas dispozitave të veçanta të parashikuara në këtë direktivë ose direktivat e tjera të miratuara në fushën e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguruese.

5. Pikat 1 dhe 4 nuk përjashtojnë shkëmbimin e informacionit brenda një Shteti Anëtar, nëse ka dy ose më shumë autoritete kompetente në të njëjtin Shtet Anëtar ose, ndërmjet Shteteve Anëtare, ndërmjet autoriteteve kompetente dhe:

- autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen zyrtare të institucioneve të kreditit dhe organizatave të tjera financiare dhe autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve financiare,

- organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguruese dhe në procedura të tjera të ngjashme, dhe

- personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të ndërmarrjeve të sigurimeve, ndërmarrjeve risiguruese dhe institucioneve të tjera financiare,

në përmbushje të funksioneve të tyre mbikëqyrëse, dhe deklarimin tek organet që administrojnë procedurat e administrimit të detyruar ose fondet e garancisë të informacionit të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Informacioni i marrë nga këta autoritete, organe dhe persona i nënshtrohet detyrimit të sekretit profesional të parashikuar në pikën 1.

6. Pavarësisht pikave nga 1 deri në 4, Shtetet Anëtare mund të autorizojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe:

- autoriteteve përgjegjës për mbikëqyrjen e organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguruese dhe procedurat e tjera të ngjashme, ose

- autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e personave të ngarkuar me kryerjen e auditimeve të detyrueshme të llogarive të ndërmarrjeve të sigurimeve, ndërmarrjeve risiguruese, institucioneve të kreditit, firmave të investimeve dhe institucioneve të tjera financiare, ose

- aktuarëve të pavarur të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguruese që kryejnë mbikëqyrjen ligjore të atyre ndërmarrjeve dhe organeve përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtyre aktuarëve.

Shtetet Anëtare të cilat kanë mundësinë e parashikuar në paragrafin e parë kërkojnë që të paktën të përmbushen kushtet e mëposhtme:

- ky informacion të jetë për qëllimin e kryerjes së mbikëqyrjes ose mbikëqyrjes ligjore të përmendur në paragrafin e parë;

- informacioni i marrë në këtë kontekst t'u nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të parashikuar në pikën 1,

- nëse informacioni e ka origjinën në një Shtet tjetër Anëtar, ai të mos deklarohet pa pëlqimin e shprehur të autoriteteve kompetente që e kanë dhënë atë dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat këto autoritete kanë dhënë pëlqimin e tyre.

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare emrat e autoriteteve, personave dhe organeve që mund të marrin informacionin në pajtim me këtë pikë.";

(b) pika 8 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"8. Pikat nga 1 deri në 7 nuk e pengojnë autoritetin kompetent t'u transmetojë:

- bankave qendrore ose organeve të tjera me funksione të ngjashme në cilësinë e tyre si autoritete monetare,

- sipas rastit, autoriteteve të tjera publike përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave,

informacionin e synuar për kryerjen e detyrës së tyre, dhe as nuk i pengon këto autoritete ose organe t'u komunikojnë autoriteteve kompetente atë informacion që mund t'u duhet në kuptim të pikës 4. Informacioni i marrë në këtë kuadër u nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të vendosur në këtë nen".

6. Neni 20 pika 4 zëvendësohet si më poshtë:

"4. Shtetet Anëtare nuk mbajnë në fuqi apo miratojnë për krijimin e provigjoneve teknike asnjë sistem me rezerva bruto që kërkon bllokimin e aktiveve për të mbuluar provigjonet për primet e pafituara dhe dëmet pezull nga risiguruesi, të autorizuar në pajtim me Direktivën 2005/68/KE nëse risiguruesi është ndërmarrje risigurimi ose ndërmarrje sigurimesh e autorizuar në pajtim me Direktivën 73/239/KEE ose me këtë direktivë.

Nëse Shteti Anëtar i origjinës lejon që provigjonet teknike të mbulohen me të drejta kundrejt një risiguruesi i cili nuk është një ndërmarrje risigurimi e autorizuar në pajtim me Direktivën 2005/68/KE e as një ndërmarrje sigurimesh e autorizuar në pajtim me Direktivën 73/239/KEE ose me këtë direktivë, ai vendos kushte për pranimin e këtyre të drejtave."

7. Neni 23 ndryshohet si vijon:

(a) në pikën 1 seksioni B, shkronja "f" zëvendësohet si vijon:

"(f) të drejtat kundrejt risiguruesve, duke përfshirë pjesën që kanë në provigjonet teknike risiguruesit, dhe kundrejt çdo mjeti për qëllim të veçantë të përmendur në nenin 46 të Direktivës 2005/68/KE;"

(b) në pikën 3, paragrafi i parë zëvendësohet si vijon:

"3. "Përfshirja e aktiveve ose kategorive të aktiveve të renditura në pikën 1 nuk do të thotë që të gjitha këto aktive duhet të pranohen automatikisht si mbulim për provigjonet teknike. Shteti Anëtar i origjinës përcakton rregulla më të hollësishme që vendosin kushte për përdorimin e aktiveve të pranueshme."

8. Në nenin 27 pika 2, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese zvogëlohet edhe me zërat e mëposhtëm:

(a) pjesëmarrjet që ndërmarrja e sigurimeve ka në:

- ndërmarrjet e sigurimeve brenda kuptimit të nenit 4 të kësaj direktive, të nenit 6 të Direktivës 73/239/KE ose nenit 1 shkronja "b" të Direktivës 98/78/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 tetor 1998, për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në një grup sigurimesh [35],

- ndërmarrjet risiguruese brenda kuptimit të nenit 3 të Direktivës 2005/68/KE ose ndërmarrjet risiguruese të vendeve të treta brenda kuptimit të nenit 1 shkronja "l" të Direktivës 98/78/KE,

- shoqëritë financiare holding brenda kuptimit të nenit 1 shkronjs “i” të Direktivës 98/78/KE,
- institucionet e kreditit dhe institucionet financiare brenda kuptimit të nenit 1 pika 1 dhe 5 të Direktivës 2000/12/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 20 mars 2000, në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë të institucioneve të kreditit [36],
- firmat e investimeve dhe institucionet financiare brenda kuptimit të nenit 1 pika 2 të Direktivës së Këshillit 93/22/KEE, datë 10 maj 1993, për shërbimet e investimeve në fushën e letrave me vlerë [37] dhe të nenit 2 pika 4 dhe nenit 2 pika 7 të Direktivës së Këshillit 93/6/KEE, datë 15 mars 1993, për mjaftueshmërinë e kapitalit të firmave të investimeve dhe institucioneve të kreditit [38];

(b) secili prej zërave të mëposhtëm që një shoqëri sigurimesh ka në lidhje me subjektet e përkufizuara në shkronjën “a” në të cilat ka një pjesëmarrje:

- instrumentet e përmendura në pikën 3,
- instrumentet e përmendur në nenin 16 pikën 3 të Direktivës 73/239/KEE;
- të drejtat e nënrenditura dhe instrumentet e përmendura në nenin 35 dhe nenin 36 pika 3 të Direktivës 2000/12/KEE;

Nëse aksionet në një institucion tjetër krediti, firmë investimesh, institucion financiar, ndërmarrje sigurimesh dhe risigurimi ose shoqëri sigurimesh holding mbahen përkohësisht për qëllimet e një operacioni asistence financiare të destinuar për të riorganizuar dhe shpëtuar subjektin, autoriteti kompetent mund të mos zbatojë dispozitat për zbritjen e përmendur në shkronjat a dhe b të paragrafit të tretë.

Si alternativë për zbritjen e zërave të përmendur në shkronjën “a” dhe “b” të paragrafit të tretë që ndërmarrja e sigurimeve ka në institucionet e kreditit, firmat e investimeve dhe institucionet financiare, Shtetet Anëtare mund të lejojnë ndërmarrjet e tyre risiguroese të zbatojnë, duke bërë përshtatjet e duhura, metodat 1, 2 ose 3 të Shtojcës I të Direktivës 2002/87/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2002, për mbikëqyrjen shtesë të institucioneve të kreditit, ndërmarrjeve të sigurimeve dhe firmave të investimeve në një konglomerat financiar. Metoda 1 (Konsolidimi i llogarive) zbatohet vetëm nëse autoriteti kompetent ka besim në lidhje me nivelin e administrimit të integruar dhe kontrollit të brendshëm në lidhje me subjektet që do të përfshiheshin në objektin e konsolidimit. Metoda e zgjedhur zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme me kalimin e kohës.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që për llogaritjen e nivelit të aftësisë paguese sipas parashikimit të kësaj direktive, ndërmarrjet e sigurimeve që i nënshtrohen mbikëqyrjes shtesë në pajtim me Direktivën 98/78/KE ose mbikëqyrjes shtesë në pajtim me Direktivën 2002/87/KE nuk e kanë të nevojshme të zbresin zërat e përmendur në shkronjën “a” dhe “b” të paragrafin e tretë të këtij neni të cilat mbahen në institucionet e kreditit, firmat e investimeve, institucionet financiare ose ndërmarrjet risiguroese ose ndërmarrjet e sigurimeve holding të cilat përfshihen në mbikëqyrjen shtesë. Për qëllimet e zbritjes së pjesëmarrjeve të përmendura në këtë pikë, pjesëmarrja është pjesëmarrja sipas nenit 1 shkronja “f” të Direktivës 98/78/KE.

9. Neni 28 pika 2 ndryshohet si vijon:

(a) "(a) rezultati i parë

një thyesë prej 4% të provigjoneve matematikore në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë dhe pranimet në risigurim pa zbritur cedimet risiguroese shumëzohet me raportin, për vitin e fundit financiar, e provigjoneve teknike pa cedimet në risigurim mbi provigjonet e përgjithshme matematikore bruto. Ky raport në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 85%. Me kërkesë të mbështetur në prova nga ndërmarrja e sigurimeve drejtuar autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e autoritetit, shumat e rikuperueshme nga mjetet e qëllimeve të veçanta të përmendura në nenin 46 të Direktivës 2005/68/KE mund të zbriten si risigurim."

(b) "(b) rezultati i dytë:

për policat tek të cilat kapitali i riskuar nuk është shifër negative, një thyesë prej 0,3% i këtij kapitali të marrë përsipër nga ndërmarrja e sigurimeve shumëzohet me raportin, për vitin e fundit financiar, e kapitalit të plotë të riskuar të mbajtur si pasiv i ndërmarrjes pas cedimeve dhe retrocedimeve mbi kapitalin e përgjithshëm të riskuar duke përfshirë risigurimin; ku raport në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 50%. Me kërkesë të mbështetur në prova nga ndërmarrja e sigurimeve drejtuar autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e autoritetit, shumat e rikuperueshme nga mjetet e qëllimeve të veçanta të përmendura në nenin 46 të Direktivës 2005/68/KE mund të zbriten si risigurim."

10. Shtohet neni i mëposhtëm:

"Neni 28a

Niveli i aftësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve që zhvillojnë veprimtari risigurimi

1. Çdo Shtet Anëtar zbaton për ndërmarrjet e sigurimeve me zyra qendrore në territorin e tyre dispozitat e neneve nga 35 deri në 39 të Direktivës 2005/68/KE në lidhje me veprimtaritë e tyre të pranimit në risigurim, nëse përmbushet një prej kushteve të mëposhtme:

(a) primet e arkëtuara të risigurimit janë më shumë se 10% e shumës së përgjithshme të primeve;

(b) primet e arkëtuara të risigurimit janë më shumë se 50 000 000 Euro;

(c) provigjonet teknike që rezultojnë nga pranimet në risigurim janë më shumë se 10% e provigjoneve të përgjithshme teknike.

2. Çdo Shtet Anëtar mund të zgjedhë që, për ato ndërmarrje sigurimesh që përmenden në pikën 1 të këtij neni me zyra qendrore në territorin e tij, të zbatojë dispozitat e nenit 34 të Direktivës 2005/68/KE në lidhje me veprimtaritë e tyre të pranimit në risigurim, nëse përmbushet një nga kushtet e parashikuara në pikën 1 të përmendur më lart.

Në këtë rast, Shteti Anëtar përkatës kërkon që të gjitha aktivet e përdorura nga ndërmarrja e sigurimeve për të mbuluar provigjonet teknike që përkojnë me pranimet në risigurim të ndahen, duke u administruar dhe organizuar veçmas nga veprimtaritë e sigurimit të drejtpërdrejtë të ndërmarrjes së sigurimeve, pa asnjë mundësi transferimi. Në një rast të tillë, dhe vetëm në rastin e veprimtarive të pranimit në risigurim, ndërmarrjet e sigurimeve nuk u nënshtrohen neneve nga 22 deri të 26.

Çdo Shtet Anëtar siguron që autoritetet e tij kompetente të verifikojnë ndarjen e parashikuar në paragrafin e dytë."

11. Neni 37 pika 4 zëvendësohet nga si më poshtë:

"4. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetencën të kufizojnë zbritjen, bazuar në risigrim, në nivelin e aftësisë paguese sikurse parashikohet në nenin 28, nëse:

(a) natyra ose cilësia e kontratave të risigurimit ka ndryshuar në masë të konsiderueshme qysh nga viti i fundit financiar;

(b) nuk ka asnjë transferim të riskut sipas kontratave të risigurimit ose ka një transferim të kufizuar të këtij risku."

## TITULLI X

### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 61

#### **Të drejtat e fituara nga ndërmarrjet ekzistuese risigurorese**

1. Ndërmarrjet risigurorese që i nënshtrohen kësaj direktive të cilat janë autorizuar ose kanë të drejtën të zhvillojnë aktivitet risigurimi në pajtim me dispozitat e Shteteve Anëtare ku ato kanë zyrat qendrore para datës 10 dhjetor 2005 konsiderohen se janë autorizuar në pajtim me nenin 3.

Megjithatë, ato janë të detyruara të përmbushin dispozitat e kësaj direktive në lidhje me zhvillimin e veprimtarisë të risigurimit dhe me kërkesat e parashikuara në nenin 6 shkronja "a", "c", "d", neni 7, 8 dhe 12 dhe nenet nga 32 deri në 41 duke filluar nga data 10 dhjetor 2007.

2. Shtetet Anëtare mund t'u lejojnë ndërmarrjeve risigurorese të përmendura në pikën 1 të cilat më datën 10 dhjetor 2005 nuk janë në pajtim me nenet 6 shkronja "a", neni 7, 8 dhe nenet nga 32 deri në 40 një afat deri më 10 dhjetor 2008 me qëllim që t'i përmbushin këto kërkesa.

#### Neni 62

#### **Ndërmarrjet risigurorese që e mbyllin veprimtarinë**

1. Ndërmarrjet risigurorese të cilat deri më datën 10 dhjetor 2007 kanë pushuar së lidhuri kontrata të reja risigurimi dhe administrojnë vetëm portofolin ekzistues me qëllim që ta mbyllin veprimtarinë nuk i nënshtrohen kësaj direktive.

2. Shtetet Anëtare hartojnë listën e ndërmarrjeve risigurorese përkatëse dhe ua komunikojnë këtë listë Shteteve të tjera Anëtare.

#### Neni 63

#### **Periudhë kalimtare për nenet 57(3) dhe 60(6)**

Një Shtet Anëtar mund ta shtyjë zbatimin e dispozitave të nenit 57 pika 3 të kësaj direktive me të cilin ndryshohet neni 15 pika 3 i Direktivës 73/239/KEE dhe zbatimin e dispozitës së nenit 60 pika 6 të kësaj direktive deri më datën 10 dhjetor 2008.

#### Neni 64

#### **Kthimi në legjislacion të brendshëm**

1. Shtetet Anëtare sjellin në fuqi laktët ligjore, nënligjore dhe administrative të nevojshme për të qenë në përmbushje të kësaj direktive brenda datës 10 dhjetor 2007. Ato i komunikojnë menjëherë Komisionit tekstet e këtyre masave.

Gjatë miratimit të këtyre masave, Shtetet Anëtare bëjnë lidhjen me këtë direktivë ose e citojnë titullin e kësaj direktive me rastin e botimit zyrtar të masave. Shtetet Anëtare vendosin vetë për mënyrën e citimit në fjalë.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit kombëtar të miratuar në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.

Neni 65

### **Hyrja në fuqi**

Kjo direktivë hyn në fuqi ditën e nesërme pas botimit të saj në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian.

Neni 66

### **Entitetet të cilëve u drejtohet**

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 16 nëntor 2005.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

J. Borrell fontelles

Për Këshillin

Presidenti

Bach of Lutterworth

[1] GZ C 120, 20.5.2005, fq. 1

[2] Opinion i Parlamentit Europian, datë 7 qershor 2005 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendim i Këshillit, datë 17 tetor 2005.

[3] GZ L 228, 16.8.1973, fq. 3 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (GZ L 79, 24.3.2005, fq. 9).

[4] GZ L 228, 11.8.1992, fq. 1 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE.

[5] GZ L 345, 19.12.2002, fq. 1 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE.

[6] GZ 56, 4.4.1964, fq. 878.

[7] GZ L 330, 5.12.1998, fq. 1 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE.

[8] GZ L 35, 11.2.2003, fq. 1 Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 2005/1/KE.



[9] GZ L 374, 31.12.1991, fq. 7 Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 2003/51/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 178, 17.7.2003, fq. 16).

[10] GZ L 3, 7.1.2004, fq. 34

[11] GZ L 184, 17.7.1999, fq. 23

[12] GZ C 321, 31. 12. 2003, fq.1.

[13] Direktiva e Shtatë e Këshillit 83/349/KEE, datë 13 qershor 1983, mbështetur në nenin 54 paragrafi 3 germa “g” të Traktatit për llogaritë e konsoliduara (GZ L 193, 18.07.1983, fq. 1).Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2003/51/KE.

[14] Direktiva 2000/12/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 20 mars 2000, në lidhje me fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të kreditit (GZ L 126, 26.5.2000, f. 1).Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE.

[15] Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004, për tregjet e instrumenteve financiare (GZ L 145, 30.4.2004. fq. 1).

[16] Direktiva 2003/41/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë datës 3 qershor 2003, për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve për pensionet nga marrëdhëniet e punës (GZ L 235, 23.9.2003, fq. 10).

[17] Direktiva 2001/34/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 28 maj 2001, për pranimin e letrave me vlerë në listën e regjistruar të bursës dhe për informacionin që duhet publikuar për këto letra me vlerë (GZ L 184, 6.7.2001, fq. 1) Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE.

[18] Rregullore e Këshillit (KE) nr. 2157/2001, datë 8 nëntor 2001, për Statutin për një shoqëri europiane (SE) (GZ L 294, 10.11.2001 fq. 1).Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Rregullorja (KE) nr. 885/2004 (GZ L 168, 1.5.2004, fq. 1).

[19] Direktiva e Tetë e Këshillit 84/253/KEE, datë 10 prill 1984, mbështetur në nenin 54 paragrafi 3 germa “g” të Traktatit për licencimin e personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve të detyrueshme të dokumenteve kontabël (GZ L 126, 12.5.1984, fq. 20).

[20] Direktiva e Katërt e Këshillit 78/660/KEE, datë 25 korrik 1978 mbështetur në nenin 54 paragrafi 3 germa “g” të Traktatit për llogaritë vjetore të disa llojeve të caktuara të shoqërive tregtare (GZ L 222, 14.8.1978, fq. 11).Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2003/51/KE.

[21] Direktiva e Këshillit 85/611/KEE, datë 20 dhjetor 1985, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me ndërmarrjet e investimeve kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (GZ L 375, 31.12.1985, fq. 3). Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE.

[22] Direktivë e Këshillit 93/22/KEE, datë 10 maj 1993, për shërbimet e investimeve në fushën e letrave me vlerë (GZ L 141, 11.6.1993, fq. 27). Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2002/87/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 35, 11.2.2003, fq. 1).

[23] Direktiva e Këshillit 93/6/KEE, datë 15 mars 1993, për mjaftueshmërinë e kapitalit të firmave të investimeve dhe institucioneve të kreditit (GZ L 141, 11.6.1993, fq. 1) Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE.

[24] GZ L 323, 9.12.2005, fq. 1

[25] GZ L 345, 19.12.2002, fq. 1. Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE (GZ L 79, 24.3.2005, fq. 9).

[26] Direktivë e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (GZ L 228, 11.8.1992, fq. 1). Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE."

[27] GZ L 323, 9.12.2005, fq. 1

[28] GZ L 323, 9.12.2005, fq. 1

[29] GZ L 35, 11.2.2003, fq. 1 Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 2005/1/KE (GZ L 79, 24.3.2005, f. 9).;"

[30] GZ L 345, 19.12.2002, fq. 1 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE."

[31] GZ L 126, 26.5.2000, fq. 1 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE.

[32] GZ L 141, 11.6.1993, fq. 27 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2002/87/KE.

[33] GZ L 228, 11.8.1992, fq. 1 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE."

[34] GZ L 323, 9.12.2005, fq. 1

[35] GZ L 330, 5.12.1998, fq. 1 Direktivë Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE (GZ L 79, 24.3.2005, fq. 9).

[36] GZ L 126, 26.5.2000, fq. 1 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE.

[37] GZ L 141, 11.6.1993, fq. 27 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2002/87/KE (GZ L 35, 11.2.2003, fq. 1).

[38] GZ L 141, 11.6.1993, fq. 1 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE

[39] GZ L 35, 11.2.2003, fq. 1 Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2005/1/KE."

-----  
SHTOJCA I

Format e ndërmarrjeve të risigurimit:

- në rastin e Mbretërisë së Belgjikës: "société anonyme/naamloze vennootschap", "société en commandite par actions/commanditaire vennootschap op aandelen", "association d'assurance mutuelle/onderlinge verzekeringsvereniging", "société coopérative/coöperatieve vennootschap";

- në rastin e Republikës Çeke: "akciová společnost";

- në rastin e Mbretërisë së Danimarkës: "aktieselskaber", "gensidige selskaber";
- në rastin e Republikës Federale Gjermane: "Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit", "Öffentlich-rechtliches Wettbewerbsversicherungsunternehmen";
- në rastin e Republikës së Estonisë: "aktsiaselts";
- në rastin e Republikës Greke: "ανώνυμη εταιρία", "αλληλασφαλιστικός συνεταιρισμός";
- në rastin e Mbretërisë së Spanjës: "sociedad anónima";
- në rastin e Republikës Franceze: "société anonyme", "société d'assurance mutuelle", "institution de prévoyance régie par le code de la sécurité sociale", "institution de prévoyance régie par le code rural" dhe "mutuelles régies par le code de la mutualité";
- në rastin e Irlandës: "incorporated companies limited by shares or by guarantee or unlimited";
- në rastin e Republikës Italiane: "società per azioni";
- në rastin e Republikës së Qipros: "Εταιρεία Περιορισμένης Ευθύνης με μετοχές" ή "Εταιρεία Περιορισμένης Ευθύνης με εγγύηση";
- në rastin e Republikës së Letonisë: "akciju sabiedrība", "sabiedrība ar ierobežotu atbildību";
- në rastin e Republikës së Lituanisë: "akcinė bendrovė", "uždaroji akcinė bendrovė";
- në rastin e Dukatit të Madh të Luksemburgut: "société anonyme", "société en commandite par actions", "association d'assurances mutuelles", "société coopérative";
- në rastin e Republikës së Hungarisë: "biztosító részvénytársaság", "biztosító szövetkezet", "harmadik országbeli biztosító magyarországi fióktelepe";
- në rastin e Republikës së Maltës: "limited liability company/kumpanija ta responsabbiltà limitata";
- në rastin e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta: "naamloze vennootschap", "onderlinge waarborgmaatschappij";
- në rastin e Republikës së Austrisë: "Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit";
- në rastin e Republikës së Polonisë: "spółka akcyjna", "towarzystwo ubezpieczeń wzajemnych";
- në rastin e Republikës Portugeze: "sociedade anónima", "mútua de seguros";
- në rastin e Republikës së Sllovenisë: "delniška družba";
- në rastin e Republikës Sllovaqe: "akciová spoločnosť";
- në rastin e Republikës së Finlandës: "keskinäinen vakuutusyhtiö/ömsesidigt försäkringsbolag", "vakuutusosakeyhtiö/försäkringsaktiebolag", "vakuutusyhdistys/försäkringsförening";
- në rastin e Mbretërisë së Suedisë: "försäkringsaktiebolag", "ömsesidigt försäkringsbolag";
- në rastin e Mbretërisë së Bashkuar: "incorporated companies limited by shares or by guarantee or unlimited", "societies registered under the Industrial and Provident Societies Acts", "societies

registered or incorporated under the Friendly Societies Acts”, "the association of underwriters known as Lloyd's".

-----

## SHTOJCA II

Shtojcat I dhe II të Direktivës 98/78/KE zëvendësohen si më poshtë:

### SHTOJCA I

#### LLOGARITJA E AFTËSISË SË RREGULLUAR PAGUESE TË NDËRMARRJEVE TË SIGURIMEVE DHE NDËRMARRJEVE TË RISIGURIMEVE

##### 1. ZGJEDHJA E METODËS SË LLOGARITJES DHE PARIMET E PËRGJITHSHME

A. Shtetet Anëtare parashikojnë që llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve të risigurimeve të përmendura në nenin 2 pika 1 të bëhet sipas njëres prej mënyrave të përshkruara në pikën 3. Megjithatë, Shteti Anëtar mund të parashikojë që autoritetet kompetente të autorizojnë ose të vendosin zbatimin e një metode të caktuar në pikën 3 të ndryshme nga ajo ka zgjedhur Shteti Anëtar.

##### B. Proporcionaliteti

Llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh dhe të një ndërmarrjeje risigurimi merr parasysh kuotën proporcionale që ndërmarrja pjesëmarrëse ka në ndërmarrjet e saj të lidhura.

"Kuota proporcionale" është, nëse përdoret metoda 1 ose metoda 2 e përshkruar në pikën 3, përqindja e kapitalit të nënshkruar që mban drejtpërdrejt ose tërthorazi ndërmarrja pjesëmarrëse ose, nëse përdoret metoda 3 e përshkruar në pikën 3, përqindjet e përdorura për përpilimin e llogarive përfundimtare.

Megjithatë, cilado qoftë metoda e përdorur, nëse ndërmarrja e lidhur është një ndërmarrje filial dhe ka deficit në aftësinë paguese, në konsideratë duhet të merret deficiti gjithsej i aftësisë paguese të filialit.

Megjithatë, nëse sipas mendimit të autoriteteve kompetente përgjegjësia e ndërmarrjes mëmë që ka në pronësi një kuotë të kapitalit në mënyrë rigoroze dhe të qartë nuk del jashtë kësaj kuote të kapitalit, këto autoritete kompetente mund të japin leje që deficiti i aftësisë paguese të ndërmarrjes filial të merret parasysh në mënyrë proporcionale.

Nëse nuk ka asnjë lidhje kapitali ndërmjet disa prej ndërmarrjeve të grupit të sigurimeve ose grupit të risigurimeve, autoriteti kompetent përcakton se cila pjesë proporcionale duhet të merret parasysh.

##### C. C.1. Trajtimi i përgjithshëm i elementeve të nivelit të aftësisë paguese

Pavarësisht nga metoda e përdorur për llogaritjen e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes së sigurimeve ose ndërmarrjes së risigurimit, përdorimi i dyfishtë i elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese ndërmjet ndërmarrjeve të ndryshme të sigurimeve ose ndërmarrjeve të risigurimit të përfshira në këtë llogaritje duhet të eliminohet.

- vlera e çdo aktivi të asaj ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimi që përfaqëson financimin e elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të një prej ndërmarrjeve të sigurimeve të lidhura të saj ose të ndërmarrjeve të lidhura risigurimi,

- vlera e çdo aktivi të një ndërmarrjeje sigurimesh të lidhur ose të një ndërmarrjeje risigurimi të lidhur të asaj ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimi që përfaqëson financimin e elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të asaj ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimesh,

- vlera e çdo aktivi të një ndërmarrjeje sigurimesh të lidhur ose të një ndërmarrjeje risigurimi të lidhur të asaj ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimi që përfaqëson financimin e elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të një ndërmarrjeje tjetër sigurimesh të lidhur ose ose ndërmarrjeje risigurimesh të lidhur të asaj ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimesh.

#### C.2. Trajtimi i elementeve të caktuara

- rezervat e fitimeve dhe fitimet e ardhshme në një ndërmarrje të lidhur të sigurimit të jetës ose të një ndërmarrjeje të lidhur risigurimi të jetës të një ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimi për të cilën llogaritet aftësia e rregulluar paguese, dhe

- çdo kapital i nënshkruar por i papaguar i një ndërmarrjeje sigurimesh të lidhur ose një ndërmarrjeje risigurimesh të lidhur të një ndërmarrjeje sigurimesh ose një ndërmarrjeje risigurimesh për të cilën llogaritet aftësia paguese e rregulluar, mund të përfshihet në llogaritje për aq sa janë të lejuar për mbulimin e kërkesës së nivelit të aftësisë paguese të asaj ndërmarrjeje të lidhur. Megjithatë, çdo kapital i nënshkruar por i papaguar që përfaqëson një detyrim potencial nga ana e ndërmarrjes pjesëmarrëse përjashtohet tërësisht nga llogaritja.

Çdo kapital i nënshkruar por i papaguar i ndërmarrjes së sigurimeve pjesëmarrëse ose i ndërmarrjes risiguroese pjesëmarrëse që përfaqëson një detyrim potencial nga ana e ndërmarrjes së sigurimeve të lidhur ose e një ndërmarrjeje risigurimesh të lidhur përjashtohet gjithashtu nga llogaritja.

Çdo kapital i nënshkruar por i papaguar i një ndërmarrjeje të sigurimeve të lidhur ose e një ndërmarrjeje risigurimesh që përfaqëson një detyrim potencial nga ana e një ndërmarrjeje tjetër të sigurimeve të lidhur ose e një ndërmarrjeje risigurimi të njëjtës ndërmarrjeje pjesëmarrëse të sigurimeve ose ndërmarrjeje risigurimi përjashtohet nga llogaritja.

#### C.3. Transferueshmëria

Nëse autoritetet kompetente konsiderojnë që elemente të caktuara të lejuara për nivelin e aftësisë paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh të lidhur ose të një ndërmarrjeje risigurimi të lidhur të ndryshme nga ato të përmendura në seksionin C.2 nuk mund të ofrohen në mënyrë të efektshme për të mbuluar kërkesën e nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjes së sigurimeve pjesëmarrëse ose të ndërmarrjes risiguroese pjesëmarrëse për të cilën llogaritet aftësia paguese e rregulluar, ata elementë mund të përfshihen në llogaritje vetëm për aq sa janë të lejuar për mbulimin e kërkesës së nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjes së lidhur.

C.4. Tërësia e elementeve të përmendura në seksionet C.2 dhe C.3 nuk mund të jetë më e madhe se kërkesa e nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjes së sigurimeve të lidhur ose ndërmarrjes risiguroese të lidhur.

#### D. Eliminimi i krijimit të kapitalit brenda grupit

- një ndërmarrjeje të lidhur,
- një ndërmarrjeje pjesëmarrëse
- një ndërmarrjeje tjetër të lidhur dhe ndërmarrjeve të saj pjesëmarrëse.

Për më tepër, nuk merret parasysh asnjë element i përshtatshëm për nivelin e aftësisë paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh të lidhur ose të një ndërmarrjeje risigurimi të lidhur të një ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimi për të cilën aftësia e rregulluar paguese llogaritet kur elementi në fjalë del nga financimi reciprok me çdo ndërmarrje tjetër të lidhur të asaj ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimi.

Veçanërisht, ekziston financimi reciprok nëse një ndërmarrjeje sigurimesh ose një ndërmarrjeje risigurimi ose një prej ndërmarrjeve të saj të lidhura ka aksione ose i jep hua një ndërmarrjeje tjetër që, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, ka një element të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjeve të para.

E. Autoritetet kompetente sigurojnë që aftësia paguese e rregulluar të llogaritet me të njëjtën shpeshësi siç është parashikuar në Direktivat 73/239/KEE, 91/674/KEE, 2002/83/KE dhe 2005/68/KEE për llogaritjen e nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve ose ndërmarrjeve risiguroese. Vlera e aktiveve dhe pasiveve vlerësohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Direktivave 73/239/KEE, 91/674/KEE, 2002/83/KE dhe 2005/68/KE.

## 2. ZBATIMI I METODAVE TË LLOGARITJES

### 2.1. Ndërmarrjet e lidhura të sigurimeve dhe ndërmarrjet e lidhura risiguroese

Llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese kryhet në pajtim me parimet dhe metodat e përgjithshme të parashikuara në këtë shtojcë.

Në rastin e të gjithë metodave, kur ndërmarrja e sigurimeve ose ndërmarrja risiguroese ka më shumë se një ndërmarrje të lidhur sigurimesh ose një ndërmarrje të lidhur risiguroese, llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese bëhet duke integruar secilën prej këtyre ndërmarrjeve të lidhura të sigurimeve ose ndërmarrjeve të lidhura risigurimi.

Në rastin e pjesëmarrjeve të njëpasnjëshme (për shembull, kur një ndërmarrje sigurimesh ose një ndërmarrje risigurimi është ndërmarrje pjesëmarrëse në një ndërmarrje tjetër sigurimesh ose një ndërmarrje tjetër risigurimi, e cila është gjithashtu ndërmarrje pjesëmarrëse në një ndërmarrje sigurimesh ose ndërmarrje risigurimi) llogaritja e aftësisë së pastër paguese kryhet në nivelin e secilës ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimi pjesëmarrëse që ka të paktën një ndërmarrje të lidhur sigurimesh ose një ndërmarrje të lidhur risigurimi.

- nëse ndërmarrja e sigurimeve ose ndërmarrja risiguroese është një ndërmarrje e lidhur e një ndërmarrjeje tjetër sigurimesh ose risigurimi e autorizuar në të njëjtin Shtet Anëtar dhe kjo ndërmarrje e lidhur merret parasysh në llogaritjen e aftësisë së pastër paguese të ndërmarrjes së sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguroese pjesëmarrëse, ose

- nëse ndërmarrja e sigurimeve ose ndërmarrja risiguroese është një ndërmarrje e lidhur e një shoqërie sigurimesh holding që e ka selinë e regjistruar në të njëjtin Shtet Anëtar si ndërmarrja e sigurimeve ose ndërmarrja e risigurimeve dhe, si shoqëria e sigurimeve holding ashtu edhe ndërmarrja e lidhur e sigurimeve ose ndërmarrja e lidhur risiguroese, merren parasysh në llogaritjen e kryer.

Shtetet Anëtare mund të heqin gjithashtu dorë nga llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh ose të një ndërmarrjeje risigurimi nëse ajo është një ndërmarrje sigurimesh e lidhur ose një ndërmarrje risigurimi e lidhur e një ndërmarrjeje tjetër sigurimesh, e një ndërmarrjeje risigurimesh ose një shoqërie sigurimesh holding që e ka selinë e regjistruar në një Shtet tjetër Anëtar dhe nëse autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare përkatëse kanë rënë dakord t'ia ngarkojnë mbikëqyrjen shtesë autoritetit kompetent të Shtetit të fundit Anëtar.

Në çdo rast, heqja dorë mund të lejohet vetëm nëse autoritetet kompetente janë të bindur që elementët e lejuar për nivelet e aftësisë paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve ose të ndërmarrjeve risiguroese të përfshira në llogaritje janë të shpërndarë në mënyrë të përshtatshme ndërmjet atyre ndërmarrjeve.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që nëse ndërmarrja e lidhur e sigurimeve ose ndërmarrja e lidhur risiguroese e ka selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga ai i ndërmarrjes së sigurimeve ose të ndërmarrjes së risigurimeve për të cilën kryhet llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese, llogaritja, në lidhje me ndërmarrjen e lidhur, merr parasysh gjendjen e aftësisë paguese që vlerësohet nga autoritetet kompetente të Shtetit tjetër Anëtar

## 2.2. Shoqëritë holding të ndërmjetme të sigurimeve

Në llogaritjen e aftësisë së pastër paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh ose të një ndërmarrjeje risigurimi që ka një pjesëmarrje në një ndërmarrje sigurimesh, një ndërmarrje të lidhur risigurimesh, një ndërmarrje sigurimesh në një shtet të tretë ose një ndërmarrje risigurimi në një shtet të tretë, nëpërmjet një shoqërie holding sigurimesh, merret parasysh gjendja e shoqërisë holding të ndërmjetme të sigurimeve. Për qëllimin e kësaj llogaritjeje që duhet të ndërmerret në pajtim me parimet dhe metodat e përgjithshme të përshkruara në këtë Shtojcë, kjo shoqëri holding sigurimesh trajtohet sikur të ishte një ndërmarrje sigurimesh ose një ndërmarrje risigurimi që i nënshtrohet kërkesës për aftësi paguese zero dhe sikur t'u nënshtrohej të njëjtave kushte që parashikohen në nenin 16 të Direktivës 73/239/KEE, në nenin 27 të Direktivës 2002/83/KEE ose në nenin 36 të Direktivës 2005/68/KEE në lidhje me elementët e lejuar për nivelin e aftësisë paguese.

## 2,3. Ndërmarrjet e lidhura të sigurimeve të shteteve të treta dhe ndërmarrjet e lidhura risiguroese të shteteve të treta

Në llogaritjen e aftësisë së rregulluar paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimesh që është ndërmarrje pjesëmarrëse në një ndërmarrje sigurimesh të një shteti të tretë ose në një ndërmarrje risiguroese në një shtet të tretë, kjo e fundit trajtohet, vetëm për qëllimet e llogaritjes, në mënyrë të ngjashme me një ndërmarrje të lidhur sigurimesh ose një ndërmarrje të lidhur risiguroese, duke zbatuar parimet dhe metodat e përgjithshme të përshkruara në këtë shtojcë.

Megjithatë, nëse shteti i tretë në të cilin kjo ndërmarrje ka selinë e saj e kushtëzon me autorizimin dhe i vendos asaj një kërkesë aftësie paguese të paktën të krahasueshme me atë të parashikuar në Direktivat 73/239/KEE, 2002/83/KE ose 2005/68/KE, duke marrë parasysh elementet e mbulimit të kësaj kërkesë, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që llogaritja të marrë parasysh, në lidhje me këtë ndërmarrje, kërkesën e aftësisë paguese dhe elementet e lejuara për të përmbushur këtë kërkesë sipas parashikimit nga shteti i tretë në fjalë.

## 2,4. Institucionet e kreditit, firmat e investimeve dhe institucionet financiare të lidhura

Gjatë llogaritjes së aftësisë së rregulluar paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimi që është një ndërmarrje pjesëmarrëse në një institucion krediti, firmë investimi ose

institucion financiar, rregullat e parashikuara në nenin 16 të Direktivës 73/239/KEE, në nenin 27 të Direktivës 2002/83/KE dhe në nenin 36 të Direktivës 2005/68/KE mbi zbritjen e këtyre pjesëmarrjeve zbatohen duke bërë përshtatjet e duhura, si dhe dispozitat për aftësinë e Shteteve Anëtare në kushte të caktuara për të lejuar metodat alternative dhe për të lejuar që këto pjesëmarrje të mos zbriten.

## 2.5. Mosdisponueshmëria e informacionit të nevojshëm

Nëse informacioni i nevojshëm për llogaritjen e aftësisë të rregulluar paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh ose të një ndërmarrje risigurimi, në lidhje me një ndërmarrje të lidhur me seli të regjistruar në një Shtet Anëtar ose në një shtet të tretë, nuk është i disponueshëm për autoritetet kompetente për çfarëdo lloj arsyeje, vlera kontabël e asaj ndërmarrjeje në ndërmarrjen pjesëmarrëse të sigurimeve ose ndërmarrjen risiguroese zbritet nga elementet e përshtatshme për nivelin e aftësisë së rregulluar paguese. Në këtë rast, fitimet e përealizuara në lidhje me këtë pjesëmarrje nuk lejohet si element i lejuar për nivelin e aftësisë së rregulluar paguese.

## 3. METODAT E LLOGARITJES

Metoda 1: Metoda e zbritjes dhe e mbledhjes

Gjendja e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguroese pjesëmarrëse është diferenca ndërmjet:

(i) shumës së:

(a) elementeve të lejuara për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguroese pjesëmarrëse, dhe

(b) pjesës proporcionale të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguroese pjesëmarrëse në elementet e përshtatshme për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguroese të lidhur, dhe

(ii) shumës së:

(a) vlerës kontabël në ndërmarrjen pjesëmarrëse të sigurimeve ose ndërmarrjen risiguroese pjesëmarrëse të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve ose ndërmarrjes të lidhur risiguroese, dhe

(b) kërkesës së aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose të ndërmarrjes pjesëmarrëse risiguroese, dhe

(c) pjesës proporcionale të kërkesës për aftësi paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve ose ndërmarrjes së lidhur risiguroese.

Nëse pjesëmarrja në ndërmarrjen e lidhur të sigurimeve ose në ndërmarrjen e lidhur risiguroese konsiston, tërësisht ose pjesërisht në pronësi jo të drejtpërdrejtë, pika ii shkronja “a” përfshin vlerën e kësaj pronësie jo të drejtpërdrejtë, duke marrë parasysh interesat përkatëse të njëpasnjëshme, dhe pika i shkronja “b” dhe pika ii “c” përfshijnë pjesët përkatëse proporcionale të elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve dhe të kërkesës së aftësisë paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve ose të ndërmarrjes së lidhur risiguroese.

Metoda 2: Metoda e zbritjes së kërkesës



Aftësia e pastër paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguruese pjesëmarrëse është diferenca ndërmjet:

(a) shumës së elementeve të lejuara për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguruese pjesëmarrëse, dhe

(ii) shumës së:

(a) kërkesës së aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose të ndërmarrjes pjesëmarrëse risiguruese, dhe

(b) pjesës proporcionale të kërkesës për aftësi paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve ose ndërmarrjes së lidhur risiguruese.

Gjatë vlerësimit të elementeve të lejuara për nivelin e aftësisë paguese, pjesëmarrjet brenda kuptimit të kësaj direktive vlerësohen me metodën e kapitalit neto, në pajtim me opsionin e parashikuar në nenin 59 pika 2 shkronja “b” të Direktivës 78/660/KEE.

Metoda 3: Metoda e bazuar në konsolidimin kontabël

Llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose e ndërmarrjes pjesëmarrëse risiguruese kryhet mbi bazën e konsolidimit kontabël. Aftësia e rregulluar paguese e ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose ndërmarrjes pjesëmarrëse risiguruese është diferenca ndërmjet elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të llogaritur mbi bazën e të dhënave të konsoliduara, dhe:

(a) ose shumës së kërkesës së aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve ose të ndërmarrjes pjesëmarrëse risiguruese dhe të pjesëve proporcionale të kërkesave të aftësisë paguese të ndërmarrjeve të lidhura të sigurimeve ose të ndërmarrjes së lidhur risiguruese, bazuar në përqindjet e përdorura për krijimin e llogarive të konsoliduara

(b) ose kërkesës së aftësisë paguese të llogaritur mbi bazën e të dhënave të konsoliduara.

Dispozitat e Direktivave 73/239/KEE, 91/674/KEE, 2002/83/KE dhe 2005/68/KE zbatohen për llogaritjen e elementeve të lejuara për nivelin e aftësisë paguese dhe të kërkesës së aftësisë paguese bazuar mbi të dhënat e konsoliduara.

## SHTOJCA II

**MBIKËQYRJA SHITESË E NDËRMARRJEVE TË SIGURIMEVE DHE NDËRMARRJEVE TË RISIGURIMEVE QË JANË FILIALE TË NJË SHOQËRIE HOLDING SIGURIMESH, NJË NDËRMARRJEJE SIGURIMESH TË NJË VENDI TË TRETË OSE NJË NDËRMARRJEJE RISIGURIMI TË NJË VENDI TË TRETË**

1. Në rastin kur dy ose më shumë ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi të përmendura në nenin 2 pika 2 të cilat janë filiale të një ndërmarrjeje holding sigurimesh, një ndërmarrjeje sigurimesh të një vendi të tretë ose një ndërmarrjeje risigurimesh të një vendi të tretë dhe që janë vendosur në Shtete të ndryshme Anëtare, autoritetet kompetente sigurojnë që metodat e përshkuara në këtë shtojcë të zbatohet në mënyrë uniforme.

Autoritetet kompetente ushtrojnë mbikëqyrje shtesë me të njëjtën shpeshësi siç është parashikuar në Direktivat 73/239/KEE, 91/674/KEE, 2002/83/KE dhe 2005/68/KEE për llogaritjen e nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve risiguruese.

2. Shtetet Anëtare mund të heqin dorë nga llogaritja e parashikuar në këtë shtojcë në lidhje me një ndërmarrje sigurimesh ose një ndërmarrje risigurimi:

- nëse ndërmarrja e sigurimeve ose ndërmarrja risiguruese është një ndërmarrje e lidhur e një ndërmarrje tjetër sigurimesh ose ndërmarrjeje risigurimesh dhe nëse merret parasysh në llogaritjen e parashikuar në këtë shtojcë që kryhet për ndërmarrjen tjetër,

- nëse kjo ndërmarrje sigurimesh ose ndërmarrje risiguruese dhe një ose më shumë ndërmarrje të tjera sigurimesh ose ndërmarrje risigurimi të autorizuar në të njëjtin Shtet Anëtar kanë si ndërmarrje të tyre mëmë të njëjtën shoqëri holding sigurimesh, një ndërmarrje sigurimesh të një shteti të tretë ose ndërmarrje risigurimesh të një shteti të tretë dhe ndërmarrja e sigurimeve ose ndërmarrja risiguruese merret parasysh në llogaritjen e parashikuar në këtë shtojcë që kryhet për një prej këtyre ndërmarrjeve të tjera,

- nëse kjo ndërmarrje sigurimesh ose ndërmarrje risigurimi dhe një ose më shumë ndërmarrje të tjera sigurimesh ose ndërmarrje risiguruese të autorizuar në Shtete të tjerë Anëtarë kanë si ndërmarrje të tyre mëmë të njëjtën shoqëri holding sigurimesh, një ndërmarrje sigurimesh të një shteti të tretë ose ndërmarrje risigurimi të një shteti të tretë dhe një marrëveshje që lejon ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë që mbulohet nga kjo shtojcë nga autoriteti mbikëqyrës i një Shteti tjetër Anëtar është lidhur në pajtim me nenin 4 pika 2.

Në rastin e pjesëmarrjeve të njëpasnjëshme (për shembull: një shoqëri holding sigurimesh ose një ndërmarrje sigurimesh ose risiguruse e një shteti të tretë, që është vetë në pronësi të një shoqërie tjetër holding sigurimesh, një ndërmarrjeje sigurimesh ose risigurimi të një shteti të tretë), Shtetet Anëtare mund të zbatojnë llogaritjet e parashikuara në këtë shtojcë vetëm në nivelin e ndërmarrjes më të lartë mëmë të ndërmarrjes së sigurimeve ose të ndërmarrjes risiguruese që është një shoqëri holding sigurimesh, një ndërmarrje sigurimesh e një shteti të tretë ose një ndërmarrjeje risigurimesh e një shteti të tretë.

3. Autoritetet kompetente sigurojnë që të bëhen llogaritje të ngjashme me ato të përshkruara në Shtojcën I në nivelin e shoqërisë holding të sigurimeve, ndërmarrjes së sigurimeve të një shteti të tretë dhe të ndërmarrjes së risiguruese të një shteti të tretë.

Analogjia konsiston në zbatimin e parimeve dhe metodave të përgjithshme të përshkruara në Shtojcën I në nivelin e shoqërisë holding të sigurimeve, ndërmarrjes së sigurimeve të një shteti të tretë ose të ndërmarrjes risiguruese të një shteti të tretë.

Për qëllimin e vetëm të kësaj llogaritjeje, ndërmarrja mëmë trajtohet sikur të ishte një ndërmarrje sigurimesh ose ndërmarrje risigurimesh që i nënshtrohet:

- kërkesës për aftësi paguese zero, nëse është shoqëri holding sigurimesh,

- kërkesës për aftësi paguese të përcaktuar në pajtim me parimet e seksionit 2.3 shkronja “a” të Shtojcës I, nëse është një ndërmarrje sigurimesh e një shteti të tretë ose një ndërmarrje risiguruese e një shteti të tretë, dhe u nënshtrohet të njëjtave kushte që parashikohen në nenin 16 të Direktivës 73/239/KEE, në nenin 27 të Direktivës 2002/83/KEE dhe në nenin 36 të Direktivës 2005/68/KEE në lidhje me elementet e lejuara për nivelin e aftësisë paguese.

#### 4. Mosdisponueshmëria e informacionit të nevojshëm

Nëse informacioni i nevojshëm për llogaritjen e parashikuar në këtë shtojcë, në lidhje me një ndërmarrje të lidhur me seli të regjistruar në një Shtet Anëtar ose në një shtet të tretë, nuk është i disponueshëm për autoritetet kompetente për çfarëdo lloj arsyeje, vlera kontabël e asaj ndërmarrjeje në ndërmarrjen pjesëmarrëse zbritet nga elementet e lejuara për llogaritjen e parashikuar në këtë shtojcë. Në këtë rast, fitimet e perealizuara në lidhje me këtë pjesëmarrje nuk lejohen si një element i lejuar për llogaritjen.